



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 29 DHJETOR 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 29. DECEMBRA 2014. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2014**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrt zakona o budžetu Republike Kosova za 2015. god.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Paraprakisht votojmë për praninë e deputetëve në sallë. Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se në sallë janë të pranishëm 93 deputetë.

Ju njoftoj se, në pajtim me vendimin e Kuvendit, më 22 dhjetor 2014, procedojmë me rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Paraprakisht e lus kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotin Ismet Beqiri, për fjalë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Unë, në bazë të nenit 42, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, propozoj që ky rend i ditës për seancën e sotme të plotësohet edhe me një pikë: Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar, duke filluar nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015.

Më lejoni shumë shkurt ta arsyetoj se pse duhet të ndodhte kjo. Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar numër 03/L-146 parasheh periudhën kalimtare 1 janar 2010 - 31 dhjetor 2012 për lirimimin e disa importeve nga pagesa e TVSH-së. Kjo periudhë kalimtare është zgjatuar deri më 31 dhjetor 2014, me vendimin e Qeverisë numër 06/94, datë 10.10. 2012.

Për arsye se ende nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme në Ligjin e TVSH-së, është e nevojshme që ky afat të zgjatet edhe për një vit, në mënyrë që Doganat e Kosovës të mos fillojnë mbledhjen e TVSH-së për këto importe nga 1 janar 2015. Kjo është arsyeja që ne kërkuam me urgjencë që kjo pikë të hyjë në rend të ditës.

Importet dhe furnizimet për të cilat kërkohet lirimimi nga TVSH-ja përfshijnë: lëndë të para dhe makineri bujqësore, siç janë të listuara në aneksin 4 të Ligjit për TVSH-në numër 03/L-146; sistemi i ujitjes të tokave bujqësore, paragrafi 2, neni 33 i Ligjit numër 03/L-146 për TVSH-në; furnizimet e financuara nga donatorët në mbështetje të projekteve humanitare-rindërtuese dhe integriteteve evropiane, sipas nenit 30, paragrafi 2.1 të Ligjit për TVSH-në numër 03/L-146; furnizimet e bëra për organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, sipas nenit 30, paragrafi 2.2, të Ligjit për TVSH-në numër 03/L-146.

Përveç kësaj, gjithashtu është e nevojshme që të vazhdohet kjo periudhë tranzitore për mosimplementimin e dispozitave të këtij ligji në fushat specifike, siç përcaktohet në paragrafin 3, të nenit 64 të Ligjit për TVSH-në.

Këto janë arsyet se pse ne kërkojmë që kjo të futet në rend të ditës, pas pikës për Ligjin për Buxhetin. Kjo ka ndodhur edhe më herë dhe ka arsyeshmëri të plotë që kjo të ndodhë

edhe sot, dhe ne si Kuvend të votojmë për lirim e TVSH-së për këto që i lexova. Faleminderit!

KRYETARI: E kemi një propozim të ri për rendin e ditës. Është lajmëruar Albulena Haxhiu. Atëherë për këtë çështje jemi gjithmonë në propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

A ka deklarime të grupeve parlamentare për arsye se në qoftë se procedojmë për futjen e kësaj pike në rendin e ditës duhet ta bëjmë një votim formal.

Në qoftë se nuk ka, duhet ta bëjmë një votim formal. Fjalën e ka Adem Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e sheh këtë vendim si të drejtë për vazhdimin e mandatit edhe për një vit, sepse ka reflektim të drejtpërdrejtë në një fushë shumë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të vendit.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i jep mbështetje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Visar Ymeri nga Lëvizja “Vetëvendosja”, pastaj Donika Kadaj-Bujupi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Mendoj që kjo mënyrë e trajtimit të këtyre çështjeve të rëndësishme, e cila po rrezikon të bëhet si e zakonshme, është jashtëzakonisht e dëmshme.

Pra, ne tashmë jemi duke e bërë një gabim shumë të madh me këtë nguti me Buxhetin, e tash po kërkohet nga që të votojmë edhe për një çështje tjetër të rëndësishme po ashtu duke u ngutur, aq më tepër pa pasur kurrfarë materiali përpara të shkruar, të cilin do të kishim pasur nevojë ta analizojmë si deputetë. Prandaj, ne nuk jemi për atë që të futet kjo pikë e re e kërkuar e rendit të ditës, sepse për këtë kërkohet një kohë pak më e gjatë për ta analizuar dhe trajtuar me seriozitet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADA BUJUPI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konsideron që kjo listë duhet të zgjerohet. Është një ndër kërkesat esenciale, sidomos për shembull për produktet bazike ushqimore. Prandaj, këto veprimet ad hoc nuk mundësojnë që të vihet deri te zgjerimi aq i nevojshëm i kësaj liste.

Dhe, ne konsiderojmë që duhet të na jepet kohë, në mënyrë që lista të përpunohet, ta marrim materialin, të zgjerohet lista sipas nevojës dhe pastaj të procedojmë tutje. Në fund të fundit, ka qenë e mundur që kjo pikë e rendit të ditës të vijë si pikë e rregullt të rendit të ditës, të vendoset në Kryesi, siç e parashih edhe Rregullorja e Kuvendit, dhe kjo

përpyjekje në vazhdimësi për t'iu shmangur Rregullores dhe për të ikur nga rendit i ditës, në fakt, po shkon në dëm të cilësisë dhe marrjes së vendimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, e dëshiron fjalën? Urdhëro, Jasmina!

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsedavajući.

Srpska lista je takođe protiv ovakve vrste uvođenja novih tačaka vezano za dnevni red u budžetu. Srpska lista je vrlo ozbiljna i vrlo odgovorna vezano za usvajanje budžeta, i vrlo ozbiljno shvata situaciju kada se radi o budžetu Kosova i usvajanje istog.

S toga Srpska lista imala sledeću poruku. Srpska lista je tokom celog perioda bila vrlo konstruktivna prilikom usvajanje budžeta za 2015. godinu na prvom čitanju i pristajući na ubrzanu proceduri, ponavljam opet shvatajući vrlo ozbiljnost usvajanje budžeta Kosova.

Verujući u obećanje svojih partnera, da će budžet na drugog čitanja i glasanje biti prilagođen minimalnim zahtevima Srpskog naroda, kako bi se time omogućili elementarnim uslovi za život onih koji žive na Kosovu i omogućio povratak onih koji su se izjasnili za to, i pokazala realna spremnost Kosova da se u povratku ne samo priče već i ozbiljno radi na tome.

Ono što moram da istaknem jeste i da funkcionisanje većih broja lokalnih samouprava sa srpskom većinom doveden u upitanje, i ukoliko ovakav budžet bude usvojen, on neće moći da odgovori realnim potrebama građana Kosova.

KRYETARI: Izvini, ali vi ste van dnevnog reda, ako možete da dolazite natrag!

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Naravno! Ja se izvinjavam! Za prvu tačku ono što ste rekli vezano za dnevni red protiv je uvrstanja bilo kojih novih tačaka, a što se samog dnevnog reda tiče, današnji dnevni red jeste budžet Kosova, iz gore navedenih razloga Srpska lista neće učestovati u daljem radu sednice. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, nga Grupi Parlamentar “Nisma” a ka dikush për diskutim diçka? Po, zoti Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ne konsiderojmë se kjo kërkesë mund të ishte e arsyeshme sikur të vinte në rrugë të rregullt. Konsiderojmë që këtë çështje nuk duhet ta trajtojmë me këtë nguti. Do të thotë, konsiderojmë që kjo pikë e rendit të ditës e do një përgatitje tjetër dhe pasi nuk është e ngutshme, mund të trajtohet edhe në janar, do të thotë në seancat e janarit. Kërkojmë nga Qeveria që ta sjellë një vendim, ose një kërkesë të saj për ta miratuar në Kuvend, por tani për tani konsiderojmë që me kaq urgjencë kjo çështje nuk duhet trajtuar në Kuvend.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi “6+”, e dëshironi fjalën? Jo! Duke pasur parasysh se kemi pozicione të ndryshme të qëndrimeve të grupeve parlamentare për propozimin e

Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, jemi të detyruar të shkojmë në një votim formal për ose kundër aprovimit të propozimit për pikën e re të rendit të ditës.

Atëherë votojmë menjëherë! Lus regjinë të përgatitet! Do të kalojmë në votim elektronik. Kush është për, edhe kundër gjithsesi.

Me 65 vota për, 30 vota kundër dhe 1 abstenim e konsiderojmë të pranuar shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar, duke filluar nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015. Domethënë kalon si pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me vendimin e Kuvendit më 22 dhjetor 2014, e ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me amendamente. Andaj, në seancën e sotme plenare do të votohen amendamentet e paraqitura në raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Para se ta ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e shoh se ka paraqitje për diskutim nga Komisioni për Legjislacion. E ftoj zonjën Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Të hënën, më 22 dhjetor 2014, u votua në parim Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2015. Sipas Rregullores së Kuvendit, po e lexoj neni 57, paragrafi 1 - shqyrtimi i projektligjit në komisione, thuhet: “Pas miratimit të projektligjit në shqyrtim të parë, Kuvendi e ngarkon për shqyrtim të mëtejshëm Komisionin FunkSIONAL, si komision raportues, dhe komisionet për Legjislacion, Buxhet dhe Financa, Integritet Evropian, për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe për të Drejtat e Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, si komisione të përhershme.

Vendimi i Kuvendit, i datës 22 dhjetor, është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, pra konkretisht me nenin që e lexova, pra nenin 57, paragrafi 1, sepse ai vendim e ngarkon vetëm Komisionin për Buxhet dhe Financa. Kësisoj, më 26 dhjetor, pra të premten, Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur, shprehu shqetësimin për shkeljen e Rregullores me rastin e anashkalimit të Komisionit për Legjislacion dhe iu drejtua me shkresë Kryesisë së Kuvendit për respektim të Rregullores dhe ngarkim të Komisionit për Legjislacion në shqyrtimin e Buxhetit për vitin 2015 para shqyrtimit të dytë.

Kërkesa e Komisionit për Legjislacion nuk hasi në mirëkuptim, pra u injorua nga Kryesia. Kësisoj sot, në mbledhjen e mbajtur, Komisioni për Legjislacion me shumicë votash vendosi që, në respektim të Rregullores, të kërkojmë mocion procedural, pra që

para shqyrtimit të dytë të Buxhetit, raporti i buxhetit 2015 të sillet në Komisionin për Legjislacion. Pra, të respektohet Rregullorja e Kuvendit.

Është shumë e vërtetë që Kuvendi të hënën, më 22 dhjetor, ka votuar për shmangie, mirëpo ajo në asnjë mënyrë nuk ka nënkuptuar heqje dorë nga shqyrtimi i raportit nga komisionet e përhershme, mirëpo shkurtim në kohë. Unë e kam një shembull këtu, për shembull Buxhetin e vitit 2012, kur Kuvendi e ka shqyrtuar me procedurë të përsheptuar, mirëpo megjithatë vendimi i ka obliguar të gjitha komisionet tjera të përhershme.

Pra, unë kërkoj nga ju, në emër të Komisionit, që të votoni për këtë mocion që të bartet raporti i Buxhetit në Komisionin për Legjislacion, pasi me këto veprime po minimizohet dhe po zbehet roli i komisioneve parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

E kemi një situatë në të cilën, në princip, deputetja e nderuar do të kishte të drejtë, sikur nuk do ta bënim në parim. Në seancën e kaluar kemi votuar me 95 vota për, asnjë kundër dhe me 1 abstenim për propozimin, në të cilin njëra nga pikat ka qenë shmangia e Rregullores dhe pika 2 ka qenë që Komisioni për Buxhet dhe Financa e shqyrton Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime.

Domethënë, Rregullorja është shmangur nga vetë ju me votim me 95 vota për. Kjo është kjo. Sido që të jetë, unë para se të vija këtu në Kuvend, e kemi konsultuar edhe Rregulloren, i kemi marrë edhe stenogramet e procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Kjo çështje faktikisht është e tejkaluar. Për këtë çështje nuk kemi çka të diskutojmë më tej. Edhe një herë - nuk është faji im, nuk do të lejoja në asnjë mënyrë të vazhdojmë me shkelje të Rregullores, as ta shndërroja atë në servis, por sido që të jetë - vendimi është juaji. Ky është vendim juaji, shmangien e Rregullores e keni bërë ju me votimin tuaj.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime...

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Më falni edhe një herë, vetë keni votuar me 95 vota për.

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Prapë, ju lutem! Le që unë jam i ri në pozicionin e kryetarit të Kuvendit, por ju paraprakisht, duke pasur mandatet e kaluara, është dashur që për mocion procedural ta dorëzoni një kërkesë të paktën me shkrim paraprakisht. Në bazë të Rregullores së Kuvendit!

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Jo, unë edhe po e lexoj, por në të njëjtën kohë, kur nuk po e marr vesh, po e pyes Sekretarinë për këtë çështje. Por, sido që të jetë, çështjet janë shumë të qarta .

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Dëgjo, unë fjalën do ta jap gjithsesi për arsye se askujt sa të jem unë këtu nuk do t'i ndalohet fjala, edhe në qoftë se bëj shmangie personalisht nga Rregullorja, por realisht vetë keni votuar dhe mbi një orë e kemi konsultuar pikërisht këtë çështje. Për hir të informimit të opinionit publik, shqetësimi ka ardhur qysh më herët pikërisht për këtë çështje. Atëherë deputete, urdhërojeni edhe një herë fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Atëherë, fillimisht po e lexoj nenin 50, që ka të bëjë me mocionet procedurale. Paragrafi 1 i nenit 50: “Në secilën mbledhje plenare - po e përsëris - në secilën mbledhje plenare të Kuvendit, deputeti ka të drejtë t'i propozojë këto mocione procedurale, pika c) për ta bartur çështjen në komisione”. Pra, kam plotësisht të drejtë që në emër të Komisionit për Legjislacion ta propozoj një gjë të tillë dhe kërkoj nga ju që ta nxirrni në votim.

Dhe, çështja tjetër është neni 84, shmangia nga Rregullorja: “Për t'iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhje plenare. Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës dhe me standardet evropiane”. Tash, është e vërtetë, siç e thatë, nuk e di nëse më keni dëgjuar në fjalimin që e bëra, ne kemi votuar për shmangie, mirëpo edhe në Kryesinë e Kuvendit jemi dakorduar vetëm për afatet kohore dhe nuk keni të drejtë që t'i anashkaloni komisionet parlamentare për shqyrtimin e raportit të ligjit më kryesor në Republikën e Kosovës, pra atij të Buxhetit. Kjo është e padrejtë.

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, para se t'ua jap fjalën të gjithëve për diskutime, e kemi edhe një mundësi për të mos marrë kohë, shkojmë edhe në votim, në qoftë se dëshironi për këtë mocion, të cilin e bëri deputetja, ose në qoftë se dëshironi shkojmë në votim? Në qoftë se është për çështjen e njëjtë, a shkojmë në votim, apo keni diçka të re? Atëherë Melihate Termokolli e ka fjalën, të njëjtën kohë të bëhet gati edhe Armend Zemaj, e pastaj shkojmë në votim elektronik.

MELIHATE TËRMKOLLI: Zoti kryetar!

Vetëm pak një përmirësim - Termokolli, këtë s'e paskam dëgjuar kurrë. Tash ka mundësi të përmirësohet në Tërmkolli. Nuk kam shumë qejf të m'i ndërruar kështu as emrin, e as mbiemrin, këtë që e kam, mirë-keq, ky është.

KRYETARI: Kërkoj falje, deputete!

MELIHATE TËRMKOLLI: Sa i përket çështjes, e cila u shtrua, ne e diskutuam në Komisionin për Legjislacion dhe ju lutem që të jemi shumë seriozë në çështjet e zbatimit të rregullave ligjore dhe Rregullores së Kuvendit. Unë po e them shumë shkurt dhe shqip, po dua t'i bie si shkurt, pa hyrë në çështjet tjera formale - me këtë vendim, të cilin e ka

marrë Kryesia dhe thotë e ka nxjerrë në votim, është shkelur Rregullorja e Kuvendit të Kosovës. Askush nuk mund t'ia ndalojë, madje as seanca parlamentare, nuk mund të bëjë shkelje të rregullës në kuptimin e procedurës së Kuvendit, përveç nëse e ndryshojmë Rregulloren. Nëse e ndryshojmë Rregulloren dhe themi që ligjet mund të shqyrtohen edhe vetëm në një komision, e jo në komisionet që janë të parapara me të, atëherë OK-ej. Përndryshe, shmangia është bërë vetëm në aspektin kohor, në afatin kohor, por jo edhe në aspektin procedural. Prandaj, ju lutem shumë, nuk ka krisur kiameti, që ky Parlament ta marrë një vendim që Komisioni i Përhershëm, ai për Legjislacion, ta shqyrtojë këtë çështje për një 10-15 minuta, të shtyhet seanca dhe asgjë askujt.

Seanca thjesht mund ta marrë këtë vendim dhe duhet ta marrë këtë vendim. Unë i kam dëgjuar dhe po i dëgjoj edhe deputetë duke thënë 'hajt, se nuk ka gjale', 'hajt se është fillimi dhe nuk ka dert'. Një fjalë e popullit thotë kur të kalojë një herë miu nëpër mustaqe, e mëson udhën dhe badihava është. Kështu që na nuk e kemi asnjë drejtë ta shkelim Rregulloren e Kuvendit. Zoti kryetar, ju lutem, edhe pa e nxjerrë në votim, por nxirreni edhe në votim, kjo çështje duhet të kalojë nëpër Komisionin Funksional. Nuk ka mundësi të shqyrtohet ligji më i rëndësishëm vjetor i Parlamentit, që e sjell Qeveria, pa trajtimin nga Komisioni për Legjislacion. Faleminderit!

KRYTEARI: Faleminderit!

Për korrektësi, këto procedura, në të njëjtën kohë edhe precedentin nuk e kam sjellë unë, e kam gjetur këtu te ju. Të paktën edhe dy herë kanë ndodhur po të njëjtat raste. Armend Zemaj e ka fjalën, pastaj kalojmë në votim.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Kryetar, unë ju kisha lutur që t'i merrni në shqyrtim praktikën e mira, e nëse ka aso të këqija që i ka bërë Kryesia e kaluar, nuk do të thotë që edhe ju duhet t'i përsëritni. Kështu që është mirë - merri ato që i thotë Rregullorja e Kuvendit dhe të takon ty edhe në bazë të pozicionit çfarë e ke, që ta respektoni Rregulloren e Kuvendit në tërësi, pa marrë parasysh afatet apo tendencat që mund të jenë nga ndonjë subjekt i caktuar politik, qoftë ai pozitë, a opozitë. Ju jeni ai që e mbron Rregulloren e Kuvendit, sidomos brenda seancës plenare, dhe kjo është ajo çfarë po kërkojmë, asgjë tjetër.

Lexojeni shmangien çka thotë, e nuk ka të bëjë këtu me çështjet që ne po i quajmë politike, është çështje procedurale dhe e respektimit të Rregullores së Kuvendit në tërësi për të gjitha nivelet. Kjo ka të bëjë edhe me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e deputetit, të cilat nuk janë respektuar, në këtë rast, gjatë shqyrtimit të amendamenteve për propozim-plotesimin e Ligjit të Buxhetit vjetor. Kjo është e para. E dyta, Kryesia nuk mund të marrë vendime jashtë asaj që thuhet në Rregulloren e Kuvendit, ose në kundërshtim me vullnetin e seancës plenare, pasi seancën nuk mund ta detyroni ju që të marrë vendime në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit.

Kjo është çështje procedurale, është teknike edhe është mirë të mos krijojmë praktika të këqija, sepse kjo nuk na takon ne, pikë së pari si ligjdhënëse. Sa i përket shmangies, shmangia duhet të lexohet në tërësi, e jo vetëm pjesa e parë, por çfarë thotë komplet neni 84 i Rregullores së Kuvendit, pa marrë parasysh shmangien procedurale. Shmangia nuk

mund të bëhet në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, të cilat janë në Republikën e Kosovës dhe i ka takuar Komisionit për Legjislacion që t'i shqyrtojë amendamentet nëse bien apo jo në kundërshtim me këtë fushë. Kjo është e para.

E dyta, ne si deputetë kemi bërë edhe amendamente, të cilat nuk u janë shpërndarë deputetëve. Unë ju kisha lutur që Administrata, se ajo nuk është vetëm në shërbim të Kryesisë së Kuvendit. Mos bëni presione të qëllimshme, por amendamentet të shpërndahen ashtu siç u takon deputetëve, në bazë të Rregullores dhe të Kushtetutës së Kuvendit.

Më 24, në orën 15:20 ne kemi shpërndarë amendamentin , i cili as nuk është në raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, por as nuk i është shpërndarë deputetëve. Dhe, kjo është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit dhe kjo është direkt shkelje e të drejtave dhe përgjegjësi, që i ka deputeti si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Unë kërkoj që ai amendament t'i shpërndahet deputetëve, ta kenë para vetes, pavarësisht që nuk është futur në Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Përndryshe, ne do të kërkojmë interpretim të Rregullores, e cila i takon po të njëjtit komision, mocion për të cilin sapo po bisedojmë.

Kjo është çështje e krijimit të një praktike të mirë e jo e praktikës së keqe. Edhe njëherë po them, administrata është në shërbim të deputetëve, nuk është në shërbim të Kryesisë. Ju jeni trupë administrative, sipas Kushtetutës, jeni udhëheqje e Kuvendit, ju jeni udhëheqës i seancës plenare, asgjë më shumë, asgjë më pak, se sa një deputet i cili është ulur në këto ulëse, që ka mandatin nga populli. Andaj, mos krijoni praktika të këqija, mos merrni praktika të këqija, as nga ata që u qëndrojnë anash, po as nga ata që ju qëndrojnë mbi krye në Kryesi të Kuvendit apo nga grupet parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhur me këtë çështjen e dytë, që e përmendi deputeti Armend Zemaj, më 24 dhjetor, pra ditën e mërkurë, përderisa afati ligjor për dorëzimin e amendamenteve ende ka qenë i hapur, janë paraqitur dy amendamente nga deputetët Vjosa Osmani, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku dhe Arben Gashi.

Amendamentet janë të protokolluara në administratën e Kuvendit dhe në përputhje me nenin 21 të Rregullores së Kuvendit, administrata është e obliguar që të gjithë deputetëve t'u shpërndajë këto amendamente, në mënyrë që ato të procedohen dhe të votohen në seancë.

Fatkeqësisht, ato as nuk janë bërë pjesë e raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe as nuk janë sot pjesë e materialit, që do ta votojnë deputetët. Meqenëse, kjo është çështje procedurale, ju lus që qysh tani të vendosni që këto amendamente të hyjnë në procedurë të votimit, qofshin edhe ato të fundit, pra kur të përfundojnë të gjitha amendamentet tjera. Janë vetëm dy amendamente, mirëpo fatkeqësisht nuk janë

shpërndarë me kohë, përkundër faktit që janë paraqitur dhe proceduar brenda afatit ligjor, së paku atij afati që neve na është komunikuar si deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Po ashtu, para se të vazhdojmë tutje, dua të theksoj që raporti i Komisionit për Buxhet në fakt nuk është sjellë për votim në Komisionin për Buxhet. Këtë po e them si anëtare e Komisionit për Buxhet dhe në raportin, i cili sot gjendet para deputetëve, janë kontrabanduar më shumë se dy amendamente, që lidhen me Ministrinë e Kulturës, ku thuhet që janë votuar nga komisioni përkatës.

Kjo është shkelje flagrante, sepse ky raport është dashur të sillet në komision për votim final dhe pastaj të procedohet në seancë. Për më tepër, kur bëhet fjalë për amendamentet të cilat nuk kanë kaluar fare dhe nuk janë aprovuar në Komisionin për Buxhet. Prandaj, konsideroj që ne nuk mund të vazhdojmë tutje, derisa të sqarohet kjo çështje dhe derisa raporti bashkë me amendamentet e propozuara nga deputetët, siç u tha edhe më herët, të procedohet për një votim final në Komisionin përkatës.

Ju lutem, ne këtu s'mund të bëjmë në vazhdimësi shkelje dhe mashtrime dhe të pretendojmë se asgjë s'po ndodh.

KRYETARI: Faleminderit!

Për hir të korrektësisë, vetëm të qartësoj disa nga shqetësimet, të cilat i shprehën deputetët e nderuar.

U përmend Kryesia dhe kryetari për disa vendime, të cilat faktikisht ne nuk kemi marrë vendime, ta keni parasysh, të gjitha vendimet janë marrë nga ky Kuvend. Ne vetëm kemi dhënë propozime, pastaj u votuan në këtë Kuvend. Dhe, keni parasysh, tek çështja e mos shpërndarjes së amendamenteve tek deputetët, nuk është faji i Kryesisë as i kryetarit, për arsye se shumica e këtyre amendamenteve i janë adresuar Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ndoshta, është se ka qenë edhe koha e shkurtër që kemi pasur, por nuk është faji te Kryesia, as kryetari, as te administrata, se nuk ka bërë shpërndarjen e tillë. Vetëm ta keni parasysh.

Duke pasur parasysh se kemi pasur një votim në seancën e kaluar, për shmangie të Rregullores, duke pasur parasysh se kemi tash edhe shqetësime të arsyeshme të ngritura këtu, pikërisht për këtë çështje, atëherë ne jemi detyruar para se të vazhdojmë më tutje për këtë pikë të rendit të ditës, të kemi një votim këtu.

E lus regjinë...

(Ndërprerje e incizimit)

...Më falni, është faji im. Kemi të bëjmë me propozimin e deputetes nga Lëvizja “Vetëvendosje”, zonjën Albulena Haxhiu, mocioni-procedura... atëherë, në emër të Komisionit për Legjislacion...

Thjesht, kemi të bëjmë me mocionin në emër të deputetes Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit për Legjislacion.

Zoti Jakup Krasniqi e ka fjalën.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

JAKUP KRASNIQI: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,
Mendoj që duhet ta lexojmë drejt shmangien, që kemi votuar në seancën e kaluar.

Shmangia është bërë për t’u futur në seancë në parim leximi i Projektligjit për buxhetin e vitit 2015. Kjo është shmangia që ka bërë Kuvendi. Kuvendi dhe seanca nuk ka bërë shmangie, që projektbuxheti të mos u shkojë komisioneve të tjera, përveç Komisionit për Buxhet dhe Financa. Kjo shmangie nuk është bërë dhe nuk duhet të trajtohet si shmangie dhe konsideroj dhe mua po më vjen keq, por anëtarët e Kryesisë që janë që sa vjet anëtarë të Kryesisë, është dashur ta kenë parasysh këtë, që nuk do të duhej të anashkalohet Komisioni për Legjislacion dhe asnjë komision, për të cilët parashihet që duhet t’i shkojnë amendamentet.

Dhe, kjo vërtet nuk mund të hidhet në votim dhe nuk mund të mbivotohet, se do të ishte se Kuvendi me vetëdije po bën shkeljen e Rregullores së tij. Prandaj, mendoj se është më mirë të merret një pauzë, në mënyrë që t’i mundësohet Komisionit për Legjislacion ta trajtojë këtë dhe pas një kohe le të caktohet vazhdimi i seancës. Kjo do të ishte zgjidhja më e mirë e mundshme, duk mos shkelur as Rregulloren e Kuvendit.

KRYETARI: Profesori Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, kolegë të nderuar!
Meqë të gjitha këto mbledhje regjistrohen edhe elektronikisht edhe me letra, është mirë që të shikohet saktë se çka është thënë edhe në Kryesi dhe këtu. Edhe, atëherë interpretimet mbasandaj çfarëdo qofshin nuk mund t’i ikin germës. Për çfarëdo qoftë që vendos kjo seancë, Kryesia s’mund të marrë kurrfarë vendimi, as s’ka marrë.

Në lidhje me trajtimin e buxhetit, Kryesia ka propozuar njëzëri për seancën atë që ka propozuar në marrëveshje, në të vërtetë, ideja ka qenë e opozitës. Domethënë, ka qenë një konsensus që mund të trajtohet buxheti brenda këtij viti, bile të trajtohet me dy lexime edhe me data të caktuara. Domethënë, Kryesia asgjë s’ka vendosur, por ka propozuar në mënyrë konsensuale. Ajo që ka ndodhur si vendim, çfarë ka ndodhur, ka ndodhur në Kuvend dhe është votuar edhe këtu në Kuvend për të dy mbledhjet, është caktuar edhe kjo mbledhje sot.

Prandaj, Kryesia në ndërkohë as që ka mbajtur mbledhje, kjo sa për informacion, për kurrgjë, as për të ndaluar diçka, as për të sugjeruar diçka. Pra, ne jemi sot këtu me vendimet e Kuvendit, që i ka marrë në seancën e kaluar, i cili ka marrë vendim edhe për këtë mbledhje, prandaj, është Kuvendi që e ka thirrur mbledhjen sot, jo Kryesia. Kjo për sqarim.

Çështja tjetër, puna e komisioneve të përhershme, nuk është veç i Komisionit të Legjislacionit, po janë edhe katër komisione. Dhe, unë menjëherë i them kështu zonjës së “Vetëvendosjes”, le të kërkojë, nëse kërkoj për Legjislacion, me të njëjtën të drejtë e fuqi edhe për tri tjera, duhet ta lexojë.

Kështu që, unë mendoj se s’ka kurrfarë pengese, nuk mund të bëhet pengesë që këto komisione, vendimi i Kuvendit nuk ua ka ndaluar, është e pamundshme, nuk shkruan kurrkund ajo. Këto katër komisione të përhershme është e drejtë e tyre ta trajtojnë këtë materie. A e trajtojnë për gjysmë ore a për dy orë, është punë për ta. Kështu që Kuvendi nuk ka pse voton, se nuk ia merr atë të drejtë kurrkujt.

Meqë u shtrua edhe një problem, amendamentet që kanë ardhur prej deputetëve ose prej grupeve, kushdo qofshin ata, për çka do qofshin, nuk mund t’i ndalë kurrkush t’u jepen deputetëve. Më në fund, ata mund të mos i pëlqej Komisioni funksional ose komisionet tjera, po ata në fund të fundit, janë dokumente të seancës edhe kanë fuqinë e plotë të artikulohen dhe në seancë. Kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Ilir Deda nga “Vetëvendosje”.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Deputetë të nderuar,

Sot, në mbledhjen e Komisionit për Integrime Evropiane njëjtë është vendosur, që të njoftohet Kryesia e Kuvendit për shqetësimin e Komisionit, që nuk është që është shkelur Rregullorja, neni 57 pika 1 për shqyrtimin e buxhetit. Dhe, të njëjtën kohë të gjithë deputetët e Komisionit, të cilët ishin të pranishëm u ankuan se nuk i morën amendamentet për shqyrtim me kohë. Ne jemi takuar edhe ditën e premte, nuk i kemi pasur amendamentet dhe sot shumica e deputetëve nuk i kanë pasur të gatshme. Dhe, ka qenë vendim me konsensus që Kryesia e Kuvendit të njoftohet, se është shkelur neni 57 pika 1 e Rregullores dhe është shprehur shqetësimi, që kjo të mos na ndodh në të ardhmen.

Domethënë, është edhe komisioni tjetër, ky për Integrime, që është komision funksional, i cili është i obliguar që t’i shqyrtojë amendamentet e propozuara.

Për më tutje, në shkresën e Komisionit për Buxhet dhe Financa thuhet se ky rekomandim është përpiluar më datën 24 dhjetor. Nuk është e vërtetë, as më 26 dhjetor, në mbledhjen paraprake të Komisionit për Integrime ne nuk e kemi pasur këtë shkresë. Domethënë, nuk do të thosha se vetëm administrata, sepse kryetarja e Komisionit kishte kërkuar nga kolegët e saj dhe nuk e kishin gati as më datën 26. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Adem Grabovci nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

ADEM GRABOVCI: Nuk dua ta luaj rolin, se s'kam nevojë ta luaj rolin e avokatit të askujt, por është një e vërtetë se seanca e kaluar ka votuar për shmangie të Rregullores dhe kanë qenë decidivisht tri pika, kur janë propozuar: shmangia e Rregullores, ngarkimi i Komisionit për Buxhet dhe shqyrtimi për ditën e sotme.

Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti që kemi për ta kaluar dhe kërkesën e drejtë të Komisionit për Legjislacion, unë propozoj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, që të bëjmë një pauzë deri në orën 14:00 dhe të ngarkohen komisionet funksionale, që të bëjnë shqyrtimin dhe të vijnë me raporte dhe ne të vazhdojmë punimet e seancës. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Edhe ne jemi që të shkojmë në pauzë deri në orën 14:00 dhe të shqyrtohet në të gjitha komisionet, flas tri të përhershmet që kanë mbetur: Komisioni për Legjislacion, Komisioni për Komunitete dhe Komisioni për Integritet. Dhe, të tri komisionet le ta kryejnë punën e vet dhe ne vazhdojmë pastaj me procedimin e këtij materiali.

Po ashtu, tash ose kur të kthehemi duhet të vendosim si seancë edhe për amendamentin, që nuk është shpërndarë dhe ka qenë i gatshëm, le të shpërndahet amendamenti që është propozuar dhe u lexua nga Vjosa që kur të vijmë në seancë, procedojmë edhe votojmë për të. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”.

VISAR IMERI: Faleminderit! Së pari është e çuditshme se si u vendos nga dy grupet parlamentare tash nga kryetarët e tyre që ta kemi këtë pauzë dhe po thuhet që është pauzë për shkak të kërkesës së Komisionit, e mua menjëherë po më bie në mend pamja e daljes së Listës serbe dhe unë po them që është për ta më shumë se sa për komisionet.

Propozimi im është që ta shtyjmë për nesër seancën ku do të diskutohej buxheti dhe t'u japim kohë të mjaftueshme komisioneve tjera, tri komisioneve të përhershme që ta trajtojnë me seriozitet buxhetin e jo kështu t'i ngutim ata.

Një qartësim për atë që u tha më herët, nuk ka qenë ide e opozitës që ta bëjmë këtë shmangie, kjo ka qenë kërkesë edhe insistim i dy grupeve më të mëdha parlamentare dhe pastaj propozimi ka qenë për të arritur një konsensus që ta bëjë një distancë në mes të dy ditëve kur do të trajtohej buxheti në dy lexime, sepse kërkesa siç e dini ju që keni qenë në atë mbledhje, ka qenë që ta trajtojmë buxhetin shpejt e shpejt përbrenda tri ditëve. Pra, ka qenë që ta trajtojmë të premten dhe pastaj të mërkurën dhe ne kemi kërkuar që kjo të bëhet të hënën, mirëpo asnjëherë nuk është diskutuar në mbledhje të Kryesisë, të gjithë ata që kanë qenë, që do t'i shmangim njëkohësisht edhe komisionet e përhershme.

Është diskutuar që do ta shkurtojmë afatin e Rregullores, por jo edhe komisionet. Dhe, në këtë drejtim konsideroj që kanë plotësisht të drejtë komisionet të gjitha njëzëri që po e kërkojnë trajtimin e raportit me amendamente të buxhetit të Republikës së Kosovës, kështu që propozimi ynë është që seancën ta shtyjme për nesër, jo për orën 14, në mënyrë që këto komisione ta kenë kohën që të mbledhen dhe ta trajtojnë me seriozitet buxhetin.

KRYETARI: Adem Grabovci, replikë, 2 minuta!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar! Nuk kam nevojë 2 minuta, por për kolegun. Qëndrimi i Grupit Parlamentar ishte, mendoj shumë i drejtë dhe është dëshmia më e mirë që Grupi Parlamentar, pa marrë parasysh se kush propozon diçka, ide të mira, konstruktive i jep mbështetje dhe në rastin konkret e them me përgjegjësi të plotë se nuk ka pasur asnjë ndikim tjetër, përveç kërkesës së drejtë të Komisionit për Legjislacion që t'u mundësohet komisioneve tjera ta marrin në shqyrtim këtë ligj dhe të procedojmë më tutje.

Ndërsa për Listën serbe, absolutisht unë nuk kam kërkuar dhe nuk kam nevojë që të bisedoj me askënd e as ta lus askënd. Jemi deputetë të barabartë të Kuvendit të Kosovës dhe jemi të obliguar të gjithë pa përjashtim të marrim pjesë në seancë. Prandaj, edhe një herë po them se nuk është e vërtetë ajo, po vetëm që të ecim më tutje.

KRYETARI: Po ashtu, për replikë Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Unë mendoj që vërtet është edhe jo serioze edhe është fyese për t'i lidhur gjërat kësisoj. Nëse ka qenë një kërkesë e juaja në këtë rast, e kryetarit të Komisionit dhe në ndërkohë është parë e arsyeshme që kjo është e arsyeshme të shqyrtohet çka ka lidhje kjo me Listën serbe dhe mendoj që nuk keni nevojë se në këtë formë nuk fitohen poenët politikë, mos fyeni sepse fundi i fundit edhe ata janë deputetë, po ne nuk kemi nevojë për t'u konsultuar me askënd. Ne si grup e shohim të arsyeshme që të shqyrtohet ky projektbuxhet edhe në komisionet tjera dhe kaq, të tjerat janë spekulime.

KRYETARI: Kundër-replikë Visar Ymeri, një minutë!

VISAR YMERI: Unë vetëm evokova edhe një herë atë që ka ndodhur në formimin e Qeverisë. Ju kujtohet ajo farë pauza e famshme për të shkuar në Rashkë e për t'u kthyer, pse i keni lutur atëherë për Qeveri, ju i keni pasur numrat, e keni pasur shumicën shqiptare, tash po thonë neve s'na e ndien për ta. Po pse atëherë i lutshi për Qeveri, pse bëjshi marrëveshje me ta? Pse ua pranojshit pikat atyre?

KRYETARI: Atëherë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Para se të procedojmë tutje kryetar, edhe unë konsideroj që duhet t'i japim fund shkeljeve të vazhdueshme të cilat po bëhen nga ky Kuvend dhe për të mos filluar me shkelje në fakt. Pajtohem plotësisht me kërkesën e Komisionit për Legjislacion, por para kësaj konsideroj që raporti për buxhetin të cilin duhet ta trajtojmë

në Kuvend duhet të aprovohet në Komision për Buxhet, përndryshe llogaritet që është kontrabanduar dhe është i pa autorizuar nga anëtarët e buxhetit, Komisionit për Buxhet. Dhe, për më tepër po e përsëris edhe një herë që kanë kontrabanduar amendamente. Ju lutem, edhe këtu kurrkush s'po jep llogari për këtë. Do të thotë është sjellë një buxhet dhe janë shtuar amendamente të kontrabanduara, të cilat nuk janë votuar në komisionin përkatës në emër të Komisionit. Dua të m'i sqarosh disa gjëra para se të procedojmë tutje.

Konsideroj që në këto kushte ne nuk mund të vazhdojmë me seancë sot për derisa t'i plotësojmë kërkesat e parapara me Rregullore të Kuvendit dhe po ashtu me legjislacionin në fuqi.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "Nisma" foli! Grupi Parlamentar "6+" a ka diçka për të shtuar? Po, urdhëroni fjalën!

MÛFERRA ŞİNİK: Faliminderit, zoti kryetar!

Sayın başkan, bugünkü bu tartışmaları göz önünde bulundurarak 2 – 3 saat'lık bir araya ihtiyacımızın olduğunu belirtmek istiyoruz. Aynı zamanda 6 + Parlamenter Grubu hava şartlarını da göz önünde bulundurarak bugün bu toplantının sonuçlanmasını öneriyoruz. Teşekkür ediyorum.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, jemi tek propozimi i Grupit i Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për shtyrjen e seancës për orën 14.

Atëherë, a të shkojmë në votim të drejtpërdrejtë, në mënyrën a jeni për propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për shtyrjen e seancës për ora 14? Ju lutem votoni me ngritjen e dorës.

Kush është kundër të propozimit të Adem Grabovcit?

A ka abstenim? Vetëm një sekondë, ju lutem!

Nga 95 deputetë prezentë në sallë, 68 kanë votuar për. Do të thotë në orën 14 vazhdojmë seancën, ndërkohë, komisionet komunikojnë në mes veti, komisionet e përhershme, Komisioni për Buxhet dhe Financa komunikon edhe me 3 komisionet e përhershme në mënyrë që të kemi një vazhdimësi të rregullt të seancës. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Së pari, i falënderoj komisionet përkatëse për punën që e kanë kryer. Në të njëjtën kohë dëshiroj të kërkoj falje për vonesën, megjithëse ka qenë objektive, e nuk ka qenë e varur nga kryetari i Parlamentit, apo nga Kryesia.

Si do që të jetë, vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme, në pajtim me vendimin e Kuvendit, më 29 dhjetor 2014 e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar pjesën tekstuale të projektligjit, pjesën tabelare dhe të gjitha kërkesat që janë adresuar Komisionit për Buxhet dhe Financa, si dhe ato institucione të pavarura të nivelit qendror, pra të ministrive dhe të pushtetit lokal.

Po ashtu, komisioni i ka shqyrtuar edhe amendamentet e propozuara nga deputetët dhe nga grupet parlamentare.

Sa u përket amendamenteve, duhet theksuar se pothuajse të gjitha ato nuk i përmbushin kushtet teknike për hartimin e një amendamenti.

Një pjesë e amendamenteve është kërkuar që të ndahen mjete buxhetore për financimin e projekteve të caktuara kapitale, ndërkaq shuma e kërkuar është shënuar në arsyetimin e amendamentit, e jo në pjesën e dispozitave, ashtu siç kërkohet.

Po ashtu, shumica e amendamenteve që i janë referuar pjesës tabelare përmbajnë kërkesa për ndarjen e mjeteve shtesë buxhetore, por nuk janë të specifikuara për mënyrën e inkorporimit të tyre në buxhet, mungojnë referenca në kodet, në tabela dhe kategoritë përkatëse ekonomike. Dhe, ajo që është më e rëndësishme, për kërkesat e parashtruara nuk kemi propozime për shkurtimin e Buxhetit, kur dihet se për çdo ndryshim të propozimit duhet të bëhen shkurtime të brendshme.

Deputetët dhe subjektet që i kanë bërë amendamentimet duhet ta dinë se nuk mund të tejkalohen kufijtë e përgjithshëm të shpenzimeve, pasi do të shkelej rregulla fiskale e

kufizimit të deficitit buxhetor prej 2%, që e parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike.

Konsideroj që Kuvendi duhet të organizojë trajnime të duhura për deputetët, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e amendamenteve. Komisioni, nga raporti që e keni para jush, i ka bërë gjithsej 64 amendamente dhe 255 ndryshime. Unë jam i obliguar që ta falënderoj komisionin për angazhimin e jashtëzakonshëm, duke marrë parasysh që në rrethana tjera ai e ka në dispozicion një muaj, kurse në këtë rast i kemi pasur dy ditë, duke e përfshirë edhe ditën e tretë, meqë sot i mbajtëm dy mbledhje, në mënyrë që sot ta sjellim para deputetëve një raport me ato ndryshime, të cilat e kompletojnë Buxhetin e Kosovës, e që krijon mundësi që Qeveria të punojë në bazë të këtij Buxheti.

Unë do të jem i gatshëm të sqaroj për çdo amendament, i cili do të duhej të sqarohej, por atë që dëshiroj ta them është që deputetët e Parlamentit të Kosovës do të bënin mirë sikur ta votonin Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin fiskal 2015. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti Osmani!

Pas kësaj paraqitjeje të raportit nga Komisioni Funkcional, të drejtën për diskutim e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme. Shkojmë me radhë. Së pari Komisioni për Legjislacion, zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në mbledhjen e mbajtur e shqyrtoi raportin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Si kryetare e këtij komisioni, unë shpreha shqetësimin për shkurtimin e Buxhetit për institucionet e drejtësisë. Pra, përveç që as 2% e Buxhetit total nuk ndahet për sistemin e drejtësisë, në amendamentet që i kemi para nesh kemi vërejtur shkurtim të këtij Buxheti. Për shembull, Prokurori i Shtetit, nga 30 mijë euro furnizim me makina fotokopjuese, u ndryshua në shumën zero. Në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale shuma 173 mijë u ndryshua në shumën 143 mijë euro.

Sa i përket Këshillit Gjyqësor të Kosovës, shuma prej 200 mijë eurove furnizim me kompjuter, server dhe pajisje tjera të teknologjisë informative ndryshon në zero. Pajisje të sigurisë dhe video të vëzhgimit, shuma prej 50 mijë eurove ndryshohet gjithashtu në zero. Sekretariati i KGJK-së, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, nga 2 milionë euro ndryshohet në shumë prej një milionë e 750 mijë euro, pra 250 mijë më pak. Pra, gjithsej 560 mijë euro i kanë hequr nga institucionet e drejtësisë. Këtu e kam fjalën vetëm për Këshillin Gjyqësor dhe për Prokurorinë e shtetit. Në kohën kur sistemi i drejtësisë ballafaqohet me probleme të shumta, ne nuk kemi rritje të këtij buxheti, mirëpo zvogëlim dhe shkurtim të tij.

Gjithashtu si kryetare e komisionit shpreha vërejtjet e mia te Fondi i Veriut, i cili është në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse është një fond paralel dhe gjithashtu me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Por, edhe se

në nenin 9, paragrafi 3 i Buxhetit, kërkohet që të gjitha mjetet e grumbulluara të pasqyrohen në tabelat buxhetore, përfshirë këtu edhe mjetet e grumbulluara në pikat doganore në veri të Kosovës, por te pjesa tabelare nuk ka asnjë informatë për shumat që priten të derdhen në këtë fond gjatë këtij viti dhe shumat e derdhura në vitin paraprak.

Dhe, problemi i tretë konsiderohet te amendamenti 2 i raportit të Buxhetit, pra financimi i RTK-së, i cili është në shpërputhje edhe me këtë ligj të Buxhetit, mirëpo edhe me atë të RTK-së, sepse këtu thuhet që për një periudhë transitore 3-vjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi, RTK-së çdo vit i ndahen 0,7% e të hyrave nga Buxheti i Kosovës, duke i përjashtuar këtu të hyrat nga proceset e privatizimit, të hyrat e njehershme për Buxhetin e Kosovës dhe të hyrat vetjake të nivelit qendrorë dhe lokal. Pra, kjo periudhë transitore përfundon në prridhin e vitit 2015 dhe ka qenë përgjegjësi e menaxhmentit të RTK-së që të gjejë mekanizma për mbledhjen e parapagimit, mirëpo këtë nuk e ka bërë.

Pavarësisht vërejtjeve të mia si kryetare e komisionit, ka pasur edhe vërejtje tjera nga anëtarët e Komisionit për Legjislacion, mirëpo për shkak të përbërjes së tij, ky raport u votua me 5 vota për dhe 4 abstenime. Kësisoj, Komisioni për Legjislacion rekomandon që Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm. Në ndërkohë e merr përgjegjësinë që gjatë rishqyrtimit të Buxhetit të kërkoj që të plotësohen kërkesat e Këshillit Gjyqësor, Prokurorisë së Shtetit, Instituti Gjyqësor, Agjencisë Kundër Korrupsionit. Pra, që Buxheti të ndahet në përputhje me nevojat e kërkesat që i kanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj Komisionin për Integritet, zonjën Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit!

Komisioni për Integritet Evropian, në fakt, sot i ka mbajtur tri mbledhje, një në orën 8:30 në mëngjes, dhe dy mbledhje tjera pas pauzës. Në pjesën e parë i shqyrtuam 60 amendamente, të cilat ishin të parashtruara më herët, ndërsa në mbledhjen e orës 13:30 i shqyrtuam edhe 4 amendamente tjera, të cilat më vonë u shtuan nga Komisioni i Buxhetit.

Anëtarët e komisionit kanë diskutuar për Buxhetin dhe më lejoni që të ju paraqes rekomandimin e Komisionit për Integritet Evropian.

Pra, Komisioni për Integritet Evropian, në bazë të nenit 57, paragrafët 1 dhe 8 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor, e shqyrtoi raportin plotësues për Projektligjin numër 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe vendosi që atij komisioni t'ia paraqesë këtë rekomandim:

Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Amendamentet plotësuese të propozuara nga Komisioni Funkcional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin primar dhe sekondar të BE-së, përkatësisht me ‘acquis communautaire’ të BE-së.

Në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 nuk është paraparë pavarësia buxhetore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kërkesë e Raportit të Progresit dhe Planit të Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, që kishin propozuar që në buxhetet e ardhshme dhe në rishikim kjo çështje të shqyrtohet dhe të kihet parasysh.

Buxheti i ndarë për vitin 2015 për Ministrinë e Integrimit Evropian, krahasuar me projeksionin e viteve 2016 dhe 2017 është më i madh, prandaj do të duhej të kishte një sqarim nga Ministria e Integrimit Evropian për projeksionet, apo vlerësimet për vitet 2016 dhe 2017. Po ashtu, kjo ministri nuk ka paraparë asnjë projekt për vitin 2015.

Mungesa e pjesës narrative apo përshkruese e shifrave tabelare e kanë bërë mjaft të vështirë analizimin e Projektligjit për Buxhetin, prandaj në të ardhmen do të duhej të përcillej me narrativ, përkatësisht me përshkrim.

Shqetësuese mbetet edhe mungesa e ndarjes së mjeteve financiare për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 për arritjen e objektivave të parapara për Planin e Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Arsyetimi: Të vetëdijshëm për vendimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me vullnetin e Komisionit për Integrit Evrope, ta japë kontributin e vet në shqyrtimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, në mbledhjen e sotme e shqyrtuam Projektligjin për Buxhet dhe vlerësuam se dispozitat e projektligjit nuk janë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit primar dhe sekondar të Bashkimit Evropian.

Në fakt, legjislacioni i Bashkimit Evropian nuk ka direktiva sa u përket buxheteve të shteteve të veçanta, por ne në komision, përveç kësaj, kemi tentuar që të analizojmë edhe dokumente, të cilat vetë Kuvendi i Kosovës dhe shteti i Kosovës i kanë miratuar.

Komisioni po ashtu i shqyrtoi edhe amendamentet plotësuese, të propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe vlerësoi që amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim me ‘acquis communautaire’. Pavarësisht se Projektligji për Buxhet nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e Bashkimit Evropian, Komisioni për Integrit Evrope e shqyrtoi këtë projektligj nga perspektiva dhe dinamizimi i proceseve integruese, në të cilat vendi ynë do të jetë në vitet pasuese. Prandaj, Komisioni i paraqet këto shqetësime, duke shpresuar që të ruhet më tej konsensusi dhe dinamika jonë në procesin e integrit evropian dhe propozon që të votohet Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2015.

KRYETARI: Faleminderit!

Komisioni për Komunitete? Kryetari mungon. Atëherë vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

(Reagime nga salla)

Nuk ka nevojë! Përfaqësuesi i Qeverisë? OK! Donika është e lajmëruar.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Kryetar, e kam kërkuar fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës. Faleminderit!

Ndërmjet dy leximeve, Buxheti i Republikës së Kosovës si instrument kryesor i aksionit ekonomik të Qeverisë nuk ka pasur asnjë ndryshim substancial, përveç se është trajtuar si pronë që i takon Qeverisë, e cila edhe e ka shpërndarë kryesisht bazuar në nevojat dhe prioritetet e pushtetit dhe në kundërshtim me parimin e shpërndarjes sipas interesit të qytetarit dhe kriterit të kthimit të taksave të qytetarët sipas kontributit dhe nevojës.

Me këtë projektbuxhet, ju u thoni qytetarëve të Kosovës se nuk do të ketë ndryshim të gjendjes, por vazhdim të saj. Me një projektbuxhet që e përjashton rritjen e pagave, do të thotë që qytetarët nuk do të mund të presin zhvillim ekonomik dhe as përmirësim të gjendjes së tyre ekonomike. Ju, nëpërmjet kësaj qeverisjeje, duke mos paraparë as në lexim të dytë asnjë masë për rritjen e të hyrave, po e konfirmoni vazhdimin e korrupsionit, të ekonomisë joformale dhe krimin të organizuar.

Nëse nuk ka investime, siç e konfirmoni edhe në këtë përmbyllje të Buxhetit, do të thotë se nuk do të ketë as hapje të reja të vendeve të punës. E nëse nuk ka vende të reja të punës, do të thotë se do të ketë më shumë varfëri dhe rritje të pakënaqësive sociale. Natyrisht se me një gjendje të tillë qytetarët nuk do të ndalen së ikuri nga vendi, çka do ta shtyjë edhe procesin e liberalizimit të vizave dhe daljen e Kosovës nga izolimi, ku e ka futur Qeveria e kaluar, dhe vazhdimin e të cilit izolim ju po e paralajmëroni edhe nëpërmjet këtij projektligji, i cili nuk ka ndryshuar aspak nga leximi i parë.

Kjo shihet edhe në dy veprime ndërmjet dy leximeve të këtij projektbuxheti, meqë ju po vazhdoni të provoni ta mashtroni opinionin, ashtu siç bëri edhe partneri juaj i koalicionit. E para, deklaruat që kursyet duke ndaluar blerjen e veturave, të telefonave dhe lukseve tjera për 6 muajt e parë të këtij viti. Dhe, çka pas 6 muajsh, ministër? Do të thotë, do të blihen përsëri. Do të thotë se ju po i kurseni paratë e qytetarëve për 6 muajt e parë për t'i shpenzuar në 6-mujorin e dytë, e ky nuk është kursim. Ky është vetëm një mashtrim, të cilin po e bëni tash në këtë krizë kur sindikatat, i gjithë opinionin po kërkon që ju t'i zbatoni vendimet e marra më herët.

Përndryshe, pse nuk vendosët që të kurseni gjatë gjithë vitit 2015 dhe gjatë gjithë mandatit, në fakt. Pse të mos i blejnë telefonat ministrat, zëvendësministrat, e gjithë armata e militantëve tuaj nga rrogat e veta? Pse duhen miliona euro të jepen për të blerë telefona. Nuk është prioritet i Kosovës ky.

Dhe mashtrimi i dytë, kur po pretendoni se po i rritni pagat, duke u thirr në 0,5% të rritjes që vjen nga përvoja e punës, kjo nuk është rritje. Ky është një obligim ligjor, të cilin ju duhet ta zbatoni.

Mos harroni, të nderuar, se ju e bartni përgjegjësinë që t'i zbatoni vendimet dhe projektet e Qeverisë së kaluar. A nuk e thatë vetë që obligoheni t'i përmbaheni parimit të vazhdimësisë së realizimit të projekteve. Edhe ne pajtohemi, por jo duke mashtruar, jo duke vazhduar aty ku e lanë të tjerët, e ku projektet lidhen kryesisht me tenderë me përqindje, e kursesi me zhvillim e me mirëqenie. Për shembull, nëse duhet të ketë vazhdimësi me projektet që lidhen me ndërtimin e rrugëve, që po besojmë se do të vazhdojnë, duhet të ketë vazhdimësi edhe në vendime dhe në realizimin e tyre, që lidhen me çështjen e pagave.

Këtu po dua të ndalem, te vendimi, i cili është nënshkruar nga ish-kryeministri e tani ministër i Punëve të Jashtme, Hashim Thaçi, më 18 mars 2014, bashkë me partnerët e Këshillit Ekonomiko-Social të Kosovës. Prandaj, ne sot kërkojmë që ky vendim të implementohet në tërësi dhe Kontrata Kolektive, duke siguruar buxhet në shumën prej 100 milionë eurove dhe atë: 90 milionë euro për rritjen e pagave prej 25% për të gjitha kategoritë, e ju sot mund të qeshni, por nuk do të qeshni kur sindikatat të ju ballafaqojnë, sepse është vendim i marrë, e nëse atëherë nuk e keni ditur, ose sot nuk po dini ku t'i merrni paratë, kryeministër Mustafa pyete Hashim Thaçin - ndoshta ky e ka pasur parasysh ku do t'i merrni ato mjete. Ndoshta ka vendosur t'i kthejë të vetat; dhe 10 milionë euro për realizimin kostos buxhetore që implikojnë dispozitat e tjera të Kontratës Kolektive.

Kërkesat e Këshillit Ekonomiko-Social të Kosovës janë të bazuara në ligj dhe në drejtën e punëtorëve të të gjitha kategorive për t'i realizuar të drejtat e tyre konform ligjeve në fuqi. Për më tepër, marrëveshja për zbatimin e Kontratës Kolektive, po e ritheksoj, është nënshkruar nga Qeveria e kaluar, në mars të këtij viti, pak para zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Aleanca konsideron që 80 000 punëtorët e përfaqësuar nëpërmjet sindikatave nuk guxojnë të mashtrohen dhe të shfrytëzohen vetëm për qëllim të fushatave, por institucionet duhet të jenë të përgjegjshme, të japin llogari para qytetarëve, duke i zbatuar vendimet dhe duke i respektuar ligjet.

Ne kemi ofruar edhe propozimin për burimin për financim, duke i kërkuar Qeverisë që ta zvogëlojë numrin e ministrive për 1/3. Qeveritë e mëdha, jo vetëm në prani, por edhe në organizim janë financiarisht të kushtueshme dhe jofunksionale. Sot, në këto rrethana, Qeveria juaj në nivelin qendror shpenzon 460 milionë euro të qytetarëve të Kosovës për paga, mëditje, dreka, darka, mallra e shpenzime. Zvogëlimi i vetëm 1/3-tës së dikastereve qeverisës do ta kursente Buxhetin e Kosovës për rreth 150 milionë euro, ndërsa zbatimi i përgjithshëm i vendimit për rritjen e pagave dhe zbatimin e Kontratës Kolektive kushton rreth 100 milionë euro, që do të thotë edhe kërkesat për transfere sociale do të mund të mbuloheshin nëse kjo Qeveri reflekton sado pak për interesat e qytetarëve.

Mos harroni që shuma e ndarë për rastet sociale nuk ka ndryshuar prej vitit 2012 dhe të gjithë e dimë sa janë rritur çmimet prej atëherë. Një ndihmë sociale sot nuk mjafton as për të blerë bukë të thatë, e lëre më artikujt tjerë shtesë. Po ashtu, të mos harrojmë që Kontrata Kolektive parasheh edhe zbatimin e Ligjit të punës për sektorin privat, ku njerëzit punojnë 8 orë, ndërsa paguhet 200 euro, e ku nuk zbatohet asnjë e drejtë e tyre për pushim, sigurim, e madje nuk e kanë asnjë përkrahje nga shteti as në rastet e

fatalitetit. Këtë vit, 8 punëtorë e kanë humbur jetën në punë. Unë pyes çfarë do të ndodhë me familjet e tyre?

Andaj, të nderuar kolegë deputetë, po ju drejtohem juve, sepse ky vendim do të jetë në dorën e çdo deputeti. Të veprojmë sot konform interesave të qytetarit. Kemi përgjegjësi të reflektojmë shtrenjtimin e jetës pahetueshëm dhe ngadalë nga viti në vit. Të gjithë po e shohim se çmimet po rriten. Për shembull, faturën e energjisë elektrike të gjithë po e paguajmë 5-fish më të shtrenjtë se në vitet e kaluara. Ushqimi, madje produktet bazë, janë rritur. Shiheni indeksin e çmimeve vetëm për muajin nëntor. Rroga e një arsimtari, rroga e një polici, rroga e një ushtari, rroga e një zonje ose zonjushë që punon në market, rroga e një infermiereje nuk e përballon koston e jetës, sepse çmimet janë rritur me shumëfishin e pagave.

Duke e votuar amendamentin e propozuar nga Aleanca, do t'i përkrahim nevojat e këtyre njerëzve, do ta përmirësojmë mirëqenien e tyre, do ta ndalim ikjen nëpër korridoret e errëta të qytetarëve, të cilët të zhgënjyer dhe të mashtruar nuk po zgjedhin rrugë dhe, mbi të gjitha, vota e juaj, të nderuar kolegë deputetë, për këtë amendament do të jetë një leksion për Qeverinë që të përgjigjet për vendimet e marra, që t'i zbatojë ato, të instalohet një llogaridhënie dhe të ndërpritet ky trend i mashtrimit dhe i humbjes së integritetit. Duke ju falënderuar, edhe një herë kërkoj përkrahjen për amendamentin e dorëzuar nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për rritjen e pagave për 25%, për zbatimin e vendimit të marrë në mars të këtij viti dhe zbatimin e përgjithshëm të Kontratës Kolektive. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “6+”, Kujtim Paçaku e ka fjalën.

KUJTIM PAÇAKU: Faleminderit kryesues!

Ju përsëritës i nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë shfletova sot disa amendamente dhe u ndala në amendamentin numër 35. Në mënyrë të hapur diskriminohet komuniteti. Do t'ju lexoj këtë amendament, i cili në vazhdim thotë - është shkurt, vetëm një minutë do t'ju marrë zoti Beqiri.

KRYETARI: Zoti Kujtim, do të vijmë te amendamentet me rend. Lexoje, por mundësisht sa më shkurt!

KUJTIM PAÇAKU: Është amendament, vetëm t'ju lexoj: “Komuna e Istogut me kuotë 633, nën program bujqësi - Istog, me kod 470170, në tabelën 4.2, në projektin me kod 41165, të fshihet fjala “magjupit”. Deri kur më do të diskriminohemi me këtë fjalë. Sot të fshihet! Nuk është dashur as të ekzistojë kjo fjalë. Besoj fuqishëm në deputetët, që as ta përdorin, as të gjendet e shkruar në këto dokumente. Besoj që me ndihmën tuaj do ta eliminojmë këtë term pezhorativ, i cili e diskriminon më tepër komunitetin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kërkojmë falje publikisht, megjithëse qenka përmirësuar, por si do që të jetë kërkojmë falje dhe nuk është mirë të ndodhin gjëra të tilla. Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i votojmë me ngritje dore, kurse për amendamentet e propozuara nga deputetët, pa përkrahje nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, shkojmë me votim elektronik.

Para se të futemi në procesin e votimit, kisha pasur dëshirë të votojmë për praninë e deputetëve në sallë. Ftoj regjinë të përgatitet për praninë e deputetëve në sallë. Ju kisha lutur për votim, për prani! Atëherë, në sallë janë të pranishëm 95 deputetë. Shkojmë në votimin e amendamenteve, në rend të parë në pjesën tekstuale të projektligjit.

Amendamenti 1, kush është për?
Aprovohet me shumicë.

Amendamenti nr. 2, kush është për? Deputetë, ju lutem koncentrohuni! Shumica është për amendamentin 2. Edhe një herë, ju lutem! Atëherë shkojmë me procedurat e rregullta. Edhe një herë, në qoftë se dëshironi shkojmë me votim elektronik, më mirë.

Jemi te amendamenti 2. Ju lutem për votimin e amendamentit nr. 2.

66 për, 26 kundër, kemi dy abstenime.
Kalon amendamenti.

Shkojmë tek amendamenti nr. 3. Lus regjinë, a jemi gati për votim? Votojmë!

Amendamentin 3, ju lutem!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

Atëherë, amendamenti 3 kalon me 70 vota për, 16 vota kundër, asnjë abstenim.

Shkojmë tek amendamenti numër 4. Lus regjinë të përgatitet për votim. Kush është për?

Atëherë, me 73 vota për, 21 kundër, 1 abstenim, kalon amendamenti numër 4.

Shkojmë, amendamenti numër 5. Deputeti Besnik Bislimi ka arsyetimin e amendamentit pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Urdhëro, deputet!

BESNIK BISLIMI: Faleminderit!

Unë nuk e di se përse komisioni nuk e ka përkrahur këtë amendament, kur është vetëm i natyrës teknike. Sa për rikujtim, në versionin ekzistues të projektligjit thuhet, si vijon:

Në pikën 3 të nenit 10, punonjësit e organizatave buxhetore, të institucioneve të pavarura, që kanë pagat e tyre jashtë sistemit të pagave të shërbyesve civilë, nuk mund të

shfrytëzojnë të drejtën për shujta, kompensime të tjera dhe rritjen prej 30%, sipas vendimit të Qeverisë.

Kjo rritje ka ndodhur para katër vjetëve dhe logjikisht mund të figurojë vetëm në buxhetin e vitit 2011, por nuk ka kurrfarë logjike që kjo të përsëritet vit pas viti. Me këtë logjikë edhe në vitin 2009 kemi pasur të njëjtin nen, ku thotë: “në bazë të vendimit të Hashim Thaçit, në 2010-tën s’ka rritje të pagave, për shujta dhe punëtorë që janë jashtë sistemit.”

Është i natyrës teknike, është një lapsus që ka rrjedh dhe unë vetëm kam kërkuar që të korrigjohet kjo, nuk ka kurrfarë implikime buxhetore, andaj nuk kuptoj pse Komisioni nuk ka vendosur ta mbështesë. Sigurisht, se as nuk e kanë lexuar, sepse kanë qenë shumë të preokupuar si t’i shtynë punëtorët e vet në projektet që kanë pasur vetëm gjenerim të punësimit për ta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, lus regjinë të përgatitet për votim! Votojmë tash!

Me 56 vota kundër, 34 për dhe 4 abstenime, nuk miratohet ky amendament.

Kalojmë tek amendamenti 6. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 91 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Kalojmë tek amendamenti 7. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

91 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet edhe amendamenti 7.

Amendamenti 8. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 87 vota për, 5 kundër, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Kalojmë tek amendamentet në pjesën tabelore të projektligjit.

Amendamenti 9. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 75 vota për, 12 kundër, 6 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10. Lus regjinë të përgatitet për votim! Votojmë tash!

Me 85 vota për, 5 kundër dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 83 vota për, 4 kundër, 4 abstenime, miratohet amendamenti 11!

Amendamenti 12. Para se të kalojmë në procesin e votimit, ka një koment ministri Mahir Yagcilar.

(Ndërhyrje Mahir Yagcilar: Për amendamentin 13!)

Këtu e kam të shkruar 12. Sido që të jetë jemi tek amendamenti 12. Lus regjinë që të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 83 vota për, 3 kundër dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13. E kalojmë Kemi koment nga ministri Mahir Yagcilar.

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Unë nuk dëshiroj të hyj në çështje financiare, por amendamenti 13, sidomos pjesa ku është Agjencia e Shoqërisë Informative do të krijojë probleme. Jo për çështje të brendshme të Ministrisë, por edhe për funksionimin e shumë institucioneve tjera, sepse bëhet zvogëlimi prej 2 milionë e 250 mijë euro vetëm 200 mijë.

Në këtë aspekt, unë besoj që edhe në nivelin e Qeverisë edhe më tutje do të bisedojmë, sepse unë kam shqetësim për funksionimin e të gjitha institucioneve qeveritare dhe institucioneve tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit!

Unë konsideroj që duhet të votohen të gjitha amendamentet, të cilat janë të Komisionit Funkcional dhe të mos merret për bazë asnjë kërkesë përmirësimi, qoftë edhe nga ministri përkatës, sepse këto çështje mund të rregullohen brenda Qeverisë.

Prandaj, unë kërkoj që të votohet ashtu siç ka propozuar Komisioni Funkcional

KRYETARI: Faleminderit! Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Do të ishte mirë që të kemi më shumë kohë edhe në Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Medie që të trajtohen çështjet e buxhetit duke ditur që tash është krejt vonë. Mirëpo, sot më shumë se sa një shqetësim imi, ndoshta edhe i ministrit, do të ishte një shqetësim i Qeverisë dhe i Ministrisë së Integrimeve Evropiane, sepse një buxhet në reduktim kaq drastik, në 90%, se kjo erdhi me amendamente, nuk erdhi me propozimin e Qeverisë, në një segment ku kemi edhe në Raport të Progresit sfida, sa i përket E-qeverisjes, nuk është fjala për blerje të kompjuterëve, por është ndërtimi i një sistemi të tërë që e kemi edhe kërkesën nga BE.

Mendoj që duhet të jetë një shqetësim më shumë i Qeverisë dhe do të ishte mirë të ketë sqarime shtesë, se përse ka ndodhur kjo me amendamente të reduktohet 90% e buxhetit në këtë segment. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Patëm një rekomandim nga ministri dhe Zenun Pajaziti, por rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, i arsyetuar nga deputeti Naser Osmani, futet për votim.

Lus regjinë të përgatitet! Kush është për?

Me 54 vota për, 26 kundër dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Miratohet amendamenti në bazë të propozimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, se kjo ishte edhe fillesa e votimit.

Shkojmë tek amendamenti 14. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 84 vota për, 3 kundër dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15. Lus regjinë të përgatitet. Votojmë tash!

Me 83 vota për, 4 kundër, 3 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16. Lus regjinë të përgatitet. Votojmë tash!

Me 85 vota për, 2 kundër dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 82 vota për, 6 kundër, 3 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 73 vota për, 4 kundër, 8 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 81 vota për, 2 kundër, 6 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 85 vota për, 3 kundër, 1 abstenim kalon amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 82 vota për, 3 kundër, 2 abstenime kalon amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

(Ndërhyrje)

Kërkoj falje, por e votuam 22. E ka fjalën kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

NASER OSMANI: Është votuar 21. Tash jemi në 22, në prag të votimit. Unë në emër të Komisionit kisha rekomanduar kryeministrit dhe Qeverisë që kur të ndahen mjetet për komunitete të kihet parasysh përbërja e komuniteteve dhe të ndahen sipas ndonjë kriteri i cili duhet të hartohet që në këto ndarje të komuniteteve për kthim të ketë pjesëmarrje nga të gjitha komunitetet që mos të shfrytëzohen mjetet vetëm nga një komunitet, prandaj ne

nuk kemi mund ta rregullojmë, por në emër të Komisionit kërkoj që kjo çështje në Qeveri të rregullohet dhe të bëhet një kriter i shpërndarjes së këtyre mjeteve.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit zoti kryetar!

Edhe unë desha të evidentoj faktin që në të gjitha amendamentet që po i votojmë deri tani ky amendament që është për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim në fakt është nga të vetmit ku këtij dikasteri i shtohet buxheti, sepse në të gjitha të tjerat kemi parë shkurtime buxhetore. Nuk kam ndonjë kundërshtim me shtimin e buxhetit, vetëm desha të di nëse në këtë shtim të buxhetit dhe në këtë Ministri janë planifikuar jo vetëm kthimi i një komuniteti, por për shembull do të më interesonte të di shumë nëse edhe shqiptarët në veri të Mitrovicës do të mund të ktheheshin sipas kësaj Ministrie. Ky është shqetësimi im.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, jemi tek amendamenti numër 22. Më falni, e ka fjalën Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Ja se takođe slažem sa mojim kolegama poslanicima u vezi sa Ministarstvom za zajednice da se taj odnos tretira i za Bošnjacku zajednicu i za povratnike koji se vraćaju na ravnopravnoj osnovi. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Danush Ademi!

DANUSH ADEMI: Faleminderit kryetar!

Edhe unë e përkrahi kryetarin e komisionit, i cili e dha një përkrahje që buxheti në Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthim që të ndahet në mënyrë fer, sepse deri me tani asnjëherë ne nuk kemi pasur qasje në këtë buxhet, i cili është ndarë për komunitete dhe po shihet fakti vetë brenda përbrenda këtu në sallë se sa i kemi komunitetet. Unë mendoj se kësaj radhe të ndahet buxheti për komunitetin dhe të ndahen një kod i veçantë ku kishim pasur mundësi që ne komunitetet tjera ta shfrytëzojmë këtë buxhet më tutje, sepse deri më tani asnjëherë nuk ka ndodhur dhe njëherësh e falënderoj kryetarin e komisionit që na e dha një përkrahje të tillë që kemi bërë shtesat e tona për ndërtim që kemi pasur për të gjitha komunitetet në përjashtim të komunitetit egjiptian që nuk e ka përkrahur këtë ide. Unë edhe një herë e falënderoj kryetarin e komisionit për mbështetje!

KRYETARI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj që një pjesë e madhe e këtij buxheti do të duhej të shfrytëzohet që këtyre që po donë të shkojnë t’u krijojmë kushte të mbesin këtu. Nuk do të duhej që njerëzit ta shfrytëzojnë këtë buxhet, për ta shfrytëzuar këtë buxhet njëherë duhet për ta lëshuar Kosovën, e mandej për ta shfrytëzuar buxhetin. Plot njerëz nga Kosova tash po shkojnë dhe do të ishte mirë që këtyre të rinjve t’u krijojmë hapësirë për jetë, kushte për jetë dhe të mos e shpenzojmë tërë buxhetin që të vijnë ata që kanë shkuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi te amendamenti numër 22. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 57 vota për, 25 kundër dhe 6 abstenime kalon ky amendament.

Amendamenti 23.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 72 vota për, 14 kundër dhe 4 abstenime kalon amendamenti 23.

Jemi te amendamenti numër 24.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 81 vota për, 11 kundër dhe asnjë abstenim kalon amendamenti numër 24.

Amendamenti numër 25.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 86 vota për, 4 kundër dhe 1 abstenim kalon amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 71 vota për, 19 kundër dhe 5 abstenime kalon amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 71 vota për, 19 kundër dhe 2 abstenime, kalon amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 84 vota për, 3 kundër dhe 3 abstenime, kalon amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Lus regjinë të përgatitet për votim dhe Votojmë tash!

Me 83 vota, 4 kundër dhe asnjë abstenim, kalon amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 83 vota për, 5 kundër dhe 2 abstenime, kalon amendamenti numër 30.

Amendamenti 31.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!
Me 69 vota për, 17 kundër dhe 3 abstenime, kalon amendamenti numër 31.

E ka fjalën Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Komisioni i Pavarur i Medieve këtë vit do të kalojë nëpërmjet një procesi që është shumë i rëndësishëm dhe që është digjitalizimi, i cili duhet të fillojë të zbatohet prej qershorit të këtij viti, sepse është kërkesë edhe e direktivave të Bashkimit Evropian kështu që mendoj se është e padrejtë që këtij Komisioni t'i zvogëlohet buxheti kur dihet se është një proces kaq i rëndësishëm përmes të cilit ai duhet të kalojë.

KRYETARI: Lus regjinë të përgatitet për votim të amendamentit numër 32. Votojmë tash!

Me 57 vota për, 21 kundër dhe 8 abstenime kalon amendamenti 32.

Amendamenti 33.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 64 vota për, 20 kundër dhe 2 abstenime, kalon amendamenti 33.

Amendamenti 34.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 80 vota për, 4 kundër dhe 2 abstenime kalon amendamenti 34.

Amendamenti 35.

Ka të lajmëruar për diskutim, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit kryetar!

Amendamenti ka të bëjë me kërkesën e vazhdueshme që ka qenë për përkrahjen e memorialit në Koshare. Këtu është edhe një amendament i një deputeti, i cili nuk është i inkorporuar tërësisht, sigurisht ai do ta arsyetojë pas kësaj, po unë mendoj se këtu e ka vendin që të futet. Kjo zonë e shpallur me interes të veçantë si zonë e mbrojtur me vendim të Qeverisë në vitin 2011, punimet kanë filluar diku në vitin 2013, ne tash po planifikojmë për vitin 2015. Edhe nëse nuk shtohet buxheti së paku i pranueshëm që atje të ketë një konsolidim të punimeve, t'i quaj ashtu, edhe nëse nuk mund të jenë të realizueshme në tërësi, po shihet qartë që ekziston një seriozitet i përkrahjes së këtij memoriali.

Nëse këtu nuk futen në këtë shumë këtu që është e paraqitur, atëherë do të kemi problem edhe nëse kalon amendamenti, sepse atëherë prishen edhe struktura apo tabela që janë të paraqitura në projektbuxhetin në tërësi.

Unë po propozoj që të shtohet shuma edhe për rrugën e kërkuar, sepse nuk mund të kemi realizim të projektit nëse nuk ka rrugë. Aty rruga mungon, është e shembur në s'e di sa

vende dhe kjo është pjesë e vendimit të Qeverisë të vitit 2011, pavarësisht se aty flitet edhe për rrugën edhe për rrugë dytësore, por është rruga që po flasim për rrugën Botushë-Koshare, në vlerë e cila ka qenë e paraparë prej 1 milion euro, e cila as sot e kësaj dite nuk ka përfunduar.

Unë për hir të asaj se ku do të gjenden këto mjete, është kodi të ndërtimi i rrugëve të reja, që është edhe bashkëfinancim me kuvendet komunale, 10 590 dhe për mendimin tim, këtë sigurisht do ta trajtojë edhe ministri i Infrastrukturs, por edhe ministri i Financave që ka të bëjë me hartimin e projekteve dhe konsulencat teknike. Nëse Qeveria e Kosovës edhe 15 vjet pas, akoma është duke hartuar projekte për ndërtim të rrugëve të reja dhe konsulencë teknike, unë nuk e di çfarë kuptimi ka që të figurojë ajo shumë. Ne i kemi kritikuar në vazhdimësi se konsulencat teknike dhe hartimi i projekteve më shumë kanë qenë të keqmenaxhuara dhe me afera korruptive, se sa diçka që ka qenë konkrete. Andaj, propozoj që të merren këto nga kjo shumë, që është diku prej 950 mijë euro, dhe të barten te ky kompleks në dy pika që ka të bëjë me rrugën, por edhe 500 mijë euro për vazhdimin e punimeve.

Nëse kështu vazhdon çdo vit t'i kemi nga 200 mijë euro, ai projekt nuk do të kryhet edhe për 10 vjetët e ardhshme. Dhe nuk po dua të hyj tash në tema tjera pse është stërgjatur, pse është zvarritur, sepse është biseduar edhe në të kaluarën, por nuk po dua edhe, si ta quaj, ta keqpërdorim për motive të ndryshme, sepse është thënë po e kërkojnë për motive politike, e kjo s'ka të bëjë me motive politike. Kjo ka të bëjë me një memorial për lavdinë e luftës çlirimtare dhe aty janë 114 dëshmorë, pjesa më e madhe e tyre akoma është në Morgun e Prishtinës për shkak të mospërfundimit të projektit në tërësi.

Andaj, nuk priset struktura e buxhetit nëse merren nga kjo shumë dhe mund të barten pjesa më e madhe. Nëse nuk mund të bartet në tërësi, atëherë propozoj që 500 mijë euro të barten nga ky kod. Konsulenca teknike për hartimin e projekteve, të rrugëve të reja, në bashkëfinancimin me kuvendet komunale, unë nuk e di edhe cila pjesë e rrugëve ka mbetur tash për hartim të projekteve. Nuk e di çfarë projektsh kanë për të hartuar, ose çfarë rrugësh në territorin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit!

Është një çështje që e kemi diskutuar dhe për këtë është amendament 44 i deputetit Rustem Berisha, të cilin ne e kemi trajtuar me kujdes dhe deputeti në fjalë ka qenë i pranishëm gjatë amendamentimit në komision. Dhe, jemi pajtuar e jemi dakorduar që është pajtuar edhe deputeti në fjalë që për momentin të ndajmë 250 mijë euro për këtë projekt, pasi është një vendim i mëhershëm i Qeverisë që projekti të realizohet. 200 mijë euro të shkojnë nëpërmjet Agjencisë për Mirëmbajtjen e Monumenteve Memorialë dhe 50 mijë euro kanë shkuar në Ministrinë e Ambientit, në kuptimin e asaj që projekti vazhdon, ndërsa e kemi garanci që gjatë rishikimit në 6-mujor do të ndahet edhe kontingjenti i mjeteve që të mund të përfundohet aq sa mund të përfundohet në vitin 2015.

Mirëpo, këto mjete mjaftojnë që projekti të vazhdojë dhe konsideroj që nuk do të ishte mirë të preken tash tabelat se na bëhet çrregullim. Konsideroj edhe një herë që duhet votuar vetëm amendamentet të cilat e kanë përkrahjen e komisionit, e jo ato që janë pa përkrahje.

KRYETARI: Faleminderit, kryetar i komisionit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

E kërkoja fjalën edhe më herët për amendamentin 15. Bëhet fjalë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe është shqetësues fakti që është një zvogëlim i pothuajse të gjitha projekteve, të cilat kanë të bëjnë me një regjion të caktuar. Aq më tepër bëhet fjalë për një zgjerimin e auto-udhës Prishtinë-Pejë, që i ka mjetet e zvogëluara. Bëhet fjalë për rrugën Deçan-Plavë, që ka shkurtim të mjeteve. Domethënë është një gabim në qasje. Ishte edhe ministri i Punëve të Brendshme këtu. Është një zvogëlim i paarsyeshëm i mjeteve për këtë ministri.

Ndërsa për Kompleksin e Koshares, këto 250 mijë euro, që janë ndarë, janë të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor. Ndërsa Agjencia për Mbikëqyrjen e Memorialëve është agjenci në kuadër të Parlamentit të Kosovës, është agjenci e shkëputur prej Ekzekutivit. Dhe, me të drejtë, unë mendoj që duhet t'i jepet një kosto shtesë kësaj për shkak se ka nevojë, se trupat e dëshmorëve janë duke pushuar në morg tash e sa vite, dhe është e paarsyeshme të arsyetohemi se nuk ka mjete për ta kryer atë projekt, që mendoj që është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Po them edhe një herë, duhet ta kemi mirëkuptimin edhe të kryeministrit, edhe të ministrave, edhe të ne deputetëve, që këtu nuk ka të bëjë politika, por duhet ta japim një përkrahje buxhetore, sepse kanë mbetur keq tash e sa vite. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë jemi te amendamenti numër 35, gjithmonë mbetemi te propozimi i Komisionit për Buxhet e Financa. Armend Zemaj edhe një herë e dëshiron fjalën, para se të shkojmë në votim.

ARMEND ZEMAJ: Unë vetëm propozova amendament, e saktësova ku mund të gjenden këto mjete. Nëse Kuvendi vendos, unë prapë po kërkoj arsyeshmëri. Konsulenca teknike dhe hartimi i projekteve të reja për rrugë nuk është arsye që të figurojnë afro 1 milion euro dhe kjo është me bashkëfinancim me kuvendet komunale. Është kritikuar shumë kjo dhe ne jemi të gjithë të vetëdijshëm.

Unë po propozoj: prapë le të mbetet një shumë, por këtu le të merren 500 mijë euro dhe të barten në amendamentin 35. As nuk e prishë strukturën, as nuk e prish Buxhetin në tërësi. Domethënë nuk ka asnjë çështje komplekse. Të kisha lutur hidhe si propozim timin këtë amendament që të plotësohet, të merren me këtë kod që e theksova, nëse doni e lexoj edhe një herë dhe të barten aty. Nëse Kuvendi vendos ndryshe, edhe unë pajtohem plotësisht.

KRYETARI: Atëherë fjalën e ka kërkuar Adem Grabovci, të lutem, se është lajmëruar.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë së pari dua të shpreh keqardhje pse ne deri më tash nuk kemi pasur mundësi që të gjitha këto monumente t'i përfundojmë dhe vërtet dëshmorët të prehen aty ku e kanë vendin. Megjithatë, mundësitë tona kanë qenë këto që janë. Unë plotësisht e mbështes propozimin e zotit Zemaj dhe të Dautit që vërtet këtij kompleksi t'i shtrohet shuma brenda mundësive buxhetore të Buxhetit të Qeverisë së Kosovës dhe ky të përfundojë në afatin sa më të shkurtër, se vërtet dëshmorët të prehen në Koshare, atje ku e kanë vendin.

KRYETARI: Faleminderit! Rustem Berisha e ka fjalën.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Unë e kam propozuar një amendament që ka të bëjë me vazhdimin e punimeve në Kompleksin Memorial të Betejës së Koshares.

Fillimisht dua të ju njoftoj se më 9 prill të vitit 2011 është vendosur gurthemeli për Betejën e Koshares. Projekti është miratuar nga Qeveria e kaluar dhe për punimet e parapara për këtë projekt, pa e përfshirë rrugën, shuma është 4 milionë e 174 mijë euro. Deri më tani punimet që janë kryer janë 587 mijë euro, çka do të thotë se nëse vazhdojmë me këtë dinamikë të ndarjes së mjeteve nuk do të arrijmë edhe 20 vjet të tjera ta përfundojmë këtë kompleks, e në ndërkohë brenda 20 vjetëve mund të ndizet edhe ndonjë luftë tjetër, e atëherë ku ta dimë se çfarë mund të bëhet.

Çështja tjetër që dua të ngre këtu - amendamenti im ka pasur të bëjë dhe kërkoj, e ftoj kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar që ta shqyrtojnë seriozisht këtë çështje, sepse kjo çështje është urgjente. Ne tash po futem në vitin 2015, në vitin kur ende trupat e Agim Ramdanit, Sali Çekut, Xhemajl Fetahut, bëhen tre vjet që janë morg, si dhe 40% e dëshmorëve tjerë. Pra, patjetër duhet që të rritet ky buxhet. Përpos kësaj, duhet ta kemi parasysh se në Kompleksin Memorial "Beteja e Koshares" punimet nuk mund të vazhdojnë në periudhën janar-prill për shkak të kohës së keqe, por as në shtator-dhjetor. Pra, duhet të parashihet që këto punime të kryhen ndërmjet muajve prill dhe shtator. Kërkesa ime ka qenë që të ndahen krahas kësaj ndarjeje plus 600 mijë euro shtesë për vazhdimin e punimeve dhe 500 mijë euro për rrugë.

Këtu e kam parë që është shënuar që është pa përkrahjen e komisionit. Unë i falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit, se aty të gjithë e kanë votuar këtë amendament dhe e kemi pasur përkrahjen, por është diskutuar shuma e caktuar, 'nuk kem ku t'i marrim mjetet, tregoni ku t'i marrim, e unë nuk e kam pasur idenë kah do t'i marrin këto mjete, por megjithatë i lus deputetët që të vazhdojnë që kjo rritje të ndodhë dhe të aprovohet amendamenti që unë e kam kërkuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Nga sqarimi që u dha nga zoti Zemaj dhe nga fakti se nuk priset, siç u tha struktura, dhe është gjetur realisht burimi ku mund të ketë një ndryshim i tillë, edhe ne përkrahim që të shtohet për 500 mijë euro kjo pjesë për Kompleksin e Koshares. Flas si Grup Parlamentar i LDK-së.

KRYETARI: Shpejtim Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetar!

I respektuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Meqë kryetari i Grupit Parlamentar është i këtij mendimi, sepse unë mendova që e kemi te amendamenti 34, nën-programin Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, paska qenë edhe ashtu shuma prej 2 milionë euro, unë mendova që qenka rritur për 2 milionë e 250 mijë, mendova që këto 250 mijë t'i heqim prej këtu e ta kthejmë në 2 milionë prapë të njëjtën shumë dhe këtë 250 mijë ta bartim atje. Por, meqë kryetari i grupit e dha atë propozim, unë e përkrah atë propozim dhe mendoj që bënë të votojmë në atë formë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë jemi para një situatë e cila e ka një unanimitet të të gjithë për përkrahje. Kisha pasur dëshirë që përfaqësuesi i Qeverisë të paktën të na japë një mundësi, ose kryetari i Komisionit për Buxhet edhe Financa edhe një herë fjalën.

NASER OSMANI: Atëherë duhet të jemi shumë të saktë, që neni 35, paragrafi 2, nën-programi Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës me kod 279, në tabelën 3.2, shtohet projekti i ri - Vazhdimi i punimeve në Kompleksin Memorial "Beteja e Koshares" me shumë prej, ku është 200, bëhet 700, dhe zvogëlohet kodi 10590, i emërtuar 'ndërtimet e projekteve dhe konsulencia teknike' te infrastruktura rrugore.

KRYETARI: Atëherë jemi te një propozim i cili vije nga kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani. Të lutem, të mos shkojmë në radhën e diskutimeve! Ishte iniciativë e deputetit Armend Zemaj. Tani jemi para përmbledhjes së çështjes për të votuar, për arsye se kryetari i komisionit e dha një propozimin se ku merren e ku largohen mjetet. Të mos e komplikojmë. E ka përkrahjen, siç po e shoh, të shumicës të grupeve parlamentare. Mirë është të shkojmë në votim. Urdhëro, Donikë!

DONIKA KADA BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Po dua për korrektësi: meqë bëhet fjalë për amendamentin e deputetit Rustem Berisha, ju kisha lutur që ky amendament të hidhet në votim si i tillë. Do të thotë është amendament, të cilin e ka punuar, e ka propozuar dhe e ka sjellë në këtë seancë deputeti Rustem Berisha, prandaj ju thërras që të mos e komplikojmë. Nuk kemi nevojë të bëjmë propozime të reja për amendamentin që veç ekziston, ka kaluar nëpër komision dhe të hidhet në votim si i njëjti. Edhe ia shtojmë ku merren mjetet, na tregon ministri ku i marrim paratë dhe vazhdojmë tutje me amendamentin e deputetit Rustem Berisha.

KRYETARI: Ju kisha lutur për arsye se është çështje e ndjeshme, të mos e politizojmë. Kryeministri Isa Mustafa e ka fjalën, ju lutem!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Unë megjithatë propozoj që të votohet sipas propozimit të Komisionit të Buxhetit.

Projekti për studim të fizibilitetit ka të bëjë me rrugë të reja, e në këtë rast ka të bëjë me rrugën e Gjilanit dhe ne s'mund ta japim një rrugë për ndryshimet, të cilat i bëjmë këtu në mënyrë të drejtpërdrejtë. Prandaj, propozoj që të shkojë propozimi fillestar i Komisionit për Buxhet, pa ndryshime.

KRYETARI: Vetëm pak, ju lutem! Armend Zemaj e dëshiron fjalën, pastaj Rustem Berisha.

ARMEND ZEMAJ: Unë vetëm e pata për sqarim paraprakisht që ne propozuam, sepse është e pamundshme ndoshta të futen, të gjenden të gjitha mjetet që janë kërkuar edhe nga amendamenti i kolegut. Unë mendova që të gjendet kjo shumë për një projekt. Tash e kuptova edhe nga kryeministri që është për studim të fizibilitetit, për një segment të caktuar, por i cili nuk është i parashkruar këtu në Buxhet. Nuk e di çfarë kanë menduar këta. Nëse kanë menduar për atë, është diçka tjetër, por në kod buxhetor nuk është. Domethënë ka të bëjë me konsulencë teknike, hartim të projekteve, dhe është çështje e Qeverisë që nuk ka mundur ta bëjë një hartim të këtij projekti për një rrugë që është nacionale deri me tani, plot 15 vjet.

Por, si do që të jetë, unë prapë mendoj që mjaftojnë të mbeten aty 498 000 euro dhe 500 000 euro të barten në këtë pjesë. Gjatë kësaj periudhe mund të gjenden mjete shtesë, përndryshe nuk është e përcaktuar me emërtim që kërkohen për këtë pjesë. Kjo është vetëm për konsulentë teknike dhe hartim të projekteve.

KRYETARI: Faleminderit! Rustem Berisha e ka fjalën.

RRUSTEM BERISHA: Kryetar, faleminderit!

Unë edhe një herë kërkoj të jem më i qartë në kërkesë. Kërkesa ime është që të ndahen mjetet për vazhdimin e Kompleksit Memorial në shumën prej 600 000 eurove edhe 500 000 euro për vazhdimin e rrugës, se nuk është e paraparë që Ministria e Infrastrukturës të parashohë rregullimin apo vazhdimin e rrugës për "Betejën e Koshares" me vlerë 500 000 euro dhe kërkoj nga ju që të hidhet në votim.

KRYETARI: Faleminderit! E ftojme ministrin, në qoftë se na jap një zgjidhje lidhur me propozimin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës janë 2 milionë euro për ndërtimin e komplekseve memorialë. Unë propozoj që nga kjo shumë të ndahen, të specifikohen 500 000 euro për këtë qëllim dhe pjesa tjetër të mbetet për menaxhimin e komplekseve kështu siç është paraparë në këtë kuadër. Mund të flasim më shumë për

dinamikën e realizimit të projekteve brenda kësaj për të realizuar projekte të ndryshme, e që pastaj me rishikim të gjendet mundësia që të financohen plotësisht ashtu siç janë paraparë. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit kryetar!

Unë nuk dua të flas se i cilit është propozimi, por në parim e përkrah këtë propozim dhe këtë ide si të drejtë dhe që duhet të realizohet. Mjetet, shumë mirë e sqaroi ministri, që është edhe kompetent të na tregojë se prej cilës linjë buxhetore mund të tërhiqen për pa u prekur kufijtë buxhetorë, e ne duhet t'i japim mbështetje. Prandaj, 500 000 euro hiqen prej aty dhe 250 000, apo sa tha kryetari i komisionit, bëhen 750 000 që dedikohen për Kompleksin e Koshares.

Ne vërtet të mos bëhemi demagogë, se me këto çështje nuk guxojmë të luajmë, nuk guxojmë të bëjmë politikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kemi edhe 3 diskutime: Besa Gaxherri, Lah Ibrahimaj dhe Time Kadrijaj. Para se të shkojmë me këto diskutime, vazhdojmë sa të dëshironi, por sido që të jetë, në fund duhet të vijmë te një përkufizim për ta vënë në votim. Derisa gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur amendamentim të shkruar, ne jemi në mungesë të një propozimi, i cili do të jepet këtu. Do të jetë më tepër interpretueshëm. Më mirë do të ishte që Ministria për Financa me kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa të na e sjellin ndonjë përkufizim në mënyrë që deputetët të votojnë, përndryshe për diskutim, sa të lajmëroheni do të diskutoni. Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Ju kisha lutur të jeni pak më korrekt kur e kërkojmë fjalën. Nuk ke nevojë t'ia japësh nga 10 herë fjalën, e dikush të presë e të mos e marrë fare fjalën.

Unë po dua të kontribuoj në këtë aspekt, se jam anëtare e Komisionit për Buxhet. Më vjen shumë keq që u hap ky amendament këtu, e u bë temë se është shumë e ndjeshme, edhe të bëhet politikë me këtë amendament nga ne është shumë e pandershme. Është shumë e vërtetë që Kompleksi Memorial “Beteja e Koshares” është neglizhuar deri tash dhe nuk janë ndarë mjete të mjaftueshme për t'u kryer, por të jemi korrektë dhe realë, e të mos bëhemi demagogë. Atë ditë amendamentin e zotit Berisha e kemi diskutuar qartë me ministrin e pranishëm dhe të gjithë jemi pajtuar që t'i ndajmë këto 200 000 euro, sepse në afatin janar-mars nuk punohet.

Edhe zoti Berisha është pajtuar, edhe ministri ka kërkuar prej nesh kështu. Mua më vjen keq tash prej kryetarit të komisionit pse tash po mund të nxjerrin mjete, kur ne e kemi shqyrtuar këtë punë në komision. Nuk kemi mundur, se asnjë këtu nuk është këtu më patriot se tjetri. Nuk kemi mundur dhe kemi vendosur t'i ndajmë këto 200 000 euro sepse nuk punohet nga janari deri në mars. Dhe, kemi premtuar dhe jemi zotuar që kjo Qeveri do ta ndërtojë këtë kompleks. Edhe një herë po flas në emër të Qeverisë dhe të Komisionit për Buxhet që Kompleksi Memorial “Beteja e Koshares” do të kryhet,

prandaj ju lutem të mos bëjmë tash demagogji, as të mos kthehemi se nuk mund të bëjmë tash amendament.

Ne e kemi ditur fortë mirë pse keni menduar t'i ndajmë kështu në këtë formë dhe të gjithë jemi pajtuar, ministri, Berisha, Komisioni i Buxhetit. Tash nuk di çka doli këtu, kush do të bëjë Pazar!

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Desha t'ia përkujtuar kryeministrit se Kosharja i ka 114 dëshmorë dhe ka shumë vite që ato kufoma gjenden në Morgun e Prishtinës, e familjarët e dëshmorëve që sa vite nuk kanë ku ta vendosin një kurorë lulësh, qoftë në ditëlindjen e dëshmorëve apo në përvjetorin e rënies.

Zoti kryeparlamentar,

Është amendamenti 44 i Rustem Berishës, prandaj si grup parlamentar ju ftojme ta hidhni në votim dhe të shohim se kush do ta votojë e kush jo këtë amendament.

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit!

Konsideroj se teksti duhet të jetë i riformuluar kështu: te neni 35, paragrafi 2, shkon kështu: “nën programin Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, me kod 279, në tabelën 3.2, shtohet projekti i ri: vazhdimi i punimeve në Kompleksin Memorial ‘Beteja e Koshares’ në shumë prej 700 000 euro, prej të cilave 500 000 euro merren nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë.

KRYETARI: Latif Gashi e ka fjalën.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Realisht, më vjen shumë keq prej kryetarit të komisionit dhe Ministrit që tani gjejnë buxhet, ndërkah kur kemi diskutuar edhe për shumë projekte të tjera të rëndësishme të njëjtë nuk ka pasur buxhet. Andaj, kërkoj që të votohen vetëm të gjitha amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Kryetar!

U dhanë disa propozime. Unë kisha propozuar, me qëllim që ne të vazhdojmë me punë, komisioni përkatës le të tërhiqet për 5 minuta dhe së bashku me ministrin le ta formulojnë qartë amendamentin dhe le të na sjellin qartë për çfarë duhet votuar, sepse në këtë formë i kemi disa propozime.

KRYETARI: Deputetja Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Unë e mora fjalën të them që jam për ndërtimin e Kompleksit në Koshare, por nuk jam që të merren mjetet për rrugën Prishtinë-Gjilan, për një rrugë nacionale, për të cilën ka filluar të bëhet projekti dhe është e rëndësisë së veçantë. Ne tash jemi deputetë të zonave të ndryshme dhe po harrojnë deputetët, si kolegu që tha pse të bëhet projekti. Mirëpo, t'jua kujtoj edhe një gjë, meqë ajo rrugë është shumë e rëndësishme, sepse e lidhë edhe Kosovën Lindore, mirëpo edhe ju që po flitni këtu - nëpërmjet asaj rruge shkohet edhe te familjarët e Komandantit Agim Ramadani. Andaj unë kërkoj që pavarësisht se jam që të bëhen mjetet, por jo të merren për nga projekti i rrugës Prishtinë-Gjilan. Të mos të preken ato mjete! Për këtë arsye e mora fjalën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Stafete Hadërgjonaj e ka kërkuar fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit kryetar!

Unë kërkoj që të hidhet në votim amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë ne i kemi pasur disa kërkesa. E kemi pasur edhe kërkesën që na ka ardhur në formë të amendamentit nga deputeti Rustem Berisha. Ne kemi diskutuar gjatë në Komisionin për Buxhet. Ka qenë i pranishëm aty edhe ministri dhe kemi ardhur në përfundim që për këtë moment t'i ndajmë 200 000 euro, që të vazhdohet me këtë projekt, dhe 200 000 euro për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe 50 000 euro të ndahen në Ministrinë për Planifikim Hapësinor që të vazhdohet prapë me këtë projekt.

Unë kërkoj që amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa të hidhet në votim, sepse çdo diskutim këtu, është duke u bërë për interesa të veta personale nga deputetët e caktuar, e jo për interesat për çfarë është e dedikuar kërkesa dhe projekti. Për këtë moment, ne jemi marrë vesh në Komisionin për Buxhet se mund të financohet me kaq mjete dhe në rishikimin e Buxhetit të financohet në tërësi projekti, që është në Kompleksin e Koshares.

Ju kisha lutur, po e shikoni se kush po diskuton në lidhje me këtë projekt. Të gjithë jemi të ndjeshëm ndaj këtij projekti, sepse në Morgun e Prishtinës ende ndodhen kufomat e dëshmorëve tanë të rënë në Betejën e Koshares. Prandaj, të zgjidhet problemi një herë, që kufomat sa më shpejt të jenë në varrezat, aty ku kanë qenë dhe të mos bëhet lojë me një gjë të tillë dhe në rishikim të Buxhetit të gjenden mjetet.

Unë nuk do të pajtohem që nga një projekt që është i rëndësisë së veçantë të tërhiqen mjetet dhe të dalin në një projekt tjetër, kur nuk ka pasur mundësi të financohet ndryshe. Nëse vjen deri te kjo, më mirë është të tërhiqen mjetet nga projektet që kanë të bëjnë me ndërtim të rrugëve, se sa të hiqen mjetet nga memorialët, të cilët janë shumë të ndjeshëm. Prej cilitdo memorial nëse hiqen mjetet, është diçka e ndjeshme dhe nuk mund të shkohet në këtë mënyrë. Prandaj, ju lutem që të dominojë arsyeja për këtë moment, të hidhet në votim amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe më tutje të vazhdojmë me miratimin e amendamenteve tjera.

Ne i kemi diskutuar gjatë në komision, kemi ardhur në këto përfundime, prandaj të vazhdojmë kështu, e të mos shkojmë për interesa individuale dhe personale, sepse të gjithë, bile-bile disa kemi shumë arsye të jemi shumë më të ndjeshëm ndaj çështjeve të tilla, sepse i kemi familjarët tanë aty, e dikush-dikush ndoshta nuk i ka fare familjarët aty, dhe e ka më lehtë të bisedojë për këtë çështje. Prandaj, shkojmë me amendamentin e Komisionit për Buxhet dhe nuk do të pajtohemi kurrë që mjetet të hiqen nga komplekset tjera memorialë dhe të barten në këtë kompleks memorial.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit kryetar!

Unë fillimisht nuk po e kuptoj pse po bëhet kaq zhurmë. Për herë të parë desha ta mbështes Adem Grabovcin, por ai tri herë e mori fjalën, tri herë i ndryshoi qëndrimet, e tash nuk po di cilin qëndrim të tijin ta mbështes. Si do që të jetë, po flitet për ndjeshmërinë e projektit, por unë prapë qëndroj në mbështetje të deputetit Rustem Berisha, jo pse është Berishë, por seriozisht më për së afërmi është i lidhur me projektin dhe po llogaris se ka pak ngecje dhe vonesa për intervenim në atë kompleks dhe po besoj se të gjithë pajtoheni që është prioriteti i prioritetëve në këtë fushë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Shqip Muja e ka fjalën.

SHQIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Me gjithë ato amendamentet paraprake që i votuam, me shumë prej tyre nuk jam dakord, mirëpo që të mos jemi bllokues të buxhetit i votuam. Ka vërejtje esenciale këtu në planifikimin e Buxhetit, gjë që shihet edhe në reduktimin e rrugëve, siç ishte kjo me Plavën, e që është shumë e rëndësishme nga shumë aspekte, mendoj pa analiza, ndërsa sa i përket propozimit të amendamentit të cilin e paraqet zoti Rustem Berisha, unë e përkrah plotësisht dhe nuk dua ta lëmë si gjeneralin e ushtrisë të vdekur në romanin e Ismail Kadaresë, por t'i japim lekët. Ka filluar nga Qeveria e kaluar, të përmbillet kjo, të mos, ndërsa të tjerët që janë duke diskutuar, është e vërtetë ajo që tha dikush këtu, që për vota është duke diskutuar. Rustem Berishës i takon kjo dhe duhet të ndihmohet ai kompleks, i cili ka një rëndësi, jo vetëm për Kosovën, por ka edhe për historinë në përgjithësi, ndërsa sa u përket komplekseve të tjera, është faji i të gjithë deputetëve, kudo që kemi qenë ne, që nuk kanë përfunduar deri më tani. Sepse, të tjerët janë duke na e vulosur historinë neve, duke mos ditur t'i qesim vlerat historike në mënyra të ndryshme. Faleminderit!

KRYETAR: E ka fjalën profesor Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Po, unë po shoh disponim të të gjithë deputetët, që të rriten mjetet për realizimin e këtij projekti të Koshares. Është pak problem që tash në mënyrë të improvizuar të merren mjetet.

Unë propozoj që ne të aprovojmë vendimin e Komisionit dhe me një konkluzë të Kuvendit të obligojmë Qeverinë, që në rishikim të na e sjell propozimin për adresimin e amendamentit të gjeneralit Rustem Berisha, sepse tash është problem me të vërtetë. Këtu

të improvizohen sendet nuk kemi nevojë edhe ashtu 300-400 mijë deri në qershor mjaftojnë, në qershor sigurisht se do të vijë rishikimi dhe le të jetë konkluzë e Kuvendit që të adresohet ky problem në mënyrën e duhur. Faleminderit!

KRYETARI: E kanë fjalën Latif Gashi, Hajdar Beqa, por si do që të jetë, ndalemi tek një konkluzë nga gjithë ky diskutim, pasi që ka vullnet të përbashkët.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Realisht, meqë nuk isha i interesuar të ngre çështjen e varrezave të dëshmorëve të rëndësishë së njëjtë në komunën e Podujevës, që tani e gjashtëmbëdhjetë vjet asnjë cent nuk u investua, por meqë këtë çështje e kam ngritur edhe gjatë mandatit tim të kaluar në Komision për Buxhet dhe Financa, e kam ngritur edhe tani në mbledhjen e fundit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe kam gjetur përkrahje nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, janë ndarë vetëm 50 mijë euro.

E kemi diskutuar po ashtu, edhe kërkesën e deputetëve tjerë të nderuar këtu, për memorialin Beteja e Koshares dhe kemi gjetur mirëkuptim, i kemi ndarë 250 mijë euro. Për hir të asaj që disa trupa të dëshmorëve janë në morg, jemi dakorduar të gjithë duke u konsultuar edhe me ministrin e Financave, jo që nuk ka pasur vullnet, por ka pasur aq mundësi.

Nëse tani ministri i Financave, kryeministri dhe ne të gjithë deputetët këtu kemi mundësi, kemi buxhet, atëherë kërkoj që varrezat e dëshmorëve të kombit, të cilat janë duke u ndërtuar në fshatin Penuhë, ndahen 1 milion euro.

KRYETARI: Faleminderit!

Kisha kërkuar nga deputetët që të koncentrohemi rreth, veçanërisht kur janë çështje të tilla sensitive, ashtu që të kemi një përkufizim dhe një votim tuajin edhe këtu. Në të kundërtën, vetëm kemi kaluar në diskutime, të cilat do të prekin edhe më shumë familje dhe histori, të cilat janë pjesë e lavdisë sonë.

Fjalën e ka Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë desha të flas pak për projektin, unë këtu i shoh që janë dy çështje, është projekti i rrugës dhe projekti memorial.

Projekti i rrugës ka filluar në vitin 2009, për shkak se ka pasur lëvizje dhe rrëshqitje të dheut, do të thotë ka mbetur nga Ministria e Infrastrukturës të bëhet një studim i fizibilitetit dhe të bëhen matje të reja gjeomekanike dhe konsideroj që duhet që këtë vit rruga Botushë-Koshare të ndërtohet, sepse edhe si projekt ka mbetur në gjysmë.

Është me rëndësi shumë të veçantë edhe për komunitetin, por edhe për rëndësinë e projektit dhe të gjitha projektet memoriale e kanë rëndësinë e vet, por unë konsideroj dhe propozoj që mjetet për memorialin të merren nga një vijë tjetër buxhetore, ose ndoshta

edhe nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve, kurse mjetet për rrugë të merren nga Ministria e Infrastrukturës.

Nëse Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet, që me rishikim të buxhetit në qershor do të ndërtohet rruga dhe projekti, atëherë ndoshta duhet pasur edhe një ujdë të deputetëve, që të votohet ai zotim dhe këtë vit të përfundojë edhe rruga edhe projekti. Se, ne e dimë që më 9 prill është përvjetori dhe familjarët, edhe nëse rregullohet memoriali, nëse nuk ka rrugë nuk munden as për përvjetorë të shkojnë e t'i vizitojnë apo në ato data të caktuara. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Jemi tek amendamenti 35. Kemi vetëm një propozim formal, i cili ka ardhur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, në të njëjtën kohë nuk kemi asnjë amendament të shkruar.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Do të votojmë për amendamentin e Komisionit për Buxhet dhe Financa aktual, i cili është propozimi fillestar.

Pra, votimi për amendamentin 35. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!
Me 67 vota për, 8 kundër dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!
Me 83 vota për, 3 kundër, 2 abstenime, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!
Me 60 vota për, 17 kundër, 6 abstenime, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!
Me 66 vota për, 12 kundër, 6 abstenime, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!
Me 60 vota për, 17 kundër dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!
Me 66 vota për, 3 kundër, 6 abstenime, miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41. Propozim i Grupit Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. “6+”-i a dëshiron ta arsyetojë? Lus regjinë!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

Më falni, e ka fjalën Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

NASER OSMANI: Kjo ka të bëjë pikërisht me atë që i bëra kërkesë Qeverisë, që mjetet që ndahen për komunitete, të ndahen sipas një formule, ku do të jenë të gjitha

komunitetet përfituese, prandaj konsideroj se kjo edhe teknikisht nuk është mirë e përgatitur.

Do të ishte mirë, që deputeti në fjalë i grupit ta tërheq, në të kundërtën duhet votuar kundër.

KRYETARI: Shaip Muja e ka kërkuar fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar,

Unë kam një vërejtje, që është shumë serioze, në përkthimin e gjuhës serbe është amendamenti me numër tjetër dhe të gjitha amendamentet, ndërsa në gjuhën shqipe janë për një numër mbrapa. Prandaj çdo gjë që është votuar, nuk është në harmoni gjuhësore me përkthimin që është bërë. Dhe, tash e vërejtja kur dhashë ato vërejtjet paraprahe, sepse ne jemi një hap mbrapa, ndërsa këta janë një hap më përpara, në përkthimin e gjuhës serbe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të presim, veç ta bëjmë krahasimin, për hir të korrektësisë me komunitetet.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

Kërkojmë falje, për arsye se administrata nuk e ka ndërruar në gjuhën serbokroate me versionin e ri, ndërsa në gjuhën shqipe e kemi versionin e fundit. Kisha pasur dëshirë nga komunitetet, a të vazhdojmë përmes komunikimit, përmes përkthimit simultan që e kemi? Në qoftë se, na lejohet do të vazhdonim, derisa administrata ta përgatisë versionin e ri edhe për komunitete.

A ka ndonjë deklaram nga komunitetet, deputetët? E ftoj deputeten Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: S obzirom da je Parlamentarna Grupa “6+” dala amandman bez podrške Funkcionalne komisije, oni su obavezni da obrazlože u vezi ovog puta Restelica - granica sa Makedonijom. Ja podržavam to. Nadam se da će u Parlamentu proći, ali Parlamentarna Grupa “6+” je u obavezi da ovo podrži.

KRYETARI: Shaip Muja, Administrata më thotë se ju keni raportin e vjetër, përndryshe, deputetët në gjuhën serbokroate e kanë të rregullt.

Jemi tek amendamenti 41. Propozim i Grupit Parlamentar “6+” pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Foli edhe kryetari i Komisionit.

Kisha lutur regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 46 vota kundër 22 për dhe 7 abstenime, nuk kalon amendamenti 41.

Kalojmë tek amendamenti 44. Deputetët e komuniteti joshqiptar dhe joserb, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Besim Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputet,

Mendoj që Komisioni për Buxhet dhe Financa në shpejtësi për ta kryer punën sa më shpejt, ka sjell amendamente të cilat nuk e kanë me plotë kuptimin e fjalës cilësinë e amendamenteve. Këto janë propozime, sepse amendamenti zyrtar që duhet të vijë nga një deputet apo nga komisioni, duhet të jetë i qartë, nga vijnë ato mjete dhe ku shkojnë, pra me kod të saktë.

Prandaj, ne e kemi të vështirë sot t'i votojmë të gjitha këto amendamente, sepse janë amendamente të paspecifikuara dhe janë të paqarta, nga burimi i mjeteve dhe ku duhet të shkojnë ato mjete. Prandaj, besoj që ne duhet të gjitha këto që janë pa përkrahje të Komisionit Funkcional të mos votohen, në mënyrë që t'u jepet mundësia që këta të vazhdojnë sipas projeksioneve buxhetore të cilat i kanë para vetes.

Besoj që është situatë mjaft e qartë, sepse nuk ka amendament me plot kuptimin e fjalës i cili tregon saktë burimin e mjeteve dhe ku shkojnë mjetet. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, faleminderit shumë deputetit Besim Beqaj. Ne po vazhdojmë kronologjinë e numrave të cilët i kemi këtu të paraqitur si amendamente. Megjithatë amendamenti 42 nuk ka përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 75 vota kundër, 6 për dhe 4 abstenime nuk kalon amendamenti 42.

Kalojmë te amendamenti 43.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Fjalën e ka deputetja zonja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, më lejoni që para jush të prezantoj amendamentin si në vijim.

Të implementohet në tërësi Kontrata Kolektive e cila është nënshkruar nga partnerët social në mars të këtij viti, duke siguruar buxhet në shumën prej 100 milionë euro dhe atë 90 milionë euro për rritjen e pagave në të gjitha kategoritë prej 25% ashtu siç thotë vendimi i nënshkruar në mars dhe jo ashtu siç po mashtron sot Qeveria e Kosovës dhe 10 milionë euro për realizimin e kostos buxhetore që implikojnë dispozitat tjera të kontratës kolektive.

Komisioni për Buxhet dhe Financa të bëjë shpërndarjen adekuate sipas organizatave buxhetore dhe numrin e të punësuarve. Po ashtu edhe një herë po e ritheksoj nëse Qeveria

dëshiron të reflektojë konform nevojave të qytetarëve, zvogëlimi i 1/3 së Qeverisë do të kursente rreth 150 milionë euro përmes të cilave do të mund t'i përgjigjemi nevojave të qytetarëve për rritje të pagave, por edhe të zbatojmë vendimin dhe të mësohemi që vendimet e Qeverisë duhet të zbatohen dhe jo të merren vetëm atëherë kur kemi fushata zgjedhore.

Unë i ftoj deputetët e Kuvendit që ta përkrahin këtë amendament i cili do të jetë amendament për një mirëqenie për ndalimin e ikjes së qytetarëve nga vendi dhe për vendimin i cili është marrë në një periudhë kur këta njerëz kanë votuar për këtë vendim, prandaj të mos vazhdojmë me mashtrim, por të votojmë zbatimin e një vendimi të marrë nga Qeveria e cila sot po ashtu është partner i Qeverisë së re. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Financave, zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ne si Qeveri në Komisionin për Buxhet kemi paraqitur amendamentet tona të cilat janë votuar në tërësi nga Komisioni për Buxhet dhe tash u përkrahën edhe nga deputetët të gjitha amendamentet. Ne kemi vendosur unanimisht në Qeveri që të kursejmë 14.5 milionë euro për vetura, për telefona, për mobilie, për të gjitha pajisjet që mund të konsiderohen në çfarëdo forme luks në Qeveri. Kaq kanë qenë mundësitë për të cilat ne i kemi ndarë 3 milionë për barna esenciale, 1 milion për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore dhe pjesa prej 11 milionë e diçka është për fillimin e zbatimit të Kontratës Kolektive për të paguar 0.5% për çdo vit të përvojës së punës jo vetëm për këto vite pas lufte, por duke përfshirë tash me amendamentet e Komisionit edhe për vitet e 90-ta.

Këto kanë qenë mundësitë e buxhetit të Kosovës. Është lehtë për të dhënë propozime, por ne duhet të kemi kujdes që t'i marrim parasysh edhe interesat e 300 mijë njerëzve tjerë të pa punë e jo vetëm të atyre që janë të punësuar. Sigurisht zonja Donika Kadaj-Bujupi kujdeset shumë për personat e punësuar e jo për ata të pa punë. Jam i sigurt se nëse e merr familjen dhe farefisën e ngushtë dhe të gjerë të saj, asnjë person nuk e ka të pa punë dhe kujdeset shumë për këta persona, vetëm për rritje të pagës e jo për të ndarë ndoshta 1 milion shtesë në Ministrinë e Punës ose nja 1 milion në Ministrinë e Bujqësisë dhe për të ndaluar autobusët, sepse autobusët jashtë nuk ndalohen duke rritur pagat, por duke çuar buxhetin në bujqësi, në trajnime, në rritje të punësimit dhe në sektorë të tjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ministër! E ftoj deputeten Donika Kadaj-Bujupi, replikë ka.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Edhe një herë, të nderuar të pranishëm!

Ky vendim, zbatimin e të cilit unë po e kërkoj sot i referohet një vendimi të marrë më 18 mars të këtij viti nga Qeveria e cila sot është partner i ministrit dhe i kryeministrit. Do të thotë bëhet fjalë për një vazhdimësi të projekteve që duhet zbatuar, është një vendim i cili është marrë para fushatës zgjedhore dhe ju i keni marrë votat e qytetarëve bazuar në këtë vendim.

Mjaft më me mashtime, mjaft më me fjalë të kota, me premtime. Ka ardhur koha që fjalët të cilat i keni folur, vendimet të cilat i keni marrë duhet t'i zbatoni. Këta njerëz të cilët janë punëtorë, të cilët kanë një pagë bazë, janë familjarë të atyre të papunëve, janë njerëz të cilët përfaqësojnë familje, janë njerëz të cilët ju i mashtruat dhe të cilët duhet të ndaloni së mashtuari edhe në të ardhmen.

Personalisht ministër, keni thënë që kjo rritje duhet të jetë diku 43% dhe jo 25%, që të jetë rritje reale. Po e konfirmoj që kjo rritje është nevojë e rritjes së kostos së jetës së qytetarëve, sepse çmimet janë dhjetëfishuar, ndërkaq pagat nuk janë rritur. Prandaj edhe një herë thatë që i keni kursyer 14 milionë. Unë ju ftoj që t'i kurseni 150 milionë duke e zvogëluar Kabinetin e juaj qeveritar që është sa ai i Kinës, sepse është krejt i panevojshëm, nëse doni të reflektoni konform varfërisë në vend dhe ky zvogëlim do t'i sjellë buxhetit të Kosovës 150 milionë euro shtesë. Dhe, këto 150 milionë do t'i mbulojnë pagat prej 25% të cilat nuk i kam premtuar unë, ministër, i keni premtuar ju.

Madje keni thënë 43%, ndërkaq partneri i juaj i koalicionit ka nënshkruar, e kemi vendimin e nënshkruar më 18 mars të vitit 2014 vendimin për rritje të pagave prej 25%. Të vazhdoni ta gënjeni opinionin është pak e tepërt, sepse veprimet e juaja po i shtojnë autobusët, e binduni se në ata autobus ka edhe familjarë të mi. Besoj që familjarë tuaj nuk ka dhe familjarë të atyre të cilët e kanë stërngarkuar administratën me nepotizëm, por familjar të mi ka, edhe shumë të afërt dhe mundeni ta verifikoni. Tash i keni edhe shërbimet, jeni bashkë dhe mundeni të bëni verifikime edhe për familjarë.

Edhe një herë po kërkoj që ky amendament të hidhet në votim dhe që deputetët të vendosin se a do ta përkrahin apo jo. Nuk është çështje e juaj, ju nuk votoni. Ju e keni marrë vendimin të cilin tash po doni t'i ikni, nuk po doni ta zbatoni, këtë vend e keni sjell në mjerim, në varfëri. Me buxhet nuk keni paraparë të hyrat, nuk keni paraparë ta luftoni korrupsionin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Më fal, deputete a e mbarove? Ministri i Financave e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar! Shumë shkurt atëherë.

Ne, të gjithë dhe ju si deputetë në veçanti duhet të përgatitemi që ne shumë shpejt do të sjellim në Kuvend Ligjin për harmonizimin e pagave se pagat e deputetëve janë 2.962 euro në mesatare vjetore me të gjitha shtesat, le të përgatitemi t'i fillojmë kursimet prej këtu, sepse autobusët nuk ndalen duke rritur pagat, por duke krijuar mundësi të punësimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Ju kisha lutur vetëm ta dëgjojmë njëri-tjetrin. Latif Gashi e ka fjalën.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Realisht kisha kërkuar nga ju zoti kryetar që tani kur po diskutojmë, kur po votojmë për Projektligjin për buxhet dhe financa në lexim të dytë që të mos ketë debat kaq shumë,

Armend a bën të dëgjosh, ngase debati u shter gjatë leximit të parë. Të gjithë deputetët duke përfshirë edhe të nderuarën deputetë Donika Kadaj-Bujupi, e cila jo një herë, por sa herë ka dashur e ka arsyetuar amendamentin të cilin e ka bërë, është edhe anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe tani këto deklarata politike të cilat i bën e nderuara deputetë dhe thotë: mashtrime e gjëra tjera, qytetarët e Republikës së Kosovës e kanë vlerësuar se kush i mashtron. Ne, disa muaj përpara kemi pasur një proces zgjedhor dhe dihet cilën qeveri, cilën parti politike qytetarët e Republikës sonë e kanë vlerësuar, andaj kjo është fyerje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, nëse ju zoti kryetar vazhdoni të lejoni kesi debati, atëherë realisht nuk është në rregull.

KRYETARI: Faleminderit! Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër, është shqetësuese kur nuk ua din pagat deputetëve, sepse kështu po krijoni opinion publik për të cilin ne ballafaqohemi me qytetarët direkt. Një deputet i Republikës së Kosovës e ka rrogën, pagën bazë 1.448 euro, ndërsa ju bëni dezinformim, shkoni në 2.600 për një deputet që s'është e vërtetë. Është për kryetarët e komisioneve ndoshta, por jo për deputetët, janë 120, le të flasim këta tjerët, ndërsa sa i përket rritjes së pagave ka në opinionin publik edhe mosmarrëveshje mes partnerëve. Prandaj duhet të qartësohet kjo çështje. Ne jemi të hutuar dhe kërkesa qëndron e bazuar, qoftë edhe në fushatën paraalektorale, por edhe gjatë këtyre ditëve, ose do rriten ose s'do rriten pagat, ose do t'i rrisim 6%.

Prandaj jeni fajtorë vetë, nuk e keni dakorduar opinionin publik në prononcimet që i bëni si Kabinet qeveritar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, pastaj vazhdojmë diskutimet.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Zoti kryetar,

Deputet të nderuar,

Sigurisht se do të ishte dëshirë e gjithë neve që sot të vendosim për t' i rritur pagat për 25% dhe asnjëri, mendoj nga ju, e as nga ne në Kabinetin qeveritar, nuk jemi kundër asaj, problemi qëndron në kufizimin buxhetor. Rritja e pagave prej 25% nënkupton 127 milionë para të reja dhe nënkupton se ne do ta kemi fondin e pagave 660 milionë në këtë rritje, që është 40% e buxhetit të vendit. Është një gjë të cilën ne nuk mundemi ta bëjmë, sepse nuk kemi para, jo sepse nuk kemi dëshirë.

Edhe në qoftë se e zvogëlojmë Kabinetin qeveritar për të cilin po propozohet këtu dhe në qoftë se e zvogëlojmë për 6 ministra apo 8 ministra, 6 ministra nga 1.200 euro në muaj...

(Ndërhyrje)

Të lutem mos ndërhyj, sepse unë nuk ndërhyra, prandaj të bëhemi korrektë në sjellje. Kabineti qeveritar i zvogëluar nënkupton përjashtim të njerëzve nga puna, në qoftë se hyjmë dhe e zvogëlojmë Qeverinë, prandaj askush nuk ka të drejtë këtu të përjashtojë

dikë nga puna por ia rrit rrogën tjetërkujt. Ne kemi pagat në sektorin publik të cilat janë më të larta nga sektori privat për mesatarisht 90 euro në pagë. Do të thotë për 90 euro i keni në sektorin privat tani pagat më të ulëta se sa në sektorin publik, në qoftë se ne domi t'i ndalim qytetarët tanë të mos shpërngulen, atëherë ata njerëz duhet t'i punësojmë. Ata nuk do t'i punësojmë duke ua rritur pagat këtyre që janë në punë, në qoftë se kemi orientim të qartë çfarë po domi, në qoftë se dëshirojmë ta zhvillojmë ekonominë, atëherë duhet të investojmë në ekonomi, duhet të investojmë në sektorin privat, duhet të mundësojmë që atje të gjenerojë punësimi, që atje të rriten pagat në mënyrë që nga ai sektor të kemi pastaj të hyra për buxhet dhe t'i rritim pagat në sektorin publik, edhe në arsim, edhe në shëndetësi, edhe në kulturë, edhe shërbyesve civilë.

Unë nuk shoh mundësi këtu, jo që nuk shoh dëshirë, ne do të trajtojmë këtë mundësi gjatë vitit. Ne nuk e mbyllim mundësinë e rritjes së pagave, por në këtë situatë do të thotë sot ne një vendim të tillë nuk mund ta marrim. Gjatë vitit ne do ta trajtojmë dhe varësisht nga rritja e buxhetit, varësisht nga shtimi i rritjes ekonomike vjetore dhe varësisht nga rritja e shpenzimeve jetësore, ne do të veprojmë, sepse jemi këtu dhe ne duhet të mendojmë për këta njerëz, por nuk është ajo çështje, të cilën ne duhet ta shtrojmë në këtë formë, sepse është e pamundur që në këtë formë të gjejmë zgjidhje.

Do të thotë, edhe një herë po konkludoj se nevojiten 127 milionë para të reja për t'i rritur pagat dhe pjesëmarrja e pagave në Buxhet do të jetë 40%. Kjo është pjesëmarrje e madhe, të cilën ne si Kosovë nuk mund ta përballojmë në këtë moment, prandaj edhe nuk jemi përcaktuar që ta bëjmë. Në qoftë se ka ndonjë burim, ne nuk mund të improvizojmë tash të hyra dhe të themi se ne i rritim të hyrat. Ne do të bëjmë përpjekje maksimale që gjatë vitit ta ulim evazionin fiskal, ta luftojmë korrupsionin, ta shtojmë Buxhetin, t'i aplikojmë arkat fiskale. Do të bëjmë çdo gjë, edhe në qoftë se bashkërisht e rritim Buxhetin, bashkërisht këtu do të vendosim edhe për rritjen e pagave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë shkojmë në votim të amendamentit 43. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 53 vota kundër, 27 për dhe një abstenim nuk kalon amendamenti 43.

Kalojmë tek amendamenti 44.

Deputeti Rustem Berisha, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONA. Urdhëro, deputet!

RRUSTEM BERISHA: Tash është fjala ime. Unë, kryetar, kam marrë pjesë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe realisht aty pjesërisht është miratuar një pjesë e Buxhetit për vazhdimin e punimeve, 200 mijë euro dhe 50 mijë euro Ministrisë të Ambientit. Por, ajo që sot nuk u tha këtu, se ishte edhe ministri i Financave i pranishëm, edhe kryetari i komisionit, këta janë zotuar që në rishikimin e Buxhetit në qershor do të ndajmë pjesën tjetër. Prandaj, unë kisha kërkuar që kryeministri i Kosovës të zotohet publikisht se këtë pjesë do të realizojë në rishikimin e Buxhetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash! Me 45 vota kundër, 38 për dhe 4 abstenime nuk kalon amendamenti 44.

Amendamenti 45. Deputeti Bali Muharremi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëroni, e keni fjalën, ju lutem!

BALI MUHARREMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 57, pika 3, edhe unë kam bërë disa kërkesa, disa amendamente për Buxhetin e vitit 2015.

Të gjitha këto kërkesa që i kam bërë në këtë komision janë për mirëqenien sociale të qytetarëve dhe për zhvillimin ekonomik. Derisa dy, kryeministri aktual dhe zëvendëskryeministri, kanë premtuar vende pune, për shembull në fushatë, unë po e marr një mesatare 160 mijë, atëherë në qoftë se nuk ndikojmë nëpër kuvendet komunale për ta zhvilluar infrastrukturën, atëherë qysh do të kemi vende të reja të punës?

Unë kam shkuar me disa kërkesa solide, për të cilat kanë nevojë qytetarët, jo vetëm të komunës së Therandës, por kanë nevojë edhe qytetarët e rajonit të Prizrenit. Kemi bërë kërkesë për shkollë, për edukimin e brezave të ri, kemi bërë kërkesë për një shtëpi të kulturës, për të cilën me të vërtetë ka nevojë, nuk është rinovuar pas luftës ka diku 15 vjet që nuk është punuar asgjë në këtë shtëpi të kulturës, e ajo e ka dhënë një numër shumë të madh të artistëve në komunën e Therandës.

Ne po ashtu kemi bërë kërkesë edhe për zona industriale, jo vetëm në komunën e Therandës, por edhe të Prizrenit e të Rahovecit, ku dihet se në qoftë se duam të kemi zhvillim ekonomik, atëherë duhet t'i stimulojmë bizneset e vogla dhe bizneset e mëdha.

Ne po ashtu e kemi bërë një kërkesë për një shtëpi të pleqve. Në qoftë se duam të hyjmë në Evropë dhe duam t'i plotësojmë standardet e Bashkimit Evropian, atëherë është një shtëpi shumë e mirë që ka filluar në komunën e Therandës, për të cilën janë investuar mbi 500 mijë euro, mirëpo për shkak të rishikimit të Buxhetit, Kuvendi Komunal i ka hequr paratë dhe i ka dërgua në 'mallra e shërbime'. Prandaj, kërkoj nga Qeveria që t'i japë së paku 500 mijë euro për ndërtimin e kësaj shtëpie, për arsye se ka mundësi që edhe mjetet që janë dhënë deri më tash të shkatërrohen.

Po ashtu, kemi bërë kërkesë edhe për një rrugë, e cila lidh autostradën "Ibrahim Rugova" me Shtërpcën, e cila është një rrugë, e cila do të ndikonte në zhvillim ekonomik dhe për vende të reja të punës.

Edhe një herë kërkoj nga gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës, pa dallim partie politike, që t'i përkrahin këto amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lus regjinë të përgatitet për votim, amendamenti 45. Votojmë tash!

Me 50 vota kundër, 22 për dhe 11 abstenime, nuk kalon amendamenti 45.

Amendamenti 46. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Nait Hasani, ju lutem!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Arsim ka bërë amendamentet, për amendamentet 46, 47, 48, 49 ne i tërheqim, sepse ato janë inkorporuar dhe Qeveria ka marrë këtë vendim. Ndërsa amendamenti 50 është me përkrahjen e komisionit dhe është i inkorporuar në amendamentin 18, pika 10, kështu që ne pajtohemi me këtë vendim. Faleminderit!

KRYETARI: E tërhoqi amendamentin. Amendamenti 46 nuk ka votim.

Amendamenti 47. Edhe ai, gjithashtu.

Amendamentet 48 dhe 49 janë tërhequr.

Amendamenti 50. Komisioni për Arsim, Shkencë Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, me përkrahjen e Komisionit Funkcional. E lus ministrin e Kulturës dhe zëvendëskryeministrin, zotin Kujtim Shala, për koment.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqë ky amendament është i komisionit dhe është bërë pa ndonjë konsultim me Qeverinë, unë do ta kërkoja një sqarim. Çfarë nënkuptohet me fazën e dytë të punimeve në stadiumin olimpiq “Adem Jashari”, e kur them këtë i kam parasysh dy faza punimesh, të cilat i ka drejtuar dhe i ka financuar Qeveria.

Është fjala për dy kontrata, e para e datës 12 dhjetor 2012, me vlerë bazë rreth 650 mijë euro, e shoqëruar me një aneks-kontratë një vit më vonë, dhe që në tërësi arrin shumën 850 mijë euro për renovimin dhe rindërtimin e stadiumit.

Dhe faza e dytë, që nënkupton ndërtimin e shtigjeve të atletikës dhe sistemin e ujitjes së stadiumit, e datës 14 gusht 2014, në vlerë 340 mijë euro.

Nga kjo shumë gjatë vitit 2014 Qeveria ka dhënë 200 mijë euro dhe ka përcaktuar, ka alokuar te projektbuxheti i vitit 2015 edhe 186 mijë euro. Për fazën e punimeve të cilave u referohet ky amendament, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk e ka një projekt shitesë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Deputeti Bekim Haxhiu e kërkon fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e kuptoj edhe ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili sapo e ka marrë detyrën dhe ende nuk është njoftuar me projektet totale, të cilat janë zhvilluar dhe cilat janë në zhvillim e sipër.

Qeveria e kaluar ka investuar në fazën e parë në renovimin e stadiumit olimpiq “Adem Jashari”. Është në fazën e investimit edhe të shtigjeve të atletikës dhe sistemit të ujitjes.

Faza e dytë, unë besoj që edhe ministri dhe krejt qytetarët, por edhe deputetë këtu e dinë që nuk ka filluar të implementohet. Aty kemi të bëjmë me ndriçimin, kemi të bëjmë me rregullimin e wc-ve për shikues, kemi të bëjmë me përforcimin e tribunës lindore, me rregullimin e hyrjes për persona VIP dhe ekranet në stadium, me çka planifikohet që të përfundojë në detale ky projekt i stadiumit “Adem Jashari” dhe të jetë i gatshëm për garat ndërkombëtare. Mendoj që kjo veç ka kaluar tani. Ky projekt është aprovuar në amendamentin 18 dhe tani po kërkohet vetëm një rikonfirmim i asaj për të cilën kemi votuar në amendamentin 18. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri i Kulturës e ka fjalën prapë, ju lutem!

MINISTRI KUJTIM SHALA: Një projekt i kësaj natyre nuk ekziston. Punimet për të cilat po flet deputeti i nderuar janë të përshkruara te kontrata e parë, këto kanë përfunduar. Projekt shtesë nuk ka, nuk ekziston.

Faza e dytë nënkupton këtë që po e them unë dhe që është kontraktuar më 14 gusht 2014.

Unë kërkoj që ky amendament të mos votohet, sepse projekti është fiktiv. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta marrë fjalën.

NASER OSMANI: Kryetar, çështja është kështu: Tash e kemi kërkesën e ministrit që të mos aprovohet amendamenti 50. Nëse është ashtu siç thotë ministri, e që unë besoj se është, atëherë duhet të votohet kundër këtij amendamenti, që e ka përkrahur komisioni, por njëkohësisht duhet t’i shtohet që abrogohet apo shlyhet, nuk miratohet vendimi i mëhershëm në amendamentin 18, e që ka të bëjë me pikat 10 dhe pikën 11, sepse është e njëjta gjë.

KRYETARI: E lus deputetin Latif Gashi ta marrë fjalën.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Realisht unë e kuptoj zëvendëskryeministrin, përkatësisht ministrin e Kulturës që e ka marrë këtë detyrë tani para disa ditësh apo javësh, dhe besoj që fare nuk është duke e kuptuar se çështja për të cilën foli, është fjala për zvogëlimin për mjetet e një kodi buxhetor, i cili ka qenë 800 mijë, e tani vetë Qeveria, vetë ministri i Financave, në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të komisionit, ka propozuar që këtij kodi buxhetor nga 800 mijë t’i hiqen 400 mijë dhe të dedikohen për stadiumin olimpiq “Adem Jashari”.

Pra, këtu kemi të bëjmë vetëm me ndërrim të shifrës së këtij kodi buxhetor, e nuk kemi të bëjmë me një projekt të ri, siç e ka kuptuar zëvendëskryeministri, por vetëm me përmirësimin e ligjit, respektivisht për të treguar se ku duhet të merren mjetet për amendamentin 18, të cilin pak më herët ne e votuam. Andaj nëse me këtë praktikë shkohet që tani t’i rivotojmë, apo të fillojmë nga fillimi, atëherë definitivisht kjo është një lojë, të cilën nuk kisha dëshiruar ta shoh në Kuvend.

KRYETARI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Edhe një herë: unë i kam tepër të qarta, provojeni të kuptoni ju, sepse unë jam tepër i saktë. Ju po kërkon mjetet për një kontratë, e cila është mbyllur. Kjo kontratë përfshin punët, unë desha të jua kursej kohën, demolimi i zhvështoreve dhe renovimi i tyre, ku janë të përfshira nivelimi, pllakat e qeramikës etj.; nga ana e jashtme e tribunave, vendosja e ulëseve e tjera; punimi i pjesës VIP e tjera, deri te banjat. Kjo punë është mbyllur, e para. Nëse ju e keni futur te një amendament tjetër, atëherë ai është gabim teknik, sepse atë nuk e ka propozuar Qeveria, sepse nuk e kam propozuar unë.

Unë kam kërkuar të rialokohen saktësisht 1 milion e 300 mijë euro, pasi i kam analizuar të gjitha kontratat me organizatat buxhetore. Meqë ka kaq konfuzion dhe pretendohet që duhet të bëhen investime, të cilat do të duhej të ishin kryer, unë do të kërkoj që në një procedurë të jashtëzakonshme të bëhet një auditim i punimeve që ka ndodhur në këto dy faza. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër Mustafa,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi të bëjmë me një projekt, për të cilin tashmë punët janë të kontraktuara. Unë has në mirëkuptim me kolegët këtu, në këtë rast me Bekim Haxhiun dhe kolegët tjerë. Por, për këtë projekt janë punët e kontraktuara, me të cilat ka filluar gjatë vitit 2014 dhe e kemi prapë një shumë të caktuar për shtigjet atletikës për vitin 2015, atë që e tha edhe ministri. Do të thotë, nëse ne i marrim këto mjetet 800 000 euro nga ai kod që është i paraparë për shtigjet e atletikës për stadiumet tjera regjionale, atëherë biem në kundërshtim me Ligjin për prokurimin publik. Po e përsëris edhe një herë, thotë biem në kundërshtim me Ligjin për prokurimin publik dhe njëkohësisht në kundërshtim me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike.

Prandaj, së pari duhet të përfundojnë punët që janë të kontraktuara, të bëhet pranimi teknik i tyre, e nëse ka nevojë për punime shtesë gjatë vitit 2015, atëherë e kemi edhe rishikimin e Buxhetit, por tash nuk guxojmë që këto mjetet buxhetore t'i tërheqim prej këtij kodi dhe t'i bartim në mënyrë të jashtëligjshme në kodin, ose në stadiumin në të cilin janë paraparë këto shtigje të atletikës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Zafir Berisha, për replikë janë lajmëruar Bekim Haxhiu dhe Latif Gashi.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Unë një gjë nuk po e kuptoj kush është ministër e kush është deputet. Tash ministri po pyet në cilësinë e deputetit. Po llogaris, nëse nuk jam gabim, ka pak përzierje të kompetencave, sepse edhe te ministri i Financave, zoti kryetar, kur nuk ma dhatë fjalën, duhet ta kuptojë që ministri është i emëruar, e deputeti është i zgjedhuri i popullit, sepse nganjëherë, domethënë me simptome të injorancës, deputeti po injorohet gjatë fjalimeve.

Në këtë rast pa diskutim, se hyrën e dytë, ministri në cilësinë e deputetit që pyeti, e nxori atë që është dashur ta nxjerrë në fillim, për çka unë desha të kërkoj sqarim, por tash çdo gjë është e qartë besoj edhe për opinionin. Faleminderit!

KRYETARI: Latif Gashi, replikë!

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Realisht këtë material që sot e kemi të pranishëm në lidhje me këtë projekt, e kemi nga Ministria e Financave. Nuk e di pse nuk kanë pasur koordinim zëvendëskryeministri me ministrin e Financave. Ne në Komisionin për Buxhet dhe Financa nuk kemi bërë material të ri lidhur me këtë projekt.

Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

E keni amendamentin 18, pika 10, që tanimë e votuam, e që flet pikërisht për këtë projekt të këtij stadiumi të përmasave evropiane. Ndërkaq, në amendamentin të cilin e ngriti ministri i Kulturës, ai flet për mjetet të cilat merren, jo në mënyrë jashtëligjore, por në mënyrë shumë ligjore, për të cilat ministri i Financave dhe drejtori i për Buxhet e kanë përgatitur ku merren dhe për çka dedikohen.

Andaj, unë tash fare nuk e kam të qartë këtë insistim të ministrit të Kulturës, i cili thotë duhet ta heqë këtë projekt, ose deputetët që thonë duhet të merren në mënyrë jashtëligjore. Krejt ky material është përgatitur në Qeveri, përkatësisht në Ministrinë e Financave, e na u ka servuar në Kuvend, respektivisht në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Andaj nuk e di tash çfarë është kjo.

KRYETARI: Bekim Haxhiu, replikë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Për shkak të procedurës edhe Rregullores së Kuvendit, për të gjithë deputetët e pranishëm - ky amendament ka kaluar në dy komisione funksionale, Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport dhe në Komisionin për Financa. Tjetra është se në amendamentin 18 është aprovuar ky investim kapital dhe nuk mund tani që me një propozim të hiqet një pjesë e amendamentit 18, dhe pjesa tjetër. Ose do të kthehemi pastaj, përfshirë procedurën e Rregullores, në fillim që t'i rishqyrtojmë të gjitha amendamentet e votuara dhe nenin 18 ta kthejmë edhe një herë në votim, gjë që nuk kemi të drejtë ta bëjmë këtë se është votuar me shumicën e votave të deputetëve.

Është çështje e përfunduar ajo, mirëpo mua më befason fakti edhe ngurrimi i ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të investuar në këtë stadium. Kjo mua më befason për arsye se në atë stadium, e thashë që është bërë një fazë e investimeve, dhe unë besoj që edhe ministri e di që në stadiumin olimpiq "Adem Jashari" mungon ndriçimi, në stadiumin olimpiq "Adem Jashari" mungon qasja VIP, në stadiumin "Adem Jashari", jo pse janë investuar, por nuk janë investuar wc-të për publik, në stadiumin "Adem Jashari" mungon ekrani për paraqitjen e rezultateve dhe me këto ky stadium do të bëhej një stadium i përmasave evropiane. Dhe, unë nuk besoj që ministri është kundër kësaj.

KRYETARI: Kundër-replikë, ministri i Kulturës!

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Nuk ka kjo të bëjë me kush është kundër e kush është për, por me punë të vërteta dhe fiktive. Nëse ju e keni kaluar te një amendament, pse është ky i dyti, unë nuk e kuptoj! Ose është gabim teknik, ose pse e propozoni si të veçantë?

Amendamenti 11 ka të bëjë me propozimet e Qeverisë. Këtë nuk e ka propozuar Qeveria, por Komisioni Parlamentar, e unë kërkoj që të tërhiqet. Kaq kam, asnjë kërkesë tjetër. Ky nuk është një projekt i vërtetë, nuk ekziston. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARDMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Në fakt, unë desha dy çështje, për të mos e marrë fjalën dy herë. Edhe më shumë jap sqarime për të parën çfarë tha ministri i Financave, rreth pagave të deputetëve. Unë mendova që ju, zoti kryetar i Kuvendit, po e sqaroni këtë çështje për hir të opinionit publik, sepse jeni kryetar dhe ju takon juve ta sqaroni se deputetët nuk paguhen në shumën e tillë. Bile-bile Kuvendi vitin e kaluar ka hequr dorë si institucioni i parë prej rritjes së pagave, që ka ndodhur, me propozim nga Qeveria e Kosovës.

E dyta, shumica prej nesh, kjo ka të bëjë edhe me personalen, meqë ndoshta jetojmë në bashkësi familjare dhe do të ishte e pakuptimtë që ne ta çojmë një rrogë tjetër në shtëpi, ndërsa ministri theksoi se ne e kemi një pagë tjetër. E nuk është mirë. Paga totale e deputetit është 1294 euro neto, shtesat për seanca dhe komisione parlamentare në total 400 euro me pjesëmarrje të rregullt. Kjo është ajo që deputetët paguhën si deputetë, pa i shqyrtuar funksionet, normalisht të kryetarit të Kuvendit dhe të Kryesisë së Kuvendit. Kjo është për sqarim, për hir të korrektësisë, sepse që sa vjet të tëra bombardohen deputetët e Kuvendi me lloj-lloj dezinformatash për pagat çfarë i kanë dhe unë mendoj se nuk jemi këtu opozitë ndaj njëri-tjetrit kur kemi të bëjmë me çështje që janë pak më sensitive.

E dyta, sa i përket këtij amendamenti, unë po dua të besoj shumë në atë që po thotë ministri i Sportit për hir të asaj që e kemi pasur nga raportet e auditorit për keqpërdorime në projektet e caktuara, të cilat kanë përfunduar, dhe vit pas viti janë kërkuar mjete shtesë. Kjo ka ndodhur. Nëse e shikoni tabelën edhe për rrugët që janë në këtë pjesë të tabelave, janë të përfunduara, disa prej tyre. Janë rrugë që u është prerë shiriti nga ministrat e caktuar dhe sot një pjesë e tyre është për shkak të borxhit të trashëguar që duhet të bartet. Andaj unë po dua të besoj dhe duhet mirë ta shqyrtojmë, sepse nuk janë pak 400 000 euro, se për 400 000 euro para e patëm një dilemë të madhe ndërmjet një memoriali dhe një studimi të fizibilitetit të ashtuquajtur, edhe pse nuk ishte një përkufizim i tillë dhe nuk ishim për as kundër asnjërës.

Kështu që unë po mendoj se ministri duhet ta theksojë qartë. Nëse ekziston projekti, zoti ministër, Kuvendi është për t'i parandaluar keqpërdorimet. Nëse ekziston si pjesë e kontratës dhe është dashur të bëhen ato pagesa, kush çka ka bërë dhe çka mendon të bëjë

në të ardhmen, Kuvendi nuk bën të lejojë, e jo unë. Mendoj se ju po flitni me kompetencë dhe e keni shqyrtuar mirë në mënyrë të detajuar atë pjesë të kontratës, çfarëdo qoftë, që ju e keni gjetur.

Pjesët tjera, unë nuk jam i fushës së faktuar, por besoj që as kolegët deputetë nuk janë të asaj fushe, pavarësisht interesimi që e kanë për sportin.

KRYETARI: Ka të lajmëruar deputetë të tjerë për diskutime, por, sido që të jetë, ne duhet të shkojmë drejt përfundimit edhe të këtij propozim-amendamenti. Kryeministri e ka fjalën

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Nëse më lejoni, unë do të ju propozoj që të tërhiqet ky amendament - amendamenti 50, sepse është amendamenti 18 që është votuar dhe nuk kemi nevojë që dy amendamente të votohen për të njëjtën gjë. Të mos prekim andej. Pastaj është çështje operative. Asnjë kontratë nuk mund të realizohet jashtë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Le të urdhërojmë ministria më vonë. Në zbatimin e kontratave do të kujdeset që të mos kemi dyfishim të shpenzimit të mjeteve, ose të mos kemi pagesë të punëve të dyfishta dhe propozoj që të tërhiqet ky amendament dhe të mbetet amendamenti 18, në mënyrë që kjo situatë të kapërcehet.

KRYETARI: Propozimi i Qeverisë është amendamenti 50 të hiqet nga rendi i ditës. Cili është qëndrimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa? Urdhëro, deputeti Besnik Bislimi, nga opozita së pari, se kemi ankesa prej saj.

BESNIK BISLIMI: Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, jo nga opozita. Vetëm një sqarim të shkurtër për ministrin. Ministri doli në foltore dhe tha se kemi të bëjmë me një projekt fiktiv. Ashtu si unë e kuptoj - një projekt fiktiv është një tendencë për t’u mashtruar dhe të vidhet Buxheti i shtetit. Dhe, nuk mund të dalësh të thuash është projekt fiktiv, e të mos thuash që kemi nisur hetime, ose të shohim çfarë po ndodh. Vetëm desha ta di cilat janë procedurat standarde, kur ju konkludoni se po u nënshtroheni tendencave për mashtrim.

KRYETARI: Latif Gashi për sqarim!

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Ministri, si duket, realisht fare nuk ka konsultime me ministrin e Financave, ngase ministri për Financa e ka sjellë këtë propozim dhe unë konsideroj, tani meqë e kemi një propozim nga kryeministri për ta tërhequr, zoti kryeministër, nëse unë e kuptoj këtë si anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk e kuptoj se kemi të bëjmë me dy projekte. Kisha dashur ta sqarojmë ministri për Financa, se kemi të bëjmë me të njëjtin projekt, nëse ka pasur atje punë brenda ligjit apo jo, janë organet tjera të cilat e shqyrtojnë. Ne nuk kemi nevojë të paragjykojmë këtu, por është fjala për të njëjtin projekt në amendamentin 18. Por, në këtë amendament tregon se ku duhet të merren mjetet. Thotë: nga shuma. Kisha dashur ta shpjegojmë ministri për Financa. Thotë nga kodi buxhetor 800 000, hiqen 400 000 dhe barten për projektin e stadiumit Kompleksi

Memorial “Zahir Pajaziti”. Andaj këtë dilemë le ta sqarojë ministri për Financa dhe ecim përpara.

KRYETARI: Safete Hadërgjonaj, kërkoj falje meqë ka shumë të lajmëruar për diskutime dhe jemi duke shkuar vetëm në qartësime, por jo edhe në konkluzione. Do të ishte mirë që Komisioni për Buxhet dhe Financa të përgatitet për një propozim.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!
Faleminderit që më në fund ma dhe fjalën!

Nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve na ka ardhur një amendament për të cilin jam pajtuar me Donikën, sepse si anëtarë të komisionit nuk e kemi parë fare dhe këtu ka dyshim të shumta në projektet kapitale. Unë dua t’ia shpjegoj zëvendëskryeministrit të Qeverisë, por edhe ministrit, që në momentin kur Buxheti arrin në Kuvend, kompetencat kalojnë te deputetët dhe deputetët vendosin se si do të jetë buxheti më tutje. Qeveria ka të drejtë të bëjë amendamente dhe t’i sjellë t’i sjellë në Komisionin për Buxhet, E ne i shqyrtojmë. A i pranojmë a s’i pranojmë, është çështje e arsyeshmërisë, të cilën e japim në Komisionin për Buxhet dhe ne ia propozojmë Kuvendit ato projekte dhe ato amendamente, që konsiderojmë se janë të nevojshme për t’u miratuar.

Mirëpo, nuk ka nevojë më të ndërhyjë Qeveria në buxhet, kur buxheti vjen në Kuvend. Kësaj radhe, ne kemi pasur mirëkuptimin që të gjitha ndryshimet të cilat kanë ardhur nga Qeveria t’i përkrahim për të shkuar projektet në disa projekte të tjera, që kemi konsideruar se janë më të nevojshme. Mirëpo, aspak nuk ka arsyeshmëri me ndryshime të mëdha të cilat i ka bërë në projektet kapitale zëvendëskryeministri në projektet kapitale. Të gjitha projektet i ka ndryshuar. Ka projekt që ka prur nga 400 mijë euro në zero mjete, ka projekt që e ka ngritur nga 200 mijë euro në 400 mijë euro. Ne ia kemi përkrahur si deputetë, e kemi prur rekomandimin në Kuvend dhe rekomandimi ka kaluar në Kuvend.

Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe për Arsim..., amendamenti i tyre është i inkorporuar në nenin 18, pika 10. Ne e kemi votuar. Mos na ktheni për ta rivotuar këtë amendament, sepse ne nuk do të votojmë fare mandej për të, dhe do të shkojë amendamenti që ka ardhur me propozim fillestar.

Prandaj, ju lutem, amendamenti i Komisionit për Arsim le të tërhiqet krejt, amendamenti numër 50 është i inkorporuar, është i votuar në amendamentin numër 18 dhe ne s’kemi nevojë ta votojmë dy herë.

Prandaj, ju kisha lutur që t’i kuptojmë kompetencat tona. Në momentin kur vjen buxheti në Kuvend, Kuvendi vendos për buxhet dhe Qeveria mund të japë sqarime mandej dhe të na sqarojë neve në momentin kur kërkojmë të bëhen ndryshimet, sa ka arsyeshmëri e sa s’ka. Prandaj, konsideroj si çështje të mbyllur, ta tërheqim amendamentin e Komisionit dhe të konsiderohet i miratuar me amendamentin 18, që faktikisht e kemi votuar. Kjo është pjesë e tabelave buxhetore.

KRYETARI: Ministri Hajredin Kuçi e ka fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Mendoj që propozimi i kryeministrit është propozim me vend, i ka disa arsye se duhet të jetë dhe besoj që e përkrah edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike.

E para është, që nuk shqyrtohen dy herë të njëjtat çështje. Është parim juridik, “ni bisi ni dem”. Të mos flas kështu shumë latinisht, por neni 18 e ka rregulluar.

E dyta, për sqarim të të gjithëve dhe të opinionit publik, nuk nënkupton që këto mjete do t’i derdhen dikujt me automatizëm, por ministri i Kulturës do të jetë ai që vendos për të ardhmen e tyre. Nëse mbesin ato mjete, do të kthehen prapë në një destinim tjetër. Dhe, unë mendoj që propozimi i kryeministrit duhet të vihet në votim, të tërhiqet ky amendament dhe të vazhdojmë më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për një propozim drejt përfundimit.

NASER OSMANI: Faleminderit!

Dua të flas në cilësinë e kryetarit të Komisionit Funksional.

Kryeministri sqaroi shumë qartë. Ne këtë kërkesë të Komisionit e kemi aprovuar në amendamentimin numër 18, në pikën 9 dhe 10, prandaj, kryetari i Komisionit që ka bërë kërkesën, duhet ta tërheqë dhe të shkojmë me votim më tutje.

Por, nuk mund ta tërheq dikush tjetër, pos kryetarit të Komisionit Funksional, që ka bërë amendamentimin.

KRYETARI: Atëherë, shkojmë drejt votimit. Shumë e qartë është, në qoftë se votohet kundër ajo hiqet.

E ka fjalën Nait Hasani, në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Meqë, ky amendament është miratuar në amendamentin 18, pika 10, ne si Komision e tërheqim dhe vazhdojmë votimin.

KRYETARI: Faleminderit , deputet i nderuar!

Kalojmë në amendamentin 51. Deputeti Visar Ymeri, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Ministri i Financave e ka fjalën.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Komuna e Prishtinës e ka pranuar qarkoren buxhetore, sikurse edhe komunat tjera, në afatin ligjor, por ka miratuar një buxhet tjetër prej qarkores buxhetore dhe, normalisht Qeveria nuk e ka aprovuar atë dhe nuk e ka përfshirë në tabelat buxhetore.

Propozimi i Qeverisë është, që ky amendament të tërhiqet, Kuvendi të kërkojë nga Komuna e Prishtinës, që gjatë janarit në Kuvendin Komunal të aprovojë buxhetin në përputhje me qarkoren buxhetore dhe pastaj, Kuvendi të autorizojë Ministrinë e Financave, që ne të bëjmë përmirësimin e tabelave buxhetore, në përputhje me buxhetin e aprovuar në Kuvendin Komunal, sipas qarkores buxhetore.

Ministria e Financave i ka të rezervuara 6,2 milionë euro, që është diferenca në mes buxhetit të Komunës së Prishtinës, që është në këtë projektligj dhe buxhetit sipas qarkores buxhetore, kështu që nuk ka asnjë problem që ne të kompensojmë diferencën në mes këtyre dy buxheteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Është e vërtetë, që këtu për buxhetin e komunës së Prishtinës, i cili është miratuar nga Kuvendi Komunal në vlerën prej 69 milionë euro dhe e cila nuk është pranuar nga Ministria, kur është bërë ndryshimi, ka shkuar nën qarkoren buxhetore. Pra, nga Ministria është paraqitur para nesh deputetëve një buxhet, i cili ka 56 milionë, në vend të 62 milionë, sa ka qenë vlera në qarkoren buxhetore.

Këtë që e thotë ministri, është një propozim se si ta rregullojmë këtë çështje. Unë mendoj, se propozim më i mirë dhe më mirë do të rregullohej kjo çështje, po ta miratonim ne tash buxhetin me 62 milionë euro për komunën e Prishtinës, si Kuvend qendror dhe pastaj të kërkojmë nga Kuvendi Komunal i komunës së Prishtinës, që t'i bëjë përshtatjet sipas këtij buxheti.

Pra, në vend të 69 milionëve sa i kanë miratuar ata, ta bëjnë përshtatjen për 62 milionë, sa ndahet me qarkoren buxhetore, sepse natyrisht, Kuvendi Qendror është përmbi kuvendet komunale dhe vendimet e Kuvendit Qendror do të duhej të bëheshin automatikisht të obligueshme për kuvendet komunale, apo jo?

Kështu që në këtë drejtim, ne e kryejmë punën me një votim në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe pastaj i bie, ose i mbetet që Kuvendi Komunal i Prishtinës ta bëjë përshtatjen në bazë të asaj shume që është ndarë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Më lejoni të sqaroj edhe njëherë.

Kuvendi i Kosovës aprovon buxhetet e komunave pasi të kalojnë nëpër Kuvendet Komunale. Nëse nuk kalojnë nëpër kuvendet komunale, Ligji i financave të pushtetit

lokal dhe Ligji për menaxhimin e financave publike e obligon Kuvendin e Kosovës, që ta aprovojë për ato komuna buxhetin e vitit vijues.

Kështu që është e nevojshme që fillimisht të kalohet buxheti në Kuvendin Komunal dhe mandej të sillet në Ministri të Financave, për të bërë harmonizimin e tabelave. Është krejt çështje teknike, pa asnjë problem mund të rregullohet gjatë muajit janar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është paraqitur zoti Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Besoj që ministri shumë qartë e shpjegoi procedurën se si duhet të shkohet të miratohet buxheti. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe për pushtetin lokal është shumë i qartë. Komunat duhet të aprovojne buxhetin konform bazës ligjore, sipas qarkoreve të cilat janë dorëzuar.

Kjo nuk është bërë nga komuna e Prishtinës, përkundër kohës shtesë e cila i është dhënë nga ana e Ministrisë së Financave, sepse kanë pasur një shqyrtim ndryshe dhe një opsion tjetër të buxhetit dhe ky është opsion i hapur, të cilin ata e kanë në çdo kohë.

Komuna, e cila nuk mund ta aprovojë buxhetin brenda afatit, në çdo komunë, kërkon nga Qeveria, Ministria e Financave, që prapë në kuvend të miratohet konform asaj të cilës e jep propozimin, por gjithmonë në harmoni me qarkoren, të cilën i dorëzon Ministria e Financave.

Pra, është shumë e qartë që kjo duhet të tërhiqet dhe normalisht, të vazhdojë sipas procedurave të rregullta ligjore.

KRYESUESI: Faleminderit!

Votojmë amendamentin 51. Votojmë tani!

Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 51. Deputeti Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zoti Topalli, a doni të flisni? Merreni fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Më lejoni, që diskutimin tim ta filloj me një pyetje.

A e dini sa euro në ditë merr një qytetar, i cili jeton nga ndihmat sociale? Nuk e dini!

Po ju tregoj unë. Një qytetar në Kosovë, i cili jeton nga ndihmat sociale merr 0,63 centë në ditë. Nuk po flas për njëqind qytetarë, nuk po flas për njëmijë qytetarë, nuk po flas për dhjetëmijë qytetarë, nuk po flas për pesëdhjetëmijë qytetarë, po flas për 121 mijë qytetarë në Kosovë, që jetojnë me nga 63 centë në ditë.

Asnjëri prej jush nuk diskutoi deri më tash për këtë çështje. Shumica prej jush keni fëmijë. Ju lutem, tregoni a ka mundësi që fëmija juaj ta kalojë ditën me 63 centë në ditë?

Zoti Grabovci, ju lutem, më thoni a mund ta kalojë fëmija juaj ditën me 63 centë në ditë? Nuk e kalon! Nëse jeni i sinqertë, e thoni që nuk e kalon. Edhe ju zoti Beqiri, a e kalon një fëmijë, a ka mundësi që ta kalojë ditën me 63 centë në ditë? Nuk e kalon dot, në qoftë se jeni të sinqertë.

Unë kam sjellë me vete një bukë, e cila peshon 500 gramë. Kjo bukë kushton 35 centë. Me këtë bukë, një qytetar i cili jeton me ndihma sociale, ka mundësi vetëm një ta blejë, sepse buka e dytë nuk blihet me 28 centë. Me një bukë s'ka mundësi ta kalojë një qytetar ditën. Mjafton ndoshta, për mëngjes, mjafton ndoshta edhe për drekë, por nuk mjafton për darkë.

Unë sot kërkoj prej jush, të nderuar deputetë e deputete, sado qesharake të ju duket kjo temë, që ju t'u mundësoni qytetarëve të Kosovës që jetojnë me ndihma sociale, që janë 121 mijë, pak më i vogël se numri i pjesëtarëve të komunës së Prizrenit, më i madh se numri i banorëve të komunës së Ferizajt. Kërkoj prej jush, që këtë shumën prej 63 centësh ta ngitni në 1 euro e 26 cent. Kërkoj prej jush, që 121 mijë qytetarëve t'u mundësoni jo ta blejnë vetëm një bukë, por t'i blejnë tri bukë të tilla.

A është kjo shumë? Nuk është shumë! Këta njerëz kanë nevojë sot për bukë, nuk kanë nevojë nesër. Këta njerëz nuk mund të presin planet ekonomike, që ka zoti Thaçi e zoti Mustafa, sepse po ikin në Çeki, në Poloni, në Gjermani, në Zvicër, e në vende të ndryshme të botës. Nuk mund të kërkonin prej tyre, që të mos largohen për arsye patriotike, e të mos jeni në gjendje t'u siguronin tri bukë në ditë. Kaq kërkohet prej jush.

Ju po mbroni vetëm interesat e atyre, që janë të pasur në Kosovë, mendoni edhe për njerëz që nuk kanë, mendoni edhe për fukaranë. Unë e di që autostradat janë të mira për të gjithë, por këta 121 mijë qytetarë, që i ka Kosova e që jetojnë me ndihma sociale, nuk mund t'i shfrytëzojnë këto autostrada.

Prandaj, kërkoj prej jush që ta miratoni këtë amendament dhe të shkoni me ndjenjën e mirë në shtëpi, që u keni ndihmuar 121 mijë qytetarëve të Kosovës dhe që u keni mundësuar, që nesër të kenë më pak uri se sa kanë sot, sepse edhe 1 euro e 26 centë janë pak.

Tash, ju do të thoni, ku do t'i marrim këto mjete, u diskutua disa herë se ku do të merren mjetet. E di që buxheti i Kosovës ka këto mundësi që ka, megjithatë, ka mundësi që këtij buxheti t'i hiqet dhjami. E di, që është sigurisht e mundur që këto mjete që kërkohen për këtë kategori sociale të sigurohen, sepse fjala është për një numër të madh të qytetarëve.

Ne e dimë, që ju keni propozuar 70 zëvendësministra, janë tepër, nuk ka nevojë për 70 zëvendësministra Kosova. E di, që keni bërë disa shkurtime në makina, megjithatë ka mundësi prapë që ky buxhet të zvogëlohet. Dhe në fund të fundit, edhe ky është një propozim, në qoftë se jemi keq me kohë dhe nuk kemi mundësi që të shikojmë me saktësi, ku mund të sigurohen mjetet, ku mund të ketë mjete që mund t'i përdorim për këtë kategori, ka mundësi që për vitin e ardhshëm të ndërtojmë 2.5 km më pak autostradë,

në mënyrë që këta 121 mijë qytetarë t'i kenë nga tri bukë në ditë. Kaq kërkohet prej jush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Shiko , zoti Topalli.

Unë të kuptoj, që je shumë melankolik, ky nuk është teatër, ky është Kuvend. Ju i takoni një partie politike dhe unë e çmoj atë, por, mos më moralizo mua si Ismet Beqiri, si deputet i barabartë dhe mos më trego çka duhet të bëj.

Në mënyrën më të sinqertë po e them, vërtet kjo është luajtje me ndjenja të njerëzve. Ti mund ta arsyetosh atë që e thoni, ne jetojmë në Kosovë dhe mos më shpjego ti mua kush me sa jeton, sepse këtë hall të qytetarëve të gjithë jemi të thirrur këtu ta ndajmë, ta shohim mundësinë për t'u ndihmuar. Por, vërtet nuk na duhen këso gjërash, këso lojërash, edhe me fjalë dhe me të vërtetë është diçka që në nderin e deputetit nuk shkojnë këto gjëra për të bërë teatër këtu në një Kuvend serioz ku ju e thoni mendimin tuaj, por s'ke nevojë të më drejtohesh ti mua a e di unë apo s'e di se me sa jetojnë ose sa marrin qytetarët me asistencë sociale në ditë.

Mos se kjo nuk ndihmon kurrgjë, absolutisht, e as atyre nuk u ndihmon kurrgjë. Prandaj është mirë me e thënë mendimin tuaj dhe mos se nuk është hera e parë që merreni me gjëra për mua, më vjen keq për ta thënë sinqerisht nga ata qytetarë, gjëra teatrale dhe nuk duhet t' i bëni këto gjëra se jemi në Kuvend dhe jemi deputetë që kemi përgjegjësi.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Më vjen keq, nëse kjo çështje konsiderohet teatër, sepse nuk është fjala për diçka të vogël, por është fjala për 121 000 qytetarë që jetojnë me nga 63 centë në ditë, respektivisht organet të cilat ne i kemi zgjedhur, Agjencia për Statistika, nëse shikoni me saktësi në tremujorin e fundit të këtij viti, thotë që në Kosovë jetojnë 121 833 qytetarë me ndihma sociale, respektivisht 29 538 familje.

Në qoftë se këtë shumë e pjesëtojmë me numrin e atyre që marrin ndihma sociale i bie që çdo qytetar që jeton nga ndihmat sociale merr 229,82 euro në ditë, aq sa marrin deputetët për mëditje, për tri-katër mëditje.

Pra, unë po flas me fakte me shifra të cilat ju zoti Beqiri i injoroni, ndoshta edhe i keni harruar, ndoshta edhe ju interesojnë fare, sepse nuk e keni hallin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Votojmë amendamentin 52. Regjia, votojmë tani.

Me 52 vota kundër, 1 abstenim dhe 27 për, nuk miratohet amendamenti 52.

Amendamenti 53. Deputeti Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti Hasani, e keni fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Amendamentin e kam bërë në shenjë respekti për njerëzit që na kanë mundësuar që Kosova ta ketë edhe mundësinë si shtet, si Kuvend dhe si president. Këtë amendament e kam bërë në shenjë të atyre që dhanë jetën në Koshare, deri në Pashtrik është një rrugë që nuk mund të shkojë askush atje, është një rrugë që vetëm ushtarët e kanë kaluar. Vetëm ata njerëz që e kanë dashur vendin, atdheun, vetëm ata njerëz që kanë mundësuar që edhe Kosova të jetë sot shtet.

Kam kërkuar dhe kërkoj që ata njerëz që i lanë gjurmët e historisë dhe ngritën edhe këtë shtet me gjakun e tyre, që kjo rrugë që është diku 10 kilometra buzë Pashtrikut deri te vendi i rënies të investohet nga Qeveria dhe t'u mundësohet familjeve, njerëzve, fëmijëve të tyre, të gjithë atyre që e donë vendin, kanë dashur vendin dhe janë të gatshëm ta mbrojnë vendin tonë, të shkojnë ta vizitojnë atë rënie të njerëzve që sot janë heronj të Kosovës.

Prandaj, është një shumë që Qeveria ka mundësi ta sigurojë, mund ta ndajë edhe në faza këtë projekt dhe kjo është e mundshme, sepse me këtë realizojmë një amanet të dëshmorëve dhe të familjeve që shkojnë ta vizitojnë.

Ky projekt është me vlerën 800 000 euro, nuk e kanë paraparë ose nuk kanë dashur ta miratojë Komisioni për Buxhet dhe Financa, është çështje e tyre, e di që ndoshta kanë pasur frikë, por nuk duhet të frikohemi nga e kaluara, nuk duhet të frikohemi prej të ardhmes, po duhet të besojmë se e ardhmja është jona dhe e kaluara na e ka ndërtuar këtë të ardhme.

Prandaj kërkoj nga deputetët që edhe ministri ta gjejnë kodin buxhetor, ta gjejnë mundësinë që ta futin në vi buxhetore për vitin 2015 në buxhet, ta rregullojnë këtë rrugë që të paktën njerëzit të shkojnë, ta dinë vendin ku i kanë rënë 46 dëshmorë në Pashtrik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Votojmë tani amendamentin 53 të deputetit Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit funksional. Votojmë tash.

Faleminderit! Me 34 vota janë për, 2 abstenime dhe 42 kundër, nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 54, i deputetit Sali Salihu, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

A e doni fjalën zoti Salihu? Zoti Salihu e ka fjalën.

SALI SALIHU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë kam bërë gjithashtu një kërkesë për ndërtimin e një shkolle në fshatin Pozharan të komunës së Vitisë, është fjala për shkollën fillore” Halil Alidema” që mësojnë 1 mijë nxënës. Objekti i tanishëm është ndërtuar në vitet e 60-ta dhe tash është në gjendje shumë të keqe, afër shkatërrimit që paraqet edhe rrezik për jetën e nxënësve që mësojnë. Ky fshat është fshati më i madh në komunën e Vitisë dhe në vitet 60-ta ky fshat ka pasur edhe Shkollë të Lartë Pedagogjike, ndërkaq tash 55 vite mbas, do të thotë nxënësit mësojnë në një shkollë e cila nuk ka kushte minimale për mbajtjen e mësimit dhe paraqet rrezik për jetën e tyre.

Prandaj, kërkoj mirëkuptim nga kolegët dhe t’i shikojnë fotografitë të cilat ia kam bashkëngjitur amendamentit për të parë se në çfarë gjendje është kjo shkollë dhe kërkoj nga kolegët që ta përkrahin këtë amendament.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur. Atëherë amendamenti 54 i deputetit Sali Salihu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tani.

Më 44 vota për, 3 abstenime dhe 49 kundër, nuk miratohet amendamenti 54.

Amendamenti 55, i deputetit Sali Salihu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zoti Salihu, në qoftë se e doni fjalën, urdhëroni!

SALIH SALIHU: Gjithashtu kërkoj që të asfaltohet rruga Gërlicë-Viti, e cila e lidh komunën e Vitisë me magjistralen Prishtinë-Shkup. Është një rrugë mjaft e frekuentuar dhe është një rrugë e cila është në shkatërrim për shkak të gropave të thella që janë krijuar. Konsideroj se është me interes ekonomik për komunën e Vitisë. Këtë rrugë e shfrytëzojnë edhe qytetarët e Gjilanit, të cilët shkojnë më shkurt për në Shkup. Kjo rrugë, përveç tjerash, po paraqet rrezikshmëri për jetë, sepse aksidentet të cilat po shkaktohen duke u përpjekur për t’u mënjeluar gropave të thella nuk janë domethënë të ralla, prandaj kërkoj që të parashihet buxhet për ndërtimin kësaj rruge. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë votojmë tani amendamentin 55 të deputetit Sali Salihu pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash.

Me 24 vota për, 4 abstenime , 50 kundër, nuk miratohet amendamenti 55.

Amendamenti 56 i deputetit Salih Salihu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zoti Salihu e keni fjalën.

SALIH SALIHU: Gjithashtu, edhe segmenti i rrugës Klllokot-Viti është në gjendje shumë të keqe, është e gjatë vetëm 6 kilometra dhe dëmet që po u shkaktohen automjeteve sepse komuna e Vitisë i ka diku rreth 8 mijë automjete të lehta e të rënda dhe dëmet që po u shkaktohen atyre në amortizim dhe në goma janë mjaft të mëdha, prandaj ata po paguajnë domethënë taksën rrugore dhe kjo pagesë e tyre nuk po u kthehet në investim të infrastrukturës, prandaj kërkoj që të përkrahet edhe ky amendament, sepse është nevojë e domosdoshme e qytetarëve se kjo rrugë është mjaft e frekuentuar kështu që i kisha lutur që kolegët tanë ta përkrahin këtë amendament.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

Votojmë amendamentin e deputetit Salih Salihu 56, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONal. Votojmë tani.

Më 26 për, 4 abstenime dhe 47 kundër, nuk miratohet amendamenti 56.

Amendamenti 57 i deputetes Alma Lama, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONal. Zonja Alma e keni fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt ky amendament është renditur gabim me sa e shoh nga Komisioni, sepse përmbajtja e këtij amendamenti është votuar tashmë në amendamentin numër 7 i cili i referohet përfshirjes në Ligjin për veteranët e luftës, invalidët dhe dëshmorët e tjerë. Janë përfshirë edhe viktimat e dhunës seksuale, kështu që mendoj se është i përmbushur, ndoshta Komisioni nuk ka pasur të drejtë ta marrë autorësinë, mund të bënte plotësim-ndryshim, sepse kemi edhe një ligj për mbrojtjen e të drejtës së autorit, zoti kryetar i Komisionit, por për mua është shumë e rëndësishme që kjo është përfshirë dhe gratë, viktimat e dhunës seksuale do të kenë mundësinë të përfitojnë nga ligji, kështu që falënderoj shumë Komisionin dhe të gjithë ata që e kanë përkrahur. Faleminderit!

KRYESUESI: Domethënë e tërhiqni? Atëherë amendamenti 57 i deputetes Alma Lama tërhiqet me vullnet, duke e marrë parasysh atë që e sqaroi.

Amendamenti 58, i deputetit Besnik Bislimi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONal. E keni fjalën zoti Bislimi.

BESNIK BISLIMI: Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë shqyrtimin e amendamenteve një nga një, nga kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa na u rekomandua që të mos e votojmë asnjë rekomandim apo amendament i propozuar nga deputetët të cilët nuk e kanë marrë miratimin e Komisionit për Buxhet e Financa.

Logjikisht kishte me qenë përfundimi se këta e kanë bërë punën në mënyrë shembullore dhe nuk ka nevojë të merren me ato amendamente që nuk janë të logjikshme.

Fakti që ne tash po diskutojmë amendamente pa përkrahje, që vijnë kryesisht nga opozita, na tregon se sa ka qenë serioz Komisioni për Buxhet dhe Financa. Unë kam qenë në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe aty i gjithë debati ka qenë, votoma mua një projekt, ta votoj unë ty një projekt, e në asnjë moment të vetëm nuk është diskutuar për nacionalitetin e amendamenteve të deputetëve.

Amendamenti që e kam propozuar unë, është në kodin 981 për investime kapitale në arsimin para universitar, ku kërkoj nga Ministria e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë të alokojë 1 milion euro për ndërtimin e një shkolle në lagjen Vetërnik të komunës së Prishtinës. Është fjala për një lagje e cila pas luftës ka ekspanduar në mënyrë të

pashembullt në nivel të Kosovës, duke arritur brenda pak viteve numër të banorëve që tejkalon edhe numrin e përgjithshëm të banorëve të disa komunave të vogla të Kosovës, por në të njëjtën kohë nuk është përcjell me infrastrukturë përkatëse. Aty nuk ka asnjë çerdhe, nuk ka shkollë, nuk ka kënde të lojërave, thjeshtë mungon komplet infrastruktura publike.

Kjo, ka krijuar kosto shtesë dhe rreziqe shtesë për anëtarët e familjeve të cilët i detyrojnë që fëmijët e tyre t'i dërgojnë nëpër shkolla dhe çerdhe anekënd Prishtinës dhe ndërtimi i një shkolle fillore sipas mendimit tim do të ishte minimumi i përkushtimit që kjo Qeveri dhe ne si deputetë do të tregonim për banuesit e kësaj lagje.

Krejt në fund, desha të rikujtoj edhe një herë ministrin Kujtim Shala se unë ia kam bërë një pyetje dhe ai nuk ka dashur të përgjigjet ose nuk është lejuar nga Kryesia e Kuvendit që të përgjigjet në këtë pyetje. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të lajmëruar për diskutim. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash.

Me 52 vota kundër, 25 për dhe 5 abstenime, nuk nuk kalon amendamenti 58.

Amendamenti 59. Deputeti Besnik Bislmi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

BESNIK BISLIMI: Nga mënyra e votimit po shihet qartë se sa ne deputetët e kemi për zemër Buxhetin dhe sa diskutojmë për të në bazë të prioritetëve që i kemi caktuar dhe sa në bazë të direktivave politike.

Po kaloj te amendamenti tjetër, me të cilin kam kërkuar që Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për veprimtari kërkimore dhe shkencore t'i alokohen 11,03 milionë euro.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdimësi është dokumentuar se resursin e saj më të rëndësishëm Kosova e ka fuqinë punëtore. Si pasojë logjike e një konkludimi të tillë, e me të cilin pajtohem plotësisht, Kosova në përpjekje të saj për të krijuar përparësi krahasuese ndërkombëtarisht do të duhej ta fuqizonte këtë resurs.

Mënyra më e mirë për ta avancuar kapitalin human është përdorimi i alokimeve buxhetore në atë mënyrë që drejtpërdrejt ndihmojnë në avancimin e mëtejshëm të kualitetit të këtij resursi. Në të njëjtën kohë, ne kemi radhitur rritjen ekonomike si prioritetin primar të Qeverisë, si në mandatin e tanishëm, ashtu edhe në ata të mëparshmit.

Rritja ekonomike mbështetet duke mbështetur burimin kryesor të rritjes, që në këtë rast është fuqia punëtore. Investimet në veprimtari kërkimore dhe shkencore janë imput shumë me rëndësi në rritjen e kapacitetit të resurseve tona humane, me çka njëkohësisht

kontribuohet në rritjen e atraktivitetit të Kosovës edhe për investitorët potencialë nga jashtë.

Të nderuar deputetë,

Kjo çfarë thash më sipër, në fakt është në kundërshtim me amendamentin që e kam propozuar. Të thuash se kapitali human është aq me rëndësi dhe në të njëjtën kohë të kërkosht vetëm 11,03 milionë euro për një vit të tërë për veprimtari kërkimore dhe shkencore, që i bie më pak se shuma që kjo Qeveri ndan për një kilometër asfalt, është e pakuptimtë. Mbase do të ishte dashur të rekomandonim që për fushë ta alokohen diku 35 deri 50 milionë euro në baza vjetore.

Ajo që unë kam kërkuar, në fakt, nuk pasqyron preferencat e mia, por reflekton vetëm obligimin tonë ligjor që kemi si deputetë. Ligji numër 04/135 për veprimtarinë kërkimore-shkencore, respektivisht neni 5 i tij, që merret me financimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, thotë si vijon: “Për sigurimin e kushteve dhe mjeteve të nevojshme për veprimtari kërkimore-shkencore, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan 0,7% të buxhetit vjetor vendor”. Këto mjete shfrytëzohen dhe shpjegohen pastaj se cilat janë aktivitetet.

Ju rikujtoj, të nderuar deputetë, se ky nuk është një ligj i vjetër, por i miratuar po në këtë Kuvend vetëm një vit e gjysmë më parë, me shumicën e votave tuaja.

Në shqyrtimin e dytë të këtij ligji, më 29 mars të vitit të kaluar, një pjesë e deputetëve madje kanë qenë kundër futjes në ligj të obligimit për alokimin e 0,7% për këtë veprimtari, edhe atë jo pse janë dukur shumë, por pse janë ndjerë të turpëruar për faktin që vendi ynë e injoron shkencën deri në këtë përmasë.

Ajo që më habit, të nderuar deputetë, është që shumica e anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa kanë vendosur me aq lehtësi të mos e përkrahin këtë amendament, duke votuar hapur për shkeljen e ligjit që e kanë votuar vetë.

Unë jam i vetëdijshëm për limitimet e tmerrshme me të cilat sfidohen disa nga kolegët e mi deputetë, me dëshirën e tyre për të kuptuar rolin që ka dija në avancimin e shoqërisë tonë. Po ashtu, jam i vetëdijshëm për limitimet e tmerrshme që kanë këta deputetë për implikimet që mund të dalin nga rastet kur ne vetë në mënyrë selektive vendosim se cilat ligje do t'i respektojmë, e cilat jo.

Njësoj siç jam shumë i tronditur që unë sot detyrohem, në prani të ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të dal e të argumentoj në vend të tij se pse duhet të ndihmohet veprimtaria kërkimore-shkencore, kur ai vetë në Qeveri ka votuar kundër mbështetjes së shkencës.

Është e pakuptueshme se si ne deputetët e Kuvendit të Kosovës me aq lehtësi vendosim për ta financuar jashtëligjshëm një medium propagandistik siç është RTK-ja, duke u munduar që këtë mbështetje ta arsyetojmë me nevojën e respektimit të ligjit, e në të njëjtën kohë ta refuzojmë mbështetjen e shkencës dhe hulumtimeve.

Të nderuar deputetë,

Ju lus që kur të votoni për këtë amendament ta keni parasysh se nuk po votoni për mbështetjen ose jo të një propozimi të një deputeti të opozitës, por do të votoni për respektimin apo shkeljen e qëllimshme të ligjit në fuqi.

Si deputetë të Kuvendit, ndërmjet tjerash, jemi betuar se do të angazhohemi për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, vetëm nuk e kam ditur se këtu duhet t'jua rikujtoj në secilën seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për diskutim është lajmëruar Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë në parim e përkrah propozimin e zotit Bislimi. Kjo shumë prej 11,03 milionë euro është shumë e vogël, mirëpo nëse analizohet në mënyrë komplekse duhet të ndërhyhet edhe me planin e bashkëpunimit, edhe të linjës buxhetore të Universitetit, që të gjenden mjete me universitetet tjera dhe në projekte të ndryshme të rritet kjo vlerë në fushën e zbulimeve dhe të kërkimeve.

Kjo do ta rriste po ashtu edhe kualitetin brenda Universitetit, sepse e ngre edhe konkurrencën për ta nxjerrë kualitetin në veprime të tilla.

Është e vërtetë që e kemi caktuar një shumë në Parlamentin e kaluar, por kjo shumë duhet të rishikohet, që në linjën buxhetore ministri sot dhe Kuvendi që është themeluesi i Universitetit nuk është duke e nxjerrë në veten si themelues i universitetit, që në linjën buxhetore të kemi mundësi t'i japim fleksibilitet atij në vetëkrijimin e këtyre fondeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të lajmëruar deputetë të tjerë për diskutim. Jemi te amendamenti 59. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 33 vota për, 4 abstenime dhe 43 vota kundër nuk kalon amendamenti 59.

Amendamenti 60. Deputeti Besnik Bislimi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

BESNIK BISLIMI: Natyrisht që pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, sepse as nuk i kanë lexuar fare, por veç u ka mjaftuar që vijnë prej opozitës.

Vetëm të konstatoj edhe një herë: 43 deputetë votuan hapur për shkeljen e ligjit. Duhet të konsultojmë dhe të shohim çfarë konsekuencash ligjore mund të ketë në qoftë se ne vetë si deputetë hapur e shkelim ligjin këtu në Kuvend.

Amendamenti tjetër, të cilën e kam propozuar unë, ka të bëjë me alokimin e 2 milionë eurove në kodin 418 për rehabilitimin e rrugëve për Ministrinë e Infrastrukturës, që ka të bëjë me rehabilitimin e rrugëve rurale në fshatrat e brezit kufitar të komunës së Dardanës.

Unë nuk kam qenë më shumë se një herë në ato fshatra, andaj nuk kam kurrfarë interesi personal, e as si deputet, por thjesht për rëndësinë që kanë fshatrat e brezit kufitar të komunës së Dardanës.

Një pjesë e madhe e këtyre fshatrave, si Polickë, Shipashnicë e Epërme, Kikë, Tugjec, Decivojcë, Koretin, Gmicë. Gjyrishec, ose nuk janë të lidhura fare me rrugë të asfaltuara, ose kanë rrugë të pamirëmbajtura për më shumë se një dekadë. Si pasojë ka ardhur te një dukuri shumë e rrezikshme për një zonë kufitare, braktisja e fshatrave.

Anashkalimi i asfaltimit të rrugëve në një komunë me përmasa kaq të mëdha, siç është rasti i Dardanës, është i pashembullt në komunat e Kosovës. Një shikim shumë i shpejtë i tabelave buxhetore tregon për masa shqetësuese të injorimit që i është bërë komunës së Dardanës ndër vite në sferën e investimeve kapitale, sidomos në pjesën e financuar nga grantet qeveritare.

E vështirë për t'u besuar, por për gjithë vitin 2015 Qeveria, në pozicionet e granteve për investime kapitale në komunën e Dardanës ka aprovuar vetëm 117 mijë euro, që janë vetëm 10 metra asfalt i autostradave. Sa për krahasim, për ta bindur secilin prej jush për përmasa të këtij diskriminimi të komunës së Dardanës, komuna e Mamushës, që e ka madhësinë e një fshati mesatar të komunës së Dardanës, ka marrë trefish më shumë grante për investime se Dardana. Leposaviqi që nuk derdh asnjë cent në Buxhetin e shtetit ka marrë si shpërblim nga i njëjti shtet 10-fish më shumë se Dardana. Për të përfunduar me rastin e komunave të Drenasit dhe Skenderajt, të cilat kanë marrë 22 herë më shumë mjete për investime kapitale se komuna e Dardanës.

Të nderuar deputetë,

Votimi i këtij amendamenti dhe përkushtimi për asfaltimin e këtyre rrugëve e ndihmon në disa aspekte këtë zonë, si për mbajtjen e fshatarëve në ato zona, ngjalljen e shpresës për mundësinë e mbijetesës atje, por edhe hap alternativa për zhvillimin e turizmit rural, apo për gjenerimin e të hyrave jashtë bujqësore.

Andaj, ju lus që të paktën një herë ta mbështetni një amendament që vjen nga opozita. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të lajmëruar për diskutim. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë për amendamentin 60, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL të deputetit Besnik Bislimi.

Me 27 vota për, 47 kundër dhe 4 abstenime nuk kalon amendamenti 60.

Amendamenti 61. Grupi Parlamentar "Nisma" për Kosovën, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

SHUKRIJE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet të nderuar kolegë deputetë,

Përsëritet qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka propozuar një amendament te Komisioni për Buxhet dhe Financa. Ky amendament ka kaluar edhe në Komisionin për Arsim, Shkencë dhe Teknologji. Mendoj që është një prej amendamenteve shumë të arsyeshme, sepse komuna e Malishevës është e vetmja komunë në Kosovë, e cila nuk e ka të funksionalizuar çerdhen për fëmijë. Çerdhja është e ndërtuar, objekti është i gatshëm, por vetëm na duhen mjete si në vijim, e keni tabelën ku janë të paraqitura pozitat dhe shuma totale që mundëson me funksionalizimin e çerdhes, e cila është 57 mijë e 984 euro. Mendoj që nuk është ndonjë shumë që e rëndon Buxhetin e ministrive përkatëse.

Kërkoj përkrahjen e gjithë kolegëve, veçanërisht të kolegeve deputete, sepse nënat e Malishevës duhet të jenë pengë të fëmijëve të tyre, ose ta zgjedhin punën, ose fëmijën. Që të dyja në njëfarë forme nuk ia vlen të sfidohen. Andaj, kërkoj mirëkuptimin e të gjithë deputetëve dhe kërkoj që të votohet ky amendament.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Salih Morina është paraqitur për diskutim.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër Mustafa,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

E konsideroj që është një projekt, të cilin ia vlen të mbështetet. Mirëpo, duke marrë për bazë dhe parasysh që nuk ka pasur edhe mbështetjen e Komisionit Funkcional, unë kërkoj që Kuvendi Komunal i Malishevës të fillojë së implementuari këtë projekt deri në rishikimin e ardhshëm të Buxhetit dhe ky kompensim të kihet parasysh nga Qeveria. Pra, duke marrë për bazë vetëm rishikimin, sepse mundësi buxhetore, me sa shihet, nuk kemi, të paktën që ky amendament ta marrë mbështetjen në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, kërkoj që në rishikim të kihet kjo parasysh nga Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Është një amendament mjaft i rëndësishëm. Ne në komision e kemi shqyrtuar dhe ka marrë edhe mbështetje. Ky amendament ka të bëjë me një çerdhe për fëmijë në një komunë që është mjaft e rëndësishme dhe më herët edhe strategjike.

Për mua është me rëndësi që kemi të bëjmë me një çerdhe dhe kemi të bëjmë me fëmijë, kemi të bëjmë me një edukim të ri të fëmijëve, e nëse kjo është shumë 50 mijë ose 60 mijë euro, e Qeveria nuk ka mundësi t'i sigurojë për fëmijët tanë, atëherë çfarë mund të kërkojmë më tutje. Ne kur kërkojmë projekte për rrugë, ose ku kërkojmë për komisione, ose për Ministrinë për Kthim dhe Komunitete nga 800 mijë euro, e nuk mund t'i sigurojmë 50 mijë euro për çerdhen e fëmijëve në Malishevë, kjo është e dhimbshme.

Për mua është çështje tjetër se a do të mund ta plotësojmë këtë çerdhe, ta mbushim me fëmijë? Prandaj, unë uroj që “Nisma” ta mbushë këtë çerdhe me fëmijë atje...

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj që është e turpshme të flitet në shekullin XXI për një çerdhe, për një qytet, meqë po pretendojmë të hyjmë, e nëse numri i fëmijëve në këtë çerdhe është 300, unë i lus kolegët që ta aprovojmë, sepse nuk është ndonjë shumë, e vërtet për ata fëmijë është me rëndësi, pasi ndoshta edhe Ministria e Shëndetësisë do t'i kursejë ilaçet për ata fëmijë, sepse në linjat e veta buxhetore nuk do të ketë nevojë të merret me sëmundjet e ndryshme të cilat do t'u gjenerohen nga pamundësia që ta kenë në një strehim të tillë.

Prandaj, ne duhet ta respektojmë këtë vendim dhe të votohet si çerdhe. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Por, meqenëse kjo u bë pak si emocionale, u bë edhe e domosdoshme, por kaloi pak edhe në shaka, unë kisha dashur që kjo të mbështetet dhe ta aprovojmë amendamentin 61, që ka të bëjë me kërkesën e shtruar për Malishevë. Unë propozoj që kjo të aprovohet dhe deputetët të votojnë për.

KRYETARI: Adem Grabovci, nga Grupi Parlamentar i PDK-së, e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Kemi të bëjmë vërtet me të ardhmen e fëmijëve. Vlerësoj që, pa marrë parasysh atë që e tha Naiti, ne besojmë që të në ardhmen vërtet ajo të mbushet plot e përplot, prandaj e mbështes këtë projekt që Qeveria e Kosovës ta gjejë anën financiare dhe të përkrahet.

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Unë shpresoj se këtë amendament sot do ta përkrahin të gjithë deputetët, sepse është i një rëndësie të veçantë, sepse në të njëjtën kohë, nëse votohet ky amendament, ua bëjmë një shërbim edhe nënave, por edhe fëmijëve, sepse e dimë se çerdhet në çdo komunë të Kosovës fillojnë t'i pranojnë fëmijët prej moshës 1-vjeçare, ndërsa nënat që punojnë kanë hall se ku do t'i lënë fëmijët e tyre në momentin që ato ikin në punë. Unë shpresoj po ashtu se një përkrahje të veçantë do ta kemi nga Grupi i Grave Deputete dhe mendoj që ky amendament ia vlen të kalohet.

KRYETARI: Faleminderit shumë për diskutimet! Po vërehet se është një konsensus. Atëherë shkojmë më mirë në votim. Ministri i Financave, ju lutem!

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ne si Qeveri pajtohemi me këtë amendament, por duhet ta kemi të qartë se ku t'i marrim mjetet. Propozimi ynë është që të kthehemi tek investimet kapitale në arsimin

parauniversitar, ku është një listë e gjatë e projekteve, e pasi nuk është shumë e madhe mund të marrim proporcionalisht nga secili projekt nga pak për ta bërë këtë shumë prej 57 mijë eurove. Faleminderit!

KRYETARI: Kalojmë në votim. Janë diku rreth 9 diskutues, në qoftë se keni dëshirën për diskutim, unë i lejoj të gjithë, por si do që të jetë, po e shoh se kjo po kalon. Të kemi mirëkuptim pak! Urdhëro Sala Berisha-Shala! Lajmërohuni sa të dëshironi diskutues, të gjithë do të flasin, për arsye se ju duhet, sepse do të kemi zgjedhje prapë ndonjëherë.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Unë nuk e mora fjalën për shaka, por shumë seriozisht e kam. Qeveria e Kosovës në vitin 2011 e ka bërë si të obligueshme që të gjithë fëmijët të përfshihen nëpër çerdhe parashkollore e deri në shkollimin e mesëm të ulët. Edhe unë e mbështes këtë projekt, sepse për tre vjet me radhë ish-deputetja Hasime Krasniqi, që vjen nga Malisheva ka kërkuar që ky projekt të futet në Buxhet, por nuk e ka gjetur as përkrahjen e komisionit, e as të deputetëve. Më në fund, më vjen shumë mirë që po e shoh disponimin e gjithë deputetëve që ky projekt të miratohet në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Haxhi Shala, nga “Nisma”, e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë veç desha t’i falënderoj të gjitha grupet parlamentare për mbështetjen e këtij projekti. Faleminderit!

KRYETARI: Salihe Mustafa e ka fjalën.

KRYETARI: Faleminderit, kryetar!

Më vjen mirë që për projektet që po përkrahen dhe për punët e mira që po bëhen po ka nevojë edhe po kërkojmë fjalë shumë veta. Është e vërtetë që nga Qeveria e kaluar në mandatin e kaluar është ndërtuar kjo çerdhe, me kërkesën e deputetes Hasime Krasniqi si amendament, e tani po kërkohet funksionalizimi i saj. Andaj, unë do ta përkrah, sepse po vazhdojnë punët e mira që kanë filluar. Do ta përkrah dhe uroj që kjo çerdhe të punojë ashtu siç duhet dhe të jetë përplot me fëmijë dhe nënat ta kenë shumë më lehtë ta mbajnë edhe punën, edhe të kujdesen për fëmijët e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Po më vjen mirë që për çështje të rëndësishme dhe për çështje që janë mirë të argumentuara ka konsensus brenda këtij Parlamenti. Kjo po e demanton atë që u tha se partitë votojnë në bazë të interesave politike dhe ne si deputete do ta votojmë amendamentin e koleges nga “Nisma”, sepse besojmë që çerdhet duhet të jenë brenda secilës komunë. Ato janë obligim i qeverisjes komunale, por edhe i institucioneve më të larta, që të ketë vende dhe hapësirë edhe për fëmijët, por, në anën tjetër, që edhe nënat të kenë mundësi që ta kenë një punë dhe të jenë të integruara më shumë në shoqëri. Faleminderit!

KRYETARI: Valdete Bajrami e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Është për të të ardhur keq se momentin që përdoret fëmija për qëllime të caktuara prej gjinisë të kundërt, në këtë rast po flas për gjininë mashkullore, nuk është në njëfarë mënyre etike të përqeshet ashtu dhe të thuhet që të gjithë fëmijët janë të “Nismës” dhe le të mbushet. U mbushtë me fëmijë të “Nismës”, por ata fëmijë janë të të gjithë njerëzve aty.

Edhe tjetra, në momentin që është paraparë të ndërtohet dhe të finalizohet një objekt, është interesant që nuk është paraparë, ose nuk janë ndarë mjetet për staf për të qenë funksionale ajo çerdhe. Kështu që rëndësia e të qenët prind dhe të të qenët femër dallon prej meshkujve, edhe për atë arsye ndoshta iu duk shumë qesharake kur u propozua. Por, faleminderit prej shumicës deputetëve, të cilët treguan gatishmëri për ta përkrahur nismën tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Edhe unë për atë që ky amendament të përkrahet, nuk mund ta fsheh që jam shumë i entuziazmuar që kaq shumë deputetë paska këtu në këtë sallë që kujdesen për fëmijë. Po kujdesen që t’i kenë 50 vende për fëmijë në një çerdhe, ndërsa 50 mijë fëmijë të tjerë, ndoshta edhe më shumë, dëshirojnë t’i lënë të jetojnë me nga 63 centë në ditë. Faleminderit!

KRYETARI: Nait Hyseni e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

E falënderoj Fatonin, e po ta ketë një propozim për një çerdhe, edhe atë do ta mbështetim dhe besoj se të gjithë deputetët do ta mbështetin. Unë e di, i kam parë këtu prej Presidentes e tutje e kanë nga një fëmijë ose nuk kanë fare. Deputetët duhet të jenë shembull dhe Qeveria duhet ta ketë një model që ta ruajë qenien tonë, kombin tonë. Duhet të angazhohet që lindjet të rriten dhe t’i bëjnë nga 4 fëmijë. Prandaj, edhe kjo iniciativë, edhe kjo çerdhe, edhe tjerat, duhet të jenë shembull dhe unë e votoj këtë.

Kryeministrat, zëvendëskryeministrat e kanë nga një fëmijë! Duhet t’i bëjnë nga 4, duhet të jenë shembull model. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Besnik Bislimi e ka fjalën.

BESNIK BISLIMI: Faleminderit!

Është bërë modë tash secili të lajmërohet dhe individualisht të tregojë nëse do ta përkrahë apo jo, edhe pse unë mendova që për këtë është votimi. Unë vetëm desha të them që po më vjen shumë keq që projekti më i ndjeshëm po keqpërdoret për ta treguar një fytyrë krejt tjetër të një koalicioni se ja ne i përkrahim edhe projektet e opozitës. Edhe projekti im që ishte për shkollën në Vetërnik nuk ishte për të rritur, se nuk po mendojmë PDK-në ta kthejmë edhe një herë në shkollë, por është për fëmijë, kështu që në qoftë se paska

pasur ide që fëmijët të mbështeten, atëherë nuk e di pse nuk u mbështet ai projekt. Unë po mendoj se po të propozonim shkollë në Drenas, ndoshta do ta kishin përkrahur.

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E kemi diskutuar edhe në Komision Parlamentar këtë propozim të deputetes, tani i ardhur këtu dhe si propozim i Grupit Parlamentar “Nisma”. Mendoj që më së pari si propozim i Grupit Parlamentar “Nisma” është dashur të jetë më preciz, i hartuar më mirë, duke pasur parasysh që në përbërjen e vet “Nisma” e ka ish-kryetarin e Kuvendit. Do të duhej që ky amendament të ishte i përgatitur më mirë, i precizuar se ku do të merren këto mjete.

Pasi në mandatin e kaluar është ndërtuar çerdhja, funksionalizimi i saj ka qenë përgjegjësi e qeverisjes komunale në bazë të ligjit dhe arsimit parauniversitar - arsimit i ulët, në bazë të ligjit është përgjegjësi e kuvendeve komunale. Mirëpo, si do që të jetë, pasi Kuvendi Komunal në Malishevë nuk ka qenë i gatshëm ta funksionalizojë këtë çerdhe, ne si Kuvend i Kosovës po e mbështetim këtë nismë që ta funksionalizojmë çerdhen për arsye se duhet thënë qartë që Kuvendi Komunal në Malishevë nuk e ka mbështetur funksionalizimin e saj, edhe pse është ndërtuar nga Qeveria e kaluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri i Financave e ka fjalën, ju lutem!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryetar!

Më lejoni vetëm të sqaroj pasi është fjala për paga për ta funksionalizuar çerdhen, propozimi ynë është që këto t’i marrim nga kontigjenca për paga në Ministrinë e Financave, në mënyrë që të mos i prishim balancat ndërmjet investimeve kapitale, pagave edhe mallrave dhe shërbimeve.

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, me këtë propozim, në rend të parë, të Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën”, në të njëjtën kohë edhe me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe me arsyetimet dhe propozimet e ministrit për Financa, thërras deputetët për votimin e këtij amendamenti, për arsye se ishte edhe fryma për votim. Lus regjinë që të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Me 87 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim kalon amendamenti 61.

Amendamenti 62. Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën”, nuk e ka përkrahjen e Komisionit Funksional, ju lutem!

Shukrije Bytyçi nga “Nisma” e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht i përshtesha të gjithëve dhe i falënderoj të gjithë kolegët deputetë për përkrahjen e funksionalizimit të kopshtit për fëmijë, ose çerdhes, në komunën e Malishevës. Nuk ka rëndësi pse kur është nisur, prej Arsimit apo prej Shukries, me

rëndësi është që fëmijët dhe nënat Malishevës t'i gëzohen funksionalizimit të asaj çerdheje.

Tani e kemi amendamentin tjetër për funksionalizimin e shkollës ose ndarjen e shkollës në fshatin Vërmicë. Objekti është i ndërtuar, e kemi në mënyrë të specifikuar numrin e punëtorëve dhe mjetet për çfarë na duhen. Duhen 49 680 euro që shkolla e Vërmicës të funksionalizohet, domethënë që nxënësit të fillojnë të mësojnë aty, për arsye she shkolla e vjetër e Vërmicës, Komuna e Malishevës, ka qenë paralele e ndarë në dy mësonjëtoje, ku kanë mësuar 6 paralele me nga tri ndërrime. Domethënë fëmijët kanë mësuar në tri ndërrime, gjë që e ka penguar procesin mësimor, sepse është dashur që ora arsimore, në vend të 45 minuta, të jetë 30 minuta, ndërsa nga klasa e katërt deri në klasën e nëntë kanë mësuar në shkollën fillore të mesme të ulët "Gjergj Kastrioti", në Llozicë.

Në këtë shkollë, që tani është e nderuar dhe pritët vetëm të ndahen mjetet për funksionalizimin e saj për vitin 2014/2015, që të fillojë në gjysmëvjetorin e dytë do të mësojnë 300 nxënës, nga klasa parafillore deri në klasën e nëntë. Andaj është më se e nevojshme të plotësohen vendet e reja të punës dhe të planifikohet buxhet për këtë vit shkollor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ali Sadriu nga Lidhja Demokratike e Kosovës e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se të kontribuojmë në ndërtimin e shkollave apo të çerdheve është një çështje shumë humane dhe në vijat e të ardhmes në këtë model, në këtë formë të investimit, përkatësisht të gatishmërisë për investim nga Kuvendi, unë mendoj se po aplikohet një praktikë jo e mirë. Unë jam për ndërtimin, por praktika në të cilën po veprojmë tash, është në kundërshtim me të gjitha rregullat.

Para shkollimi, shkollimi fillor dhe i mesëm është çështje e përgjegjësisë komunale dhe më së pari komuna duhet atje ta trajtojë këtë çështje. Dhe, nëse nuk ka kapacitet, atëherë do të duhet që në koordinim me Ministrinë e Arsimit t'i gjejnë format e jo të vijë si projekt i veçantë këtu. Thjesht, po reagoj jo në kuptimin që ta ndali shkollën, po ta ndalim një praktikë të keqe, që të mos instalohet këtu.

KRYETARI: Faleminderit!

Amendamenti 62, pa përkrahjen e Komisionit Funksional, me propozimin e Grupit Parlamentar "Nisma për Kosovën".

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Me 49 vota kundër, 26 për, 7 abstenime, nuk kalon amendamenti 62.

Amendamenti 63, i propozuar nga deputetët Vjosa Osmani, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku dhe Arben Gashi, nuk e ka përkrahjen e Komisionit Funksional. Deputetja Vjosa Osmani është lajmëruar për diskutim.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Ky amendament i paraqitur nga katër deputetë, ka për qëllim implementimin e plotë të Ligjit për skema pensionale të financuara nga shteti, konkretisht të nenit 8, pika 6 të këtij ligji, i cili parasheh që t'u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit dhe shëndetësisë e të tjerëve, që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që kjo dispozitë ligjore të implementohet, është kërkuar saktësim në tabelën buxhetore 3.1 tek buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, te kategoria e pensioneve kontributpagues, thjesht të shtohet teksti në vijim: “përfshirë pensionet kontributdhënës të viteve ‘89-‘99, që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”.

Pra, është thjesht një sqarim i cili lejon implementimin e plotë të Ligjit për skema pensionale, jo vetëm një implementim të pjesshëm. Ky ka qenë një amendament, në fakt, që pastaj është bërë neni 8.6 i Ligjit për skema pensionale, në të cilin për gati dy vjet me radhë, ka insistuar Lidhja Demokratike e Kosovës dhe përfundimisht është bërë pjesë e këtij ligji.

Tashmë edhe një pjesë e buxhetit është ndarë nga Qeveria, e cila do të mund të implementonte në tërësi ligjin, pra thjeshtë në mënyrë që të lejohet ky implementim, në aspektin juridik kërkohet të bëhet edhe ky sqarim tek buxheti i Ministrisë së Punës dhe shpresoj që deputetët do ta përkrahin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ftoj deputetin Naser Osmani, përkatësisht edhe kryetar i Komisionit për Buxhet e Financa që të marrë fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

E kemi shqyrtuar kërkesën, në të vërtetë amendamentin e deputetes në fjalë dhe deputetëve të tjerë dhe këtë propozim e kemi përkrahur dhe e kemi futur në pjesën tekstuale të projekt-ligjit, respektivisht në amendamentin 6, ku nenit 12 i shtohet edhe pika 8, ku thuhet: “Qeveria obligohet që të krijojë mundësi për implementimin e Ligjit për skemat pensionale nr. 04/L-131, të financuara nga shteti, sipas nenit 8, paragrafi 6 dhe nenit 29 të Ligjit në fjalë.

Ta sqaroj, përgatitja për futjen e kësaj kategorie në njohjen e përvojës ka të bëjë me nenin 29, që parasheh nxjerrjen e disa dispozitave ligjore nga ana e Ministrisë përkatëse, që të formohen komisionet për të bërë verifikimin e të gjithë atyre që i kanë punësuar në atë kohë dhe, pasi të bëhet evidentimi i saktë, atëherë Qeveria mund t'i fusë ata në financim, siç është paraparë.

Prandaj, kjo kërkesë është futur në ligj dhe konsideroj, se kjo kërkesë është e plotësuar, por duhet që tash të funksionojë mekanizmi i Ministrisë përkatëse për krijimin e trupave që bëjnë verifikimin e këtyre. Konsideroj që deputeti ishte dashur ta tërheq këtë amendament, sepse është i futur në ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Vjosa Osmani ka kërkuar replikë.

VJOSA OSMANI: Faleminderit! Nuk është çështja e njëjtë. Në fakt, tentohet të rregullohet çështja e njëjtë, mirëpo nuk rregullohet në mënyrë të njëjtë, kjo për arsye, se amendamenti 6 thotë: “Qeveria obligohet që të krijojë mundësi.”. Kjo faktikisht nuk krijon ndonjë efekt juridik, sepse lihet në tërësi në vullnet të Qeverisë, të krijojë apo mos të krijojë, varësisht nga mundësitë ta implementojë këtë.

Ndërkaq, teksti që është propozuar në amendamentin e katër deputetëve, në fakt, obligon Qeverinë që domosdoshmërisht në përputhje me nenin 8.6 të Ligjit për skema pensionale, të përfshijë edhe këtë kategori. Pra, nuk lihet në vullnetin e askujt, që të krijojë apo të mos krijojë mundësi, po obligohet duke përfshirë këtë kategori tek buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Prandaj, unë shpresoj që deputetët do ta përkrahin sqarimin, që është dhënë në mënyrë shumë më konkrete dhe që është tekst i marrë drejtpërdrejt nga neni 8.6 i Ligjit për skema pensionale, ligj i cili u pat përkrahur nga shumica e deputetëve në mandatin e kaluar. Pra, amendamenti nuk tërhiqet, por propozojmë që të votohet teksti, të cilin e kemi propozuar unë bashkë me tre deputetët të tjerë.

KRYETARI: Prapë kryetari i komisionit e ka kërkuar fjalën.

NASER OSMANI: Me gjithë respektin, por amendamenti i Komisionit është shumë i saktë: “Qeveria obligohet” domethënë, nuk mbetet në vullnetin e askujt, por në obligim, kështu është e thënë.

Amendamenti i parashtruar nuk ka shumë të caktuar, prandaj përderisa nuk ka një shumë të caktuar, nuk mund të futet në tabela, për arsye se është prejudikim. Derisa nuk e dimë numrin e saktë, nuk mund të dimë edhe shumën, prandaj, kjo është mirë e formuluar dhe e mbulon këtë kërkesë, që është parashtruar nga deputetët në fjalë.

KRYETARI: Ismail Kurteshi e ka fjalën.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit!

Unë mendoj që kontestimi i kontributit të mësimdhënësve dhe punëtorëve të shëndetësisë gjatë viteve të '90-ta, nuk mund të vijë në shprehje dhe mendoj që edhe zvarritja e kësaj çështjeje, që asnjëherë nuk është dashur të kontestohet, është në njëfarë mënyre diskriminim për herë të dytë i atyre njerëzve që kanë kontribuar atëherë shumë dhe mendoj që është e padiskutueshme. Ata njerëz me punën dhe angazhimin që kanë bërë gjatë atyre viteve, kanë dhënë kontributin e tyre dhe mendoj që ky amendament i këtyre katër deputetëve duhet të votohet dhe të mos jetë çështje e vullnetit të askujt e as e kësaj qeverie dhe se vendimi i Qeverisë nuk guxon të varet nga shumat.

Të gjithë ata që kanë dhënë kontribut, të gjithë ata duhet tash të përfitojnë nga kontributi, ky nuk është ndonjë përfitim. Ata vetëm janë të barabartë me të gjithë njerëzit të cilët kanë punuar në kohë shumë më të mira, me të ardhura të rregullta. Këta që kanë punuar në një kohë pa të ardhura të rregullta, shpeshherë pa të ardhura personale dhe të diskriminuar dhe në kushte shumë të këqija, dikush tash duhet të marrë vendim, se a

duhet t'ia njohë kontributin apo jo! Ky është absurd i kohës së vet dhe kërkoj nga të gjithë deputetët, që kjo të votohet pa e zvarritur për asnjë moment më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Unë desha vetëm të jap një sqarim, se çështja e kategorisë së pensioneve, kontribut-paguesit e moshës, domethënë sikur kërkohet në këtë amendament, nuk është mirë e formuluar, pasi që nuk e parasheh një shumë dhe, për të qenë e plotë, atëherë Ministria e ka për detyrë me akt nënligjor, të konstatojë se cilët janë ata që e meritojnë dhe sa.

Prandaj, kujtoj që kjo është procedurë që i takon Ministrisë dhe, këtyre njerëzve me ligj iu është pranuar kjo e drejtë dhe është e patjetërsueshme. Është i panevojshëm ky amendament.

KRYETARI: Faleminderit, doktoreshë! Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Për të mos u llogaritur marketing politik, se tashmë e ka ndërprerë transmetimin Radiotelevizioni i Kosovës, po flasim për hir të korrektesisë dhe detyrës.

Sido që të jetë, nëse s'ka qenë i nevojshëm ky amendament, atëherë është dashur të ndodhë implementimi i ligjit. Dhe, unë po ua bëj të qartë kolegëve që kanë dilema, pse ne e kemi paraqitur këtë amendament, është se nuk është duke u implementuar ligji, i cili tash ka kaluar afër një vit që është miratuar këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe atë, me propozim të Lidhjes Demokratike të Kosovës, konkretisht amendament në seancë plenare nga Sabri Hamiti. Dhe, kjo gjuha juridike mund të ketë konkludime të ndryshme edhe nga kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa, por s'ka të bëjë me korrektesinë e një amendamenti, i cili është propozuar nga deputetët.

Ne kërkojmë, që amendamenti të mbetet, është shumë i qartë. Nëse ka nevojë edhe pesë herë dikujt t'i lexohet, por nuk besoj që duhet për t'ua lexuar shumë, as të flitet se përse duhet të jetë ky i përfshirë në tabelat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Gjuha juridike e përdor që të krijojë mundësinë, mbetet fontanë dëshirash, që të krijojë mundësinë, nuk ka ndoshta kohë që të krijohet mundësia, ose mund të dalë një punë më e rëndësishme për Ministrinë e caktuar. Por, është obligative, sepse është në ligj. Ne po kërkojmë që kjo të bëhet pjesë e tabelës buxhetore dhe Ligjit për buxhetin.

Dhe, kjo është arsyeja pse ne kemi paraqitur amendament, se ne kemi mundur të dalim deklarativisht e të themi: "kërkojmë implementim të ligjit" por, ne po kërkojmë amendament konkret, që të jetë pjesë e Ligjit të buxhetit. Kaq!

Dhe, unë mendoj që nuk ka ndonjë hezitim, nëse është i njëjtë atëherë me amendamentin 6, që e ka paraqitur Komisioni, edhe pse me nuanca të dëshirave, por sido që të jetë unë mendoj që ky amendament duhet të përkrahet.

KRYETARI: Latif Gashi e ka fjalën.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Realisht, kjo kërkesë e këtyre kolegëve është shumë e arsyeshme dhe edhe ne si Komision për Buxhet dhe Financa, me shumë seriozitet e kemi shqyrtuar. U tha këtu, se ka qenë kërkesë e zotit Hamiti. Unë e di, që kjo ka qenë kërkesë e kryeministrit, ish kryeministrit zotit Thaçi dhe tani zëvendëskryeministër, që u aprovua edhe nga deputetët e pozitës dhe të opozitës, pa hezitim, ngase kjo kategori është shumë e rëndësishme për atë periudhë kohore, ashtu siç ishin të rëndësishëm veteranët e luftës, për të cilët u nxor një ligj, por u desh të presim vite të tëra derisa të bëhet verifikimi i tyre, ashtu siç nxorëm Ligj për të burgosurit politikë, që u desh një kohë e gjatë të gjejmë mirëkuptim nga ata, të bëhet verifikimi dhe sakt numri i tyre dhe të nxirret kostoja buxhetore.

Andaj, edhe ne si Komision për Buxhet dhe Financa e kemi diskutuar shumë me kujdes këtë amendament dhe kemi ardhur në përfundim, që të nxjerrim një amendament, ku e obligon Qeverinë, Ministrinë përkatëse të bëjë trupa punuese, të nxjerrë saktë numrin e ish-punëtorëve, qoftë në shëndetësi, arsim, apo në vende të tjera, ngase ka shumë të tillë, që në atë kohë janë të regjistruar që kinse kanë punuar në Kosovë, por në fakt kanë qenë azilantë në vende të ndryshme, apo kanë punuar nëpër vende tjera të Evropës.

Andaj, unë kërkoj mirëkuptim, që të bëhet një Komision Qeveritar dhe të dihet numri i saktë, të dihet kostoja buxhetore. Nuk e di si kërkohet të futet në ligj, kur nuk dihet kostoja buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Selvije Halimi e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Unë veç desha të marr fjalën dhe t'i njoftoj kolegët deputetë, se në mandatin e kaluar Ministria e Arsimit, gjegjësisht Qeveria e kaluar ka përgatitur Draftligjin për kategoritë e mësimdhënësve 90-99. Dhe, ky draftligj ka buruar nga një vendim i kryeministrit atëherë, që t'u njihen kontributet, gjegjësisht pensionet, stazhi i punës kësaj kategorie për këto vite dhe nuk ka arritur të implementohet në shumicën prej komunave. Më pas është diskutuar mu në këtë Kuvend, në mandatin e kaluar dhe ka dal një rekomandim nga ky Kuvend, që duhet kjo çështje të rregullohet me ligj të veçantë, atëherë kur veç Ministria e Arsimit e kishte trupën punuese, që ishte duke e draftuar ligjin.

Ka shkuar në Ministrinë e Financave, por për shkak të një kostoje shumë të lartë buxhetore është kthyer në rishqyrtim. Dhe, po i njëjti grup punues ka diskutuar së bashku me Sindikatën e Arsimit dhe kanë ardhur në përfundim, se duhet të zvogëlohet pak a shumë kostoja buxhetore, në mënyrë që tërë kjo kategori pastaj të ligjësohet.

Gjithashtu, në këtë ligj parashihen dhe trupat punuese, që do të merren me verifikimin e të gjithë atyre që kanë qenë të angazhuar në procesin e mësimdhënies në këto vite, për periudhat e caktuara dhe të gjitha periudhat janë paraparë që duhet të kompensohen për atë kohë.

Sido që të jetë, tash pritet që ligji të vijë në këtë mandat dhe unë mendoj që nuk kemi nevojë të ngutemi dhe t'i fusim tash në skema sociale, si pension kontibutdhënës, por të shkojmë, të nxjerrim ligjin i cili do ta rregullonte në tërësi problematikën e kësaj kategorie për këtë periudhë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Shukrije Bytyçi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj se ky amendament duhet përkrahur, pavarësisht asaj se çka është bërë, unë mendoj se ne jemi të vonuar si Parlament i Kosovës, për t'ua njohur kontributin e mësimeve të asaj kohe. Është absurde të thuhet se nuk kanë qenë kontributdhënës ata për dhjetë vjet, kur ata kanë dhënë kontributin, ndoshta më të madh se të gjithë, sepse të gjithë fëmijët e Kosovës domethënë kanë mësuar se arsimimi edhe edukimi janë baza e një shteti, prandaj kërkoj përkrahjen e të gjithë deputetëve, që ky amendament të kalojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Armend Zemaj është lajmëruar për replikë.

ARMEND ZEMAJ: Kolegë deputetë,

E para, është që ne nuk kemi të bëjmë këtu me një kategori që i duhet verifikim, sepse ata mësimeve, ata pedagogë, kanë vazhduar të punojnë edhe pas vitit '99, po, tash në këtë fazë, kur i plotësojnë kushtet për pensionim nuk u takon kontributi dhe ata mbesin si kategori sociale.

Pra, ne po kërkojmë që të futen si kontribut-dhënës, nuk është kjo çështje sociale, as nuk është çështje që i përket një verifikimi apo nëse dikush ka keqpërdorur në suaza hipotetike, kush ku ka punuar. Ne po flasim për një kategori të nderuar, që është e verifikuar, ekzistojnë listat. Kolegia Halimi e elaboroi mënyrën e tentimit të një projektligji, por i cili nuk ka arritur të marrë përfundimin final.

Ekzistojnë me emër dhe mbiemër të gjithë ata që janë dhe janë pjesë e Ministrisë së Arsimit dhe që duhet të jenë pjesë edhe e këtij ligji. Kaq po kërkojmë. Nuk ka të bëjë ky me një kategori që duhet të verifikohet.

Dhe e dyta, pasi kërkuam kolegët, që e kemi RTK-3-shin dhe RTK-4-shin, ata janë kabllovikë, nuk janë tokësorë, ne kërkojmë sipas ligjit, që transmetimi publik ta transmetojë seancën deri në momentin e përfundimit dhe kjo bëhet jo rrallë, por bëhet qëllimshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Time Kadriaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Ne si komision, në mandatin e kaluar si Komision Parlamentar për Punë dhe Çështje Sociale, shumë seriozisht të gjithë anëtarët e Komisionit nga të gjitha subjektet politike jemi marrë me këtë çështje. Dhe në fakt, në projektligjin është përfshirë që t'u kompensohet gjithë ai mund të gjithë mësimeve, që kanë punuar prej vitit '90-'99,

por njëkohësisht edhe të gjithë mjekëve, mantelbardhëve, të cilët kanë punuar në organizimin e shoqatave “Nëna Terezë”, sepse s’ka qenë lehtë në të kohë të punohet, as si mësimdhënës, por as si mjek në ato kushte, sepse në çdo hap ke qenë i ndjekur prej policisë serbe.

Andaj, qoftë si amendament i propozuar nga kolegët deputetë të Lidhjes Demokratike, apo si implementim i ligjit në fuqi, ne e përkrahim këtë amendament.

KRYETARI: Latif Gashi e ka fjalën.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë kërkoj falje realisht se u desh shumë herë ta marr fjalën këtu, por, meqë është Ligji për buxhet dhe si anëtar i Komisionit për Buxhet isha i obliguar në njëfarë mënyre.

Unë edhe njëherë i lus kolegët deputetë edhe koleget, që tani janë në pozitë e ende po veprojnë si opozitë, të konsultohen me ministrin e Financave, kryeministrin, ministrat tjerë dhe t’i lënë dëshirat se dëshira ka shumë, po t’i shikojnë mundësitë. Mundësitë janë këto dhe unë prapë kërkoj që Qeveria të bëjë verifikimin e tyre, zoti Armend Zemaj se po ka dëshirë ta marrë fjalën edhe një herë, po ia përmendi emrin, tha se nuk duhet të bëhet verifikimi. Si atëherë t’u besojmë ne, edhe nëse dihet ajo kosto, ai numër, pse nuk prezantohet në këtë amendament e të thuhet janë kaq punëtorë dhe ka këtë kosto buxhetore, po flitet paushall. Faleminderit!

KRYETARI: Kisha kërkuar nga deputetët për hir të korrektësisë, edhe ndaj kësaj salle këtu po edhe ndaj opinionit publik që mos ta keqpërdorin edhe foltoren, edhe foljen nga tre katër herë. Unë e di që nuk u lejohet nga tri-katër herë, por është një keqpërdorim, i cili është duke ndodhur në vazhdimësi.

Sido që të jetë, Armend Zemaj, pasi ta përmendi emrin, replikë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Ne pikërisht jemi konsultuar me ministrat të dikastereve përkatëse dhe ata e përkrahin këtë kategori, bile i përkrahin këto “vite të arta” të Republikës së Kosovës dhe të gjithë atyre që kanë punuar dhe janë angazhuar për pavarësinë e këtij vendi. Dhe nuk besoj që ndokush mund të ketë ndonjë qasje tjetër ndaj kësaj periudhe.

Përndryshe, unë u besoj shumë pedagogëve, mësimdhënësve, por edhe personelit shëndetësor, sepse edhe ashtu më takon, sepse dy prindërit më vijnë nga ajo kategori dhe unë besoj shumë në paraqitjet e tyre si pjesë i këtij kontributi që duhet t’u njihet.

KRYETARI:Faleminderit! E ka fjalën profesori Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Mendoj se ne e kemi një ligj të aprovuar i cili shumë qartë ua njuh stazhin këtyre njerëzve. Krejt çka duhet, duhet të zbatohet ligji dhe të zbatohet menjëherë dhe ne po më duket po sajojmë probleme pa nevojë.

Nuk ka nevojë këtu të krijohet komisioni për verifikim e ç' verifikim, por njeri që del në pension, i merr vërtetimet, i çon atje dhe i pranohet stazhi. Mos t' i bëjmë këtu 100 telashe pa pasur nevojë. Dhe, nuk po di, në qoftë se ai buxhet për pensione që është paraparë, unë po e kuptoj që e përfshin edhe këtë kategori dhe në qoftë se s' e përfshin duhet të korrigjohet, po unë mendoj që e përfshin, prandaj po më doket se nganjëherë po sajojmë probleme artificiale për të treguar këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputeten Vjosa Osmani ta bëjë përmbylljen dhe të futemi në votim.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe një herë, në mënyrë që të mos kemi keqkuptime, sepse ka interpretime të ndryshme, është propozuar tekst jashtëzakonisht i saktë, tekst i cili është në përputhje të plotë me nenin 8.6 të Ligjit për skema pensionale dhe ky është i vetmi tekst i cili lejon implementimin e plotë të kësaj kërkesë që është njohja e stazhit të punëtorëve të sistemit të Republikës së Kosovës të viteve 1989-1999. Përderisa e kemi pasur një tekst kaq të qartë të propozuar nga deputetët, Komisioni për Buxhet dhe Financa s' ka pasur asnjë arsye të propozojë tekst tjetër totalisht të pa qartë, sidomos në aspektin juridik që thotë të krijohen mundësitë.

Unë i lus deputetët që në mënyrë që t' u njihet ai kontribut mësimdhënësve, punëtorëve shëndetësorë dhe të tjerëve gjatë viteve 89-99 ta përkrahin këtë amendament. Ata që nuk e përkrahin nënkupton që edhe nuk e njohin këtë kontribut.

KRYETARI: Faleminderit! Përfundimisht kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani është lajmëruar për diskutim.

NASER OSMANI: Po mundohem që të jam institucionalist dhe të mos lëshohem në çështje personale, sepse unë kam punuar prej vitit 1989 deri në vitin 1990, kam qenë nënkryetar i Këshillit për financim të Republikës së Kosovës, 10 vjet të plota, të cilat tash unë e kam vështirë nëse një komision i formuar nga Qeveria nuk ma vërteton atë periudhë në të cilën unë kam kontribuar. Ka të bëjë domethënë me mua personale. Unë po e them atë që duhet për ta bërë në mënyrën procedurale, pa u bërë këto verifikime, pa u dhënë këto dëshmi, sepse kolegët e mi po e ngatërrojnë. Nuk është vetëm çështja e arsimit. Është edhe e shëndetësisë, edhe e Komisionit të Solidaritetit, edhe të Këshillit për Financim, është edhe i Këshillit të Bujqësisë, edhe këshillave tjera që kanë punuar për ta mbajtur një jetë të tërë, dhe nuk guxojmë të ngutemi për të bërë vetëm për një kategori apo për t' ia bërë dikujt qejfin që po transmetohet ky emision për të dëgjuar që është për ta.

Prandaj unë kërkoj që Qeveria të respektojë ligjin, të respektojë nenin dhe amendamentin e Komisionit që komisioni të bëjë verifikimin e saktë të atyre kontributdhënësve.

Në anën tjetër, kjo do të ishte në dobinë e Kosovës dhe të institucioneve, sepse për sa atë që t' u njihet atyre stazhi, ata dalin në pension dhe për atë numër krijohen vende të reja të

punës. Kjo është dobi e përgjithshme, prandaj këtë duhet bërë me kujdes. Faleminderit dhe kërkoj që të votohet amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Atëherë jemi te amendamenti 63, i propozuar nga deputetët Vjosa Osmani, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku dhe Arben Gashi, i cili nuk e ka përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë të përgatitemi për votim dhe votojmë tash.

Atëherë, me 26 vota kundër, 5 abstenime dhe 46 vota për, kalon amendamenti 63.

Kalojmë tek amendamenti 64, po ashtu i propozuar nga deputetët Vjosa Osmani, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku dhe Arben Gashi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Vjosa Osmani e kërkon fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse pas propozimit të amendamentit, i kemi marrë edhe amendamentet tjera dhe jemi njoftuar që Qeveria e Kosovës tashmë i ka ndarë 3 milionë euro për listën e barnave esenciale dhe po ashtu shtesë përtej atyre që tashmë kanë qenë të planifikuara dhe totali ka arritur në 6 milionë euro, sa jemi të njoftuar. Po ashtu është rritur buxheti për shërim jashtë vendit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në të njëjtën kohë jemi njoftuar që çështja e shëndetësisë është bërë një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë sa e kuptoj për herë të parë pasluftës dhe për këtë besoj që është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, ne shpresojmë që 3 milionët e fundit të mbetura për listën e barnave esenciale do të shtohen në rishikim, prandaj këtë amendament në emër të katër deputetëve nënshkrues, e tërheqim.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Lus regjinë të bëhet gati për votim.

(Ndërhyrje)

E tërheq. Atëherë, faleminderit shumë!

Para se të votojmë për tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara, duhet të votojmë për prezencën e deputetëve në sallë.

Pra, të shohim një herë prezencën në sallë. A ka mundësi t'i bjerini ziles për t'i thirrur deputetët të vinë në sallë?

Edhe një herë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në sallë i kemi të pranishëm me kartelë elektronike 90 deputetë, derisa të numëruar janë 92. Po theksoj se dy nga deputetët nuk i kanë vendosur kartelat mirë, para votimit. Përgatitemi për votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Ju lutem, me 69 vota për, 20 kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015. Urime!

(Duartrokitje)

Pra, nëse pajtoheni do ta kishim bërë një pauzë prej 15 minutave. Nëse jo, të vazhdojmë. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar, duke filluar nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar, duke filluar nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë propozim-vendimin.

E ka fjalën kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e sotme e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë dhe njëherësh i ka rekomanduar Kuvendit që të miratojë rekomandimin e Komisionit që të aprovohet propozim-vendimi i Qeverisë numër 01/5, të datës 29 dhjetor 2014, për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar prej datës 1. 1. 2015 deri më 31.12. 2015 dhe ftoj deputetët që të votojnë propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për aprovim.

KRYETARI: Faleminderit! E kanë fjalën kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare pastaj deputetët. A ka dikush që paraqitet për fjalë? Atëherë, deputetja Alma Lama është paraqitur për diskutim më herët.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju tjerët mos u mërzitni se folët nga dhjetë herë, kurse unë vetëm një herë po flas dhe po kërkoj një sqarim.

Padyshim që e përkrah këtë vendim, por kam një pyetje në fakt, është shumë e paqartë, tek arsyetimi thuhet kështu në një pikë: Furnizimi i stafit nga institucionet religjioze dhe

filozofike për qëllime mjekësore të mirëqenies, mbrojtjen e fëmijëve dhe qëllime edukative. Me të vërtetë nuk e kam të qartë se çfarë do të thotë kjo? Thjeshtë, domethënë një sqarim dhe ta dimë çka votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Besnik Bislimi nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

BESNIK BISLIMI: Të nderuar deputetë,
Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, kisha kërkuar që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme për arsye se propozimi i Qeverisë është i përgatitur jashtëzakonisht keq, si propozimi ashtu edhe arsyetimi.

Është shumë lehtë të shihet pa se ku ka mangësi ky dokument. Për shembull kur radhiten ato pikat në të cilat thuhet për cilat vlen kjo periudha transitore, kemi mospërputhje mes të propozimeve dhe versionit origjinal të Ligjit për Tatimin në Vlerën e Shtuar, e kjo është që shkakton konfuzion. A mendohet që vetëm këto kategori të vazhdojnë të hyjnë në ato lirimet transitore, të periudhës transitore, a të tjerat fshihen, se është shumë keq i argumentuar për derisa të gjitha efektet buxhetore ekonomike dhe sociale kanë të bëjnë me vetëm një prej pikave të propozuara. Do të thotë ky propozim ka nevojë për përpunim shtesë nga ana e Qeverisë, në mënyrë që të argumentohen edhe elementet tjerë, e jo vetëm pjesa e parë që ka të bëjë me bujqësinë. Në njëfarë mënyre përmes fokusimit në bujqësi po tentohen të kontrabandohen pjesë tjera që të manipulohen pjesë tjera.

Ju kisha lutur që kjo të shtyhet derisa të na vijë një propozim pak më profesional të cilin kishim mund ta diskutojmë ne.

KRYETARI: E ka fjalën deputeti Zafir Berisha, nga “Nisma”.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!

Normalisht se është interes që të miratohet, por unë po llogaris në bazë të asaj për shkak të periudhës të shkurtër që erdh ky material, kjo është një ‘copy paste’ e dokumenteve të mëhershme.

Unë do ta argumentoj këtë ku thuhet në mungesë të statistikave, nuk e di ministri, meqë edhe po mungon, a e di se megjithatë një institucion i Kosovës ka bërë regjistrimin e bujqësisë, prandaj më nuk mund të thirremi se s’kemi statistika për të bërë politika të caktuara në bujqësi.

Përndryshe, po pajtohem me parafolësin se megjithatë ky dokument duhet rishikuar dhe të përshtatet vitit 2015. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Para se të votojmë për miratimin e propozim-vendimit të Qeverisë do të votojmë në rend të parë për prezencën e deputetëve në sallë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash për praninë në sallë.

Prezentë në sallë janë 82 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e propozim-vendimit të Qeverisë, pasi që do të jetë vendimi i fundit, pastaj deri më 19 janar 2015 kemi pushime.

Përgatitemi për votim! Votojmë tash!

Me 64 vota për, 8 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare lirime nga Tatimi i Vlerës së Shtuar duke filluar nga 1 janari 2015 deri më 31 dhjetor 2015.

Faleminderit! Urime të gjithëve festat dhe festa e Vitit të Ri!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*